

**RAPORT FINAL AUDITIMI
GJYKATA E APELIT TIRANË**

PASQYRA E LENDES

I.PERMBLEDHJA EKZEKUTIVE

II.HYRJE

III.METODA E AUDITIMIT

IV.GJETJET NGA AUDITIMI

V.ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TE LENA ME PARE

VI.REKOMANDIMET

RAPORT FINAL AUDITIMI GJYKATA E APELIT TIRANË

I. Përmbledhje ekzekutive

Bazuar në Ligjin Nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 6, gërma “c” e tij, në “Manualin e Auditimit të Brendshëm”, programit të auditimit të miratuar në Bord për vitin 2017 dhe programit të auditimit Nr. 01 Prot. datë 10/01/2018 u krye “*Auditim i Kombinuar*” në përputhje me përcaktimin e pikave të këtij programi.

Gjatë auditimit gjetjet janë ballafaquar dhe trajtuar me menaxherët perkatës të institucionit duke nxjerrë edhe konkluzionet perkatëse dhe dakortësuar në lidhje me përmiresimet në vijimësi.

Në përfundim të rishikimit dhe vlerësimit të gjetjeve grupi i auditimit arrin në opinionin se Gjykata e Apelit Tiranë paraqet një performancë të mire, pasi ka menaxhuar drejt veprimtarinë ekonomiko-financiare, ka administruar drejt vlerat monetare dhe materiale në dispozicion.

Raportimet financiare paraqesin në menyre të drejtë të gjitha aspektet materiale të institucionit dhe i kane dhënë menaxherit të lartë informacionin e duhur për menaxhimin me efikasitet dhe efektivitet të fondeve të vëna në dispozicion nga buxheti i shtetit si dhe të ardhurat e përfituara nga realizimi i shërbimeve të administratës gjyqësore sipas legjislacionit në fuqi.

Parregullsitë e konstatuara nga grupi i auditimit gjejnë pasqyrim dhe janë trajtuar më hollesisht në piken IV “Gjetjet nga Auditimi”.

II. Hyrje

Misioni i auditimit u krye nga grupi i auditimit i përbërë nga z. Aristotel Telhaj inspektor audit përgjegjës grupi, z. Agim Koçi dhe zj. Marjana Sulshabanaj inspektor audit.

Qëllimi i misionit të auditimit është :

- 1. Vlerësimi i veprimtarisë meparshme**
- 2. Vlerësimi i veprimtarisë aktuale**
- 3. Përmirësimi i veprimtarisë së ardheshme**

Për fillimin e misionit, nga grupi i auditimit u zhvillua takimi prezantues, me kryetarin e gjykatës, kancelarin dhe kryetaren e degës së buxhetit në datën 15/01/2018.

Në takim u prezantua qëllimi dhe tematika e auditimit, ku palët ranë dakord për fillimin e misionit të auditimit, sipas programit të auditimit të pranuar dhe axhendes paraprake.

Mbi bazën e sistemeve të audituar janë dhënë rekomandimet në pikën VI të projekt raportit për :

- 1. Sistemin organizativ*
- 2. Sistemin e hartimit dhe zbatimit të buxhetit*
- 3. Sistemin e pagave dhe pagesave*
- 4. Sistemin e prokurimit dhe blerjet e vogla dhe zbatim kontratash*
- 5. Sistemin e raportimit publik*
- 6. Sistemi IT*

III. Metodatat e Auditimit

Në misionin e auditimit është kushtuar rëndësi metodave dhe teknikave të manualit të auditimit. Janë përdorur metodat dhe teknikat e auditimit si: intervistat, llogaritjet matematikore, sondazhet, përzgjedhja, etj.

Grupi i auditimit ka respektuar formatet standard të hartuar në bazë të manualit të ri të auditimit dhe ligjit të auditimit të brendshëm.

**RAPORT FINAL AUDITIMI
GJYKATA E APELIT TIRANË**

Grupi auditimit është njohur me të gjithë dokumentacionin që ka menduar se është i nevojshëm dhe i ka siguruar gjurma e auditimit ne gjykatë.

Nga përfundimi i ketij procesi rezultoi se në fushën e llogarisë dhe në krijimin dhe funksionimin e mjedisit të kontrollit, gjykata vlerësohet me *rrisk të mesëm*.

Auditimi përfshiu periudhën nga 01/11/2014 deri në 31/12/2017.

IV. Gjetjet nga Auditimi

4.1. Funksionimi organizativ i Gjykatës

Gjykata e Apelit Tirane për periudhën e audituar ka funksionuar në bazë të ligjit Nr.9877, date 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i shfuqizuar (perjashtuar nenin 18, pika 1, 2, 3 “b”, 4 dhe nenet 26 dhe 27) me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”. Ligjeve të tjera të administrimit publik, akteve të nxjerra nga Bordi i Zyres të Administrimit Buxhetit Gjyqësor, Ministria e Drejtësisë dhe Keshilli i Lartë i Drejtësisë.

Ne mungese të një Rregulloreje të Brendshme të unifikuar për të gjitha gjykatat, ne nevojë të gjykatës, është hartuar dhe miratuar Rregullorja e Brendshme për Gjykatën, me urdher nr.72 prot. date 28.06.2012. Kjo rregullore është hartuar në zbatim të Ligjit Nr. 9877 datë 18.02.2008, “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, neni 18/3, pika (g) “Kompetencat e Kryetarit të Gjykatës”, “...Kryejne detyra të tjera në funksion të drejtimit administrativ të gjykatës, të parashikuara në aktet ligjore ose nenligjore.....”.

Nga auditimi konstatohet se: Në Rregulloren e Brendshme, ndarja e detyrave, pershkrimet e punës dhe përgjegjësitë duhet të jenë me të qarta dhe sipas strukture aktuale për çdo punonjës që ka funksione për menaxhimin e fondeve buxhetore, mbrojtjen e aseteve publike nga abuzimet, përdorimin e tyre me efektivitet, efikasitet dhe ekonomi, duke përfshirë edhe detyrimet që rrjedhin nga ndryshimet që ka në ligjin “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, dhe ligjin nr.10296 date 08.07.2010 “Per Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”(i ndryshuar).

Auditi rekomandon: Referuar nenit 37 germa “dh” të Ligjit Nr.98, date 06.10.2016 “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të rishikohet dhe permiresohet rregullorja egzistuese, ku ndarja e detyrave, pershkrimet e punës dhe përgjegjësitë të jenë të qarta dhe sipas strukture aktuale për çdo punonjës që ka funksione për menaxhimin e fondeve buxhetore duke përfshirë edhe detyrimet që rrjedhin nga ligji nr.10296 date 08.07.2010 “Per Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”(i ndryshuar).

Gjykata kryen veprimtarinë e saj procedurale dhe administrative, ku përfshihen: Pranimi, mbajtja dhe administrimi i akteve procedurale, provave materiale dhe shkresore të paraqitura, organizimi i shortit për ndarjen e çështjeve, si dhe shpërndarja e çështjeve për gjykim sipas shortit, njoftimet dhe komunikimet e akteve procedurale, përgatitja dhe shpallja e listës së gjykimeve, mbajtja e procesverbaleve të seancës gjyqësore, si dhe respektimi i kërkesave të solemnitetit në gjykim, etj.

Gjate vitit 2014, në Gjykatën e Apelit kanë përfunduar me vendim përfundimtar gjithsej 8398 çështje gjyqësore. Në vitin 2015, kanë përfunduar me vendim përfundimtar 7736 çështje gjyqësore gjithsej. Në vitin 2016 kanë përfunduar me vendim përfundimtar 7704 çështje gjyqësore. Për vitin 2017, kanë përfunduar me vendim përfundimtar 7354 çështje. Në mënyrë periodike është raportuar në KLD, M/Drejtësisë dhe ZABGJ. Gjykimimi i çështjeve gjyqësore mbështetet nga administrata ndihmëse në gjykatë. Puna për administratën mbështetëse është e organizuar referuar strukture organizative ku në

**RAPORT FINAL AUDITIMI
GJYKATA E APELIT TIRANË**

mbeshtetje te trupes gjyqesore jane Kancelari, ndihmesat ligjor , kryesekretarja, sekretaret gjyqesore, nepunes gjyqesor,dega e buxhetit, punonjesi i personelit, arkivistet,specialistet e IT, sanitar ,shofer, mirmbajtes, punonjes sigurie .

a). Struktura Organizative e Gjykates.

Struktura organike e Gjykatës për periudhën e audituar është miratuar nga Ministri i Drejtësisë, perkatesisht me Urdherat, nr.153/2 date 12.03.2014 me 81 punonjes, nr.1477 date 24.02.2015 me 84 punonjes dhe nr.1978/2 date 16.03.2016 me 88 punonjes,nr.113date 14.02.2017 me 88 punonjes. Gjykata e Apelit ne vitin 2014 dhe 2015, ka funksionuar me 25 gjyqtare nga 30 te percaktuar ne organike, ne vitin 2016 ka funksionuar me 29 gjyqtarë nga 30 te percaktuar ne organike,ne vitin 2017 ka funksionuar me 27 gjyqtar nga 30 te percaktuar ne organike. Ne vitin 2017 mungon nje ndihmes ligjor.

Krahasimi i numrit te punonjesve sipas struktures dhe organikes te miratuar me numerin e punonjesve ne fakt per periudhen nen auditim parqitet :

Viti	Nr. Punonjësve sipas Strukturës	Nr. Punonjësve	Diferenca
		Fakt	(+),(-)
2014	81	76	-5 gjyqtare
2015	84	79	-5 gjyqtare
2016	88	87	-1 gjyqtare
2017	88	84	-3gjyqtar
			-1nd/ligjor

Pervec struktures baze ,konstatohet se ne mbeshtetje te Kolegjit Zgjedhor jane miratuar nga ZABGJ, punonjes me kontrate te perkohshme konkretisht;

Ne vitin 2015,me shkresen nr.33 date 20.01.2015,te ZAB-se jane miratuar 3 sekretare gjyqesore me kotrate 6 mujore me kohe te plote pune 8 ore ne dite dhe 2 nepunes gjyqesor me kontrate 6 mujore me kohe te plote pune 8 ore ne dite ne mbeshtetje te kolegjit zgjedhor. Ne vitin 2016 me shkresat nr.98 date 23.02.2016 eshte eshte miratuar 1(nje) nepunes gjyqesor me kontrate te perkohshme per nje vit me kohe te reduktuar 4 ore ne dite.Shkresa nr .432,date 06.09.2016 miratuar 2 sekretare gjyqesore me kohe pune 8 ore ne dite per nje periudhe 4 mujore.Konstatohet se per vitin 2017 jane punesuar 3 sekretare Gjyqesore me kontrate (6 mujore), nje N/gjyqesor me kohe pune 4/oresh deri me 31.12.2017. ***Nga auditimi i perputhshmerise ligjore te struktures organike te Gjykates, u konstatua se:*** Administrata e Gjykates per periudhen ne auditim ka respektuar strukturen dhe numrin e punonjesve sipas organikes te miratuar. Per periudhen nen auditim nuk kemi tejkallim te numrit real faktik te punonjesve , krahasuar kjo me strukturat e miratuara ne baze te akteve ligjore dhe nenligjore te siperpermendura, por kemi mosplotesim te saj, qe ka sjelle dhe mosrealizim te shpenzimeve ne zerin “Paga” dhe “Sigurime Shoqerore”.

b.Praktika e menaxhimit të burimeve njerëzore. Zbatimi i akteve ligjore e nënligjore në lidhje me rekrutimet e reja, largimet nga puna, vlerësimet dhe aftësitë profesionale të punonjësve.
Mbi procedurat e rekrutimit dhe largimit nga puna.

Në lidhje me procedurat e rekrutimit, në Gjykatë, Per periudhen e auditimit 01.12.2013 deri me 31.12 2017, per shkak te levizjeve/vendeve vakant te krijuara ne gjykate, si rezultat i largimit nga puna me dëshire/kerkesen e tyre, daljes ne pension apo largimit nga puna per shkelje te disiplines ne pune jane bere Largime dhe emerime te reja.

Nga auditimi konstatohet se, nuk ekzistojnë procedura të qarta të shpalljes së vendeve vakante, të konkurimit, si dhe të përzgjedhjes së punonjësve administrativ. Për plotësimin e çdo vendi vakant, nuk

RAPORT FINAL AUDITIMI GJYKATA E APELIT TIRANË

është ngritur një *komision ad hoc*, që ka për detyrë që të hartojë kriteret konkrete të konkurimit, veç atyre të përgjithshme, të realizojë publikimin, mbledhjen e dokumentacionit, konkurimin nëpërmjet intervistimit, dokumentimin dhe arshivimin e të gjithë procedurës.

Auditi rekomandon: Deri në krijimin e institucioneve të reja të Gjyqësorit, për plotësimin e çdo vendi vakant, të ngrihet një komision ad-hoc, që të hartojë kriteret konkrete të konkurimit, veç atyre të përgjithshme, të realizojë publikimin, mbledhjen e dokumentacionit, konkurimin nëpërmjet intervistimit, dokumentimin dhe arshivimin e të gjithë procedurës.

Në lidhje me zbatimin e procedurave të largimit nga puna, nga kampioni i perzgjedhur për auditim rezulton se janë raste të largimit me kërkesën e vete punonjesve, të mbarimit të kontratës së punës si dhe raste të mbushjes së moshës për pension. Në të gjitha rastet janë zbatuar aktet ligjore dhe nenligjore në fuqi, për zgjidhjen e kontratës së punës.

Regjistri Themeltar i punonjesve

Nga auditimi rezulton se regjistri themeltar i punonjesve administrohet nga punonjësi i personelit në përputhje me nenin 96 "Regjistri", të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar me ligjin nr.136/2015. Regjistri themeltar i punonjesve, është sekretuar dhe vulosur në çdo faqe, si dhe është plotësuar në të gjitha referencat e tij. Nga auditimi i dosjeve të punonjesve administrativ, u konstatuan raste të mungesës së dokumentave që duhet të përmbajë dosja personale e çdo punonjësi, duke filluar nga fleta e inventarit, kërkesa për punësim, CV, dëshmi penalteti, vertetim mjekësor, dokument identifikimi, libere pune, diploma dhe liste notash, vertetim nga Njësia Bashkiake (adresa e banimit), certifikate familjare, diploma, certifikata trajnimesh, foto pasaporte, kontrata e punës me/pa afat si dhe kontrata e punës (marrja në provë), përshkrimi i vendit të punës, ku përcaktohen detyrat specifike, performanca periodike (vlerësimi i punës) dhe referenca të tjera. Kërkesa këtu të parashikuara në VKM-ne Nr.117 datë 05.03.2014 "Për Permbajtjen, Procedurën dhe Administrimin e Dosjeve të personelit ...". Përshkrimi i vendit të punës dhe vlerësimet periodike (vlerësimi i punës) duhet të behen/jenë pjesë e dosjes personale të çdo punonjësi.

Dosja personale e gjyqtarit.

Për efekt të vlerësimit përshkruar që kryen Titullari në kuadër të sistemit të vlerësimit profesional dhe etik të gjyqtarëve, në mënyrë që ky vlerësim të jetë sa më i bazuar, objektiv dhe i besueshëm, si dhe për efektet financiare korrekte - *per vjetërsite e pagueshme*, krahas fashikullimit që ekziston në KLD është krijuar një fashikull i ngjashëm dhe në Gjykatë. Për efekt pagesës së shtesës së pagesës të vjetërsisë në shërbim të gjyqtarëve, për vitet e punës të shërbimit të shënuar në librezën e punës janë konfirmuara nga KLD sipas dekreteve të Presidentit të Republikës dhe akteve të emerimit.

Konstatohet se administrimi i dosjeve të gjyqtarëve behet nga kryetarja e degës së buxhetit dhe jo nga punonjësi i burimeve njerezore e cila e ka detyrë funksionale administrimin dhe kompletimin e dosjeve si për gjyqtarët ashtu dhe për administratën për efekt të përlogaritjes së vjetërsisë në punë, për të garantuar sistemin e dyneshkrimeve. *Nga ana e punonjeses të burimeve njerezore u moren masa dhe u plotësuan dosjet me dokumentacionin e nevojshëm gjatë periudhës së auditimit.*

Funksionimi i gjykates.

Hyrja për administratën është nga parkimi dhe nga hyrja kryesore në Gjykatë. *Per të rritur sigurinë në gjykatë duhet të merren masa të instalohet hyrja me karta elektronike për të qenë e aksesueshme hyrja vetëm për administratën.* Hyrja për publikun është e vecantë, nga rruga kryesore, hapet në orën 08:00 dhe mbyllet në orën 16:00. Për personat me aftësi të kufizuara hyrja është e aksesueshme. Në hyrje ka detector, një punonjës sigurie nga Gjykata dhe një polic. Në ambjentin e publikut ka dy dhoma për avokatët me kompjuter, ka sallën e pritjes për gjyqë, ka një televizor në të cilën shpallen

RAPORT FINAL AUDITIMI GJYKATA E APELIT TIRANË

listat e ditës të gjyqeve, është instaluar sistemi i fonise ne hyrjen e gjykates per publikun, me ane te te cilit behet i mundur njoftimi i paleve me mikrofon nga sekretaret e seancave.

Nga ky ambient shkohet tek zyra e informacionit, e cila ofron shërbim për qytetarët dhe avokatët nga ora 08:30-15:00. Tek zyra e informacionit tërhiqen të gjitha vendimet, vërtetimet, fotokopjet dhe çdo kërkesë tjetër për informacion në lidhje me çështjet në gjykim. Kryesekretaria është e vendosur në katin e parë, ka derë me hekura për siguri më të lartë meqenëse dosjet sistemohen aty deri sa të përfundojnë gjykimin në Apel.

Sallat e gjyqeve funksionojnë me grafik, me trupa gjykues sipas ditëve të caktuara, të cilat rregullohen me një urdhër të brendshëm të kryetarit. Në gjykatën e Apelit Tiranë gjenden 8 salla gjyqësore, 5 prej tyre ndodhen në katin e parë të godines, me kalimin e godines "Ish apeli ushtarak" me shkresën nr.84 date 14.02.2017, të ZABGJ-se, janë shtuar 2 salla të reja gjyqesh dhe dy dhoma keshillimi, dhe 1 sallë në bodrum, ku zhvillohen masat e sigurisë. Të gjitha sallat janë të pajisura me a) kompjuter, b) bateri UPS, c) infrastrukture rrjeti të instaluar, d) paisjet audio të përbëra prej paisjes mikser DMX dhe mikrofonave (3-4 mikrofone në varësi të sallës) dhe e) printer laser. Në godine janë instaluar dhe funksionojnë sensorët **kunder zjarrit** si dhe bobulat fikese të zjarrit. Kamerat e sigurisë janë të gjitha në funksion të plote në 6 sallat e gjyqeve dhe në korridoret e gjykates (me përjashtim pjesën e shtuar të godines pas vitit 2017).

Gjykata disponon website e saj krijuar në vitin 2011 nga kompania host.al dhe në janar të vitit 2017 është rinovuar nga kompania Inovacion, për të qënë sa më i mirë menaxhueshëm nga publiku dhe stafi. Në website-in e Gjykatës së Apelit Tiranë www.gjykataeapelititirane.al pasqyrohen për publikun të dhënat e mëposhtme:

Çështje gjyqësore, Informacione Mbi gjykatën, Kalendari i seancave (seancat gjyqësore sipas datës dhe orarit), Vendimet e gjykatës, Informacion mbi shortin, Lajmërime për publikun, Publikime, Programi i transparencës, Kontakte.

Menaxhimi i riskut, dhe masat për parandalimin e ngjarjeve që rrezikojnë objektivat (me efektivitet, ekonomi dhe efikasitet). Regjistrimi dhe raportimi i masave për parandalimin e parregullsisë, abuzimeve dhe mashtrimeve.

Në mbështetje të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar me ligjin 110/2015 u krye auditimi mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Në kuptimin e këtij ligji menaxhimi dhe kontrolli financiar përcaktojnë përgjegjshmërinë menaxheriale për planifikimin, zbatimin dhe kontrollin e buxhetit, kontabilitetit dhe raportimit, për të arritur objektivat dhe për të shmangur shpërdorimin dhe keqpërdorimin e pasurisë.

Gjykata, në bazë të nenit 19 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me ligjin nr.110/2015, ka hartuar pyetësorin vjetor të vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm për vitin 2014, 2015, 2016 dhe 2017. Pyetësori i vetëvlerësimit dhe regjistri i minimizimit të riskut janë derguar dhe në rrugë elektronike dhe zyrtarisht në ZABGJ Brenda afateve të përcaktuara. Në këtë proces grupi i auditimit ka kryer teste kontrolli në procedura pune, pjesë e aktivitetit të Gjykates, për të vlerësuar përputhshmërinë me përgjigjet e pyetësorit të vetë vlerësimit dhe funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

a) Mjedisi i kontrollit.

Mjedisi i kontrollit përfshin të gjithë elementet e tjerë të MFK, pasi vendos strukturat dhe disiplinën. Gjykata e Apelit ka ushruar aktivitetin e saj në përputhje me deklaratën e misionit dhe objektivat strategjike të hartuara nga ZABGJ. Në përputhje me Kreun II, neni 8, pika 8(b) të Ligjit

**RAPORT FINAL AUDITIMI
GJYKATA E APELIT TIRANË**

Nr.10296, date 08.07.2010 “Per menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Manualin per Menaxhimin Financiare dhe Kontrollin”, me Urdherin e Kryetarit te Gjykates ne fillim te cdo viti eshte ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik(G.M.S) i njesise.Ne perberje te te cilit eshte Kryetari i Gjykates, ne cilesine e Nepunesit Autorizues, Kancelarja ne cilesin e menaxherit te Gjykates, Kryetarja e Deges se Buxhetit ne cilesine e Nepunesit Zbatues.Nga auditimi rezulton se: *Ceshtjet kryesore dhe mangesite qe kane dale brenda njesise i jane parashtruar grupit per menaxhimin strategjik, me qellim diskutimin e metejshem dhe marrjen e masave, ne perputhje me nenin 27, pika 1 te ligjit per MFK..* Nga auditimi rezultoi se: jane organizuar takime here pas here per te diskutuar problemet e dala gjate aktivitetit te gjykates, **mungon dokumentimi i ceshtjeve te trajtuara dhe zgjidhjet e dhena, ne nje regjister/liber te vecante.** Politikat dhe praktiket e menaxhimit te burimeve njerzore perbejne një pjesë të rëndësishme të kontrollit të brëndshem.

Nga auditimi konstatohet se nuk ekziston një planifikim mbi baza vjetore për trajnimet që duhet te zhvillohen per administraten. Ne fakt jane zhvilluar trajnime nga Ministria e Drejtesise ne lidhje me sistemin ICMIC per sekretaret gjyqesore, si dhe nga ZABGJ per programin Alfaweb per K/D/Buxhetit etj.Nuk janë zhvilluar trajnime me personelin në lidhje me njohjen dhe ndërgjegjësimin mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin(menaxhimin e riskut), prokurimet publike, menaxhimin e burimeve njerzore etj. Me qëllim rritjen e kapaciteteve profesionale të stafit.

Auditi rekomandon: *Trajnimi i stafit administrativ eshte i domosdoshem, ne bashkepunim me MD, DAP,APP dhe ZABGJ duhet te programohet, sidomos ne drejtim te Ndryshimeve ne legjislacion, prokurimeve publike,perdorimin e sistemeve informatike dhe financiare, menaxhimin e burimeve njerzore dhe MFK-se.*

b) Menaxhimi i riskut.

Menaxhimi i riskut përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme që kanë efekt të dëmshem mbi përmbushjen e objektivave të njësise publike dhe kryhet për të dhëne siguri të arsyeshme se këto objektiva do të realizohen. Risku matet sipas efektit të tij dhe shkallës së probabilitetit të ngjarjes.

Në mbeshtetje te nenit 10 te ligjit per MFK si koordinator i riskut është Titullari instiucionit. Risqet, të cilat identifikohen, merren parasysh në hartimin e objektivave afatmesem, brënda kapaciteteve dhe mundësive. Identifikimi dhe çështje që kanë të bëjnë me risqet ne arritjen e objektivave, trajtohen në mbledhjet javore qe organizohen nga Titullari institucionit. Rezultatet dhe konkluzionet e mbledhjeve, i komunikohen stafit për të ndërgjegjësuar praninë e risqeve. Në lidhje me menaxhimin e riskut, per vitin 2014,2015,2016 dhe 2017 eshte hartuar regjistri i minimizimit te riskut ne perputhje me kerkesat e nenit 11, pika 2 dhe nenit 12, pika 3(d) te ligjit “Per menaxhimin financiare dhe kontrollin” te ndryshuar, i cili eshte derguar në ZABGJ bashke me pyetesorin e vetevleresimit, në mënyre elektronike dhe shkresore. Ne regjistrin e riskut evidentohen masat e marra per minimizimin e risqeve per aktivet dhe per pjese te tjera te aktivitetit te gjykates.

c.Aktivitetet e kontrollit.

Aktivitetet e kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet, që synojnë reduktimin e risqeve me synim përmbushjen e objektivave të njësisë si dhe për të nxitur zbatimin e vendimeve të menaxherit.

Një kontroll i rëndësishëm mbi aktivitetin e gjykatës, është ndarja e qartë e detyrave dhe përgjegjësi të personelit. Ne Rregulloren e Brendëshme te Gjykates, jane te perfshira pershkrimet e punes per cdo pozicion pune, pergjegjesite dhe detyrat per secilin punonjes.Nga intervistat e kryera gjate auditimit me disa punonjes kanstatohet se nuk dine te pershkruajne qarte

RAPORT FINAL AUDITIMI GJYKATA E APELIT TIRANË

detyrat funksionale te tyre sipas emertesese qe kane ne organike. Nga ana e kancelares me cilesin e menaxherit te institucionit si dhe punonjeses se burimeve njerezore si personi pergjegjes, te merren masa per punonjesit e administrates gjyqesore nepermjet trajnimeve te njohin rregulloren e brendshme si dhe detyrat funksionale te tyre.

d. Informacioni dhe komunikimi.

Mekanizmat e kontrollit të pergjithshem zbatohen për të gjitha operacionet dhe kontribuojne për zbatimin e duhur të tyre, janë mekanizma të pergjithshem që kontrollojnë funksionimin e teknologjisë së informacionit. Ne këtë institucion këto kontrole ushtrohen nga dy specialistet e IT, në drejtim të ruajtjes së të dhënave të hyra në servere-t e sistemeve, e konkretisht kryhet back-up i të dhënave të sistemit ICMIS i programuar ne menyre automatike cdo te premte, si dhe Back-up i programuar cdo dy ore. Per te shtuar sigurine ,specialistet e IT kryejne ne fund te cdo dite nje Back-up manual te databases icmis i cili ruhet ne server. Testimi i këtij procesi është automatik, dhe kryhet nga vetë sistemi duke u mirembajtur nga specialistet e TI-se. Ne gjykate fuksinojn aktualisht dy sisteme: ICMIS -sistemi i menaxhimit te ceshtjeve gjyqesore civile dhe penale, i cili gjeneron informacion mbi ceshtjet qe nga moment i regjistrimit deri ne dhenjen e vendimit te gjykimit. Paketa RDA perdoret ne sallat e gjyqit i cili realizon regjistrimin audio te te gjithë seances gjyqesore, ne kuader te transparences se procesit. Çdo përdorues i sistemit të menaxhimit të çështjeve gjyqësore ICMIS për Gjykatën, është i regjistruar edhe në domain-in e gjykatës me një Username individual. Për të patur akses në të dhënat e tij, përdoruesit i duhet një fjalëkalim, i cili në fillim është vendosur standart, por dhe që mund të ndryshohet edhe nga vetë përdoruesi. Për aksesimin e kompjuterit (PC) të vendit të punës, përdoruesi logohet ne Domain , ku cdo përdorues është i regjistruar në Active Directory me te njëjtat kredenciale , pra duke përdorur të njëjtin fjalëkalim me sistemin ICMIS.

Per sa i perket informacionit financiare, eshte instaluar program “Alpha Web”, duke filluar nga viti 2015, ne te cilin duhet te pasqyrohet dhe rregjistrohet aktiviteti financiar dhe buxhetor I gjykates

e. Monitorimi.

Në Gjykatën Apelit Tirane , monitorimi kryhet nepermjet raportimeve periodike te Kancelares dhe KDB tek Kryetari i Gjykates. Nepermjet raportimeve periodike 3-mujore qe gjykata kryen ne ZABGJ, Ministrine e Drejtesise dhe analizave te kryera per fusha te vecanta te veprimtarise se sektoreve te gjykates. Ne perputhje me afatet ligjore dhe nenligjore ne fuqi monitorimi eshte kryer nga auditimi i jashtem(KLSH) dhe auditimi i brendshem(NJAB) te ZABGJ.

4.2. Hartimi i PBA-s dhe zbatimi i programit të fondeve buxhetore

a). Kriteret e hartimit të buxhetit .

Ne zbatim të Ligjit Nr.9936 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, udhëzimeve përkatëse të Ministrise Financave, si dhe vendimeve të Bordit e udhëzimeve të ZABGJ-s, është bërë hartimi, detajimi dhe miratimi i PBA-ve për vitin 2015-2017, 2016-2018, 2017-2019 dhe 2018-2020.

PBA-të janë hartuar, miratuar dhe dërguar në afat në ZABGJ. Pasqyrat e PBA-ve janë plotësuar sipas kërkesave të udhëzimeve përkatëse të Ministris Financese dhe ZABGJ-se.

Relacionet shoqeruese te tyre japin nje informacion baze te arsyetuar per menyren e llogaritjeve dhe çka jane nevojat e gjykates, sa mbulohen ato sipas limiteve te fondeve te derguara dhe sa nga te ardhurat e veta.

Hartimi i PBA-ve është bazuar në strukturën organike dhe numrit të punonjësve të miratuar nga Ministri Drejtësisë per fondin e pagave dhe sigurimet shoqerore, numrit të çështjeve të gjykuara dhe

**RAPORT FINAL AUDITIMI
GJYKATA E APELIT TIRANË**

ato të parashikuara për gjykim në vitet pasardhëse, standarteve orjentuese të dërguara nga ZABGJ dhe të dhënat e viteve parardhëse për shpenzimet operative, etj.

Nga auditimi konstatohet se në hartimin e PBA-ve nuk është respektuar “gjurma e auditit”, është ngritur grupi i punës (*Grupi Menaxhimit Programit*) për PBA-të për vitin 2016-2018, 2017-2019 dhe 2018-2020. Për hartimin e PBA-ve të vitit 2015-2017 nuk është ngritur GMP. Nuk është kryer ndarja e detyrave si dhe kalendari i punës për hartimin e PBA-së në përputhje me ligjin nr. 9936 datë 26/06/2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe udhëzimit nr.8 datë 29/03/2012 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” pikat 39 (a) dhe 47-55, ligji nr. 10296 datë 08/07/2010 “Për MFK” i ndryshuar nëni 12 pika 3/b/c. Përveç tabelave të PBA-ve të plotësuara dhe shkresave pritëse e përcjellëse për ZABGJ në dosje nuk ka dokumentacion për përgatitjen e tyre për të siguruar “gjurmën e auditit” në këtë proces. Për anetaret e grupit të menaxhimit të programit(GMP), nuk është kryer ndarja e detyrave, nuk është hartuar kalendari i aktiviteteve, nuk ka dokumentim të punës së antareve të GMP, analiza dhe llogaritje të shpenzimeve të cilat i shërbejnë procesit të hartimit të PBA-ve duke mos evidentuar “gjurmën e auditit” në këtë proces.

Auditi rekomandon : *Për hartimin e PBA-së si një proces i rëndësishëm për aktivitetin e gjykatës në vijimësi duhet të ndahen detyrat për secilin anëtar të GMP, të hartohet kalendari i aktiviteteve të grupit të punës në referencë edhe të kalendarit të hartuar nga ZABGJ sipas kërkesave të ligjit 9936 datë 26/06/2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe udhëzimit nr.8 datë 29/03/2012 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” pikat 39/a dhe 47-55 dhe të sigurohet gjurma e auditit në këtë proces.*

b). Zbatimi i Buxhetit

Zbatimi i buxhetit të Gjykatës për periudhën nën auditim është bërë në përputhje me ligjet “Për zbatimin e buxhetit” të viteve përkatëse, udhëzimet vjetore përkatëse të Ministrisë së Financës dhe udhëzimit nr. 2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” dhe sipas programit buxhetor të miratuar e dërguar nga ZABGJ-ja.

Të dhënat e realizimit të zërave kryesorë të buxhetit për periudhën nën auditim paraqiten si më poshte:

000/lek

Artikulli	Viti 2014			Viti 2015			Viti 2016			Viti 2017		
	Plan	Fakt	Rel.%	Plan	Fakt	Rel.%	Plan	Fakt	Rel.%	Plan	Fakt	Rel.%
600	84 600	79 167.7	93.5	82 700	82 634.2	99.9	82 950	82 404.5	99.3	9 6 450	95 370.2	98.8
601	11 700	10 916.1	93.3	11 550	11 488.6	99.4	11 650	11 459.6	98.3	13 650	13 278.6	97.2
602	19 078	18 671.9	97.8	15 600	15 597.1	99.9	16 626.5	16 626.5	100	19 400	17 471.7	90
606	90	90	100	185	185	100	30	30	100	390	390	100
231	2 240	2 216	98.9	3 900	3 900	99.9	2 390	2 352.2	98.4	7 300	7 020	96.1
Shuma	117 708	111061.9	94.3	113935	113 804.1	99.8	113 646.5	112 873	99.3	137 190	133531	97.3

Nga të dhënat e mesipërme rezultojnë se gjykata ka menaxhuar dhe realizuar buxhetin e planifikuar për vitin 2014 në masën 94.3 %, për vitin 2015 në masën 99.8 %, për vitin 2016 në masën 99.3 % dhe për vitin 2017 në masën 97.3 %.

Konstatohet se gjykata ka menaxhuar dhe realizuar drejt buxhetin e planifikuar. Investimet e realizuara janë fokusuar kryesisht në zërat “Paisje Elektronike” dhe “Paisje - Mobilje”, për shkak të amortizimit të paisjeve egzistuese dhe “Rikonstruksion parkimi për automjetet dhe arkivin e gjykatës” në vlerën 3925.8 mijë leke gjatë vitit 2017. Të ardhurat dytesore nuk janë përdorur nga ana e gjykatës.

**RAPORT FINAL AUDITIMI
GJYKATA E APELIT TIRANË**

c). Auditimi për të ardhurat nga tarifaf për shërbime gjyqësore.

Te ardhurat dytësore realizohen nga vjelja e tarifës së shërbimeve gjyqësore, konkretisht nga: 10% i takses së pulles, nga fotokopja, nga shërbimet e tjera gjyqësore dhe nga dhenja me qera e 1 (një) ambjenti për "Bar Kafe". U audituan 25 % e dosjeve civile të periudhës nën auditim për mënyrën e llogaritjes dhe arketimin e tarifës gjyqësore.

Në kampionin e perzgjedhur konstatohet se nga ana e gjyqësorit janë aplikuar drejt tarifaf gjyqësore bazuar në Udhëzimin e Perbashkët të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Drejtësisë nr.33 datë 29/12/2014 "Për përcaktimin e tarifave të shërbimit të administratës gjyqësore e Ministrisë së Drejtësisë, Prokurorisë dhe Notarisë", dhe është vjelë ajo.

Nga dega e buxhetit janë kryer regjistrime kontable për të ardhurat dytësore, janë kryer rakordimet periodike dhe vjetore me degën e thesarit dhe nga testimet e kryera rezultoi se janë të pasqyruara drejt.

Niveli i të ardhurave dytësore të realizuara nga gjykata paraqiten në tabelën e mëposhme:

Ne leke

Nr.	EMERTIMI	Viti 2014		Viti 2015		Viti 2016		Viti 2017	
		Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
1	Arketim nga 10% të takses së pulles	1 459	1 459	118 780	118 780	115 200	115 200	171 000	171 000
2	Arketim nga 1% i kerkese Padive	-	-	-	-	-	-	-	-
3	Arketim nga fotokopja	-	-	39 341	39 341	81 373	81 373	120 738	120 738
4	Arketim nga shërbimet e tjera gjyqësore	-	-	1 304 067	1 304 067	350	350	105 000	105 000
5	Arketim nga dhenja me qera	138 600	138 600	256 410	256 410	374 220	374 220	374 220	374 220
	Shuma								

Te ardhurat dytësore nuk janë përdorur nga ana e gjyqësorit.

4.2. Sistemi i Pagesave (Pagat, Transaksionet për blerjet, shpenzimet)

1. Pagat dhe shtesat mbi pagë

a). Përputhja e numrit të punonjësve sipas strukturës organizative të miratuar

Sistemi i pagesave në gjykatë, është bazuar në Ligjin Nr. 9877 datë 18.02.2008 "Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar për sa i përket trupës gjyqësore, Ligjin nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe VKM-ve përkatëse për administratën gjyqësore.

U auditua respektimi i strukturës organizative të miratuar për periudhën 01/11/2013 deri më 31/12/2017. Nga auditimi rezultoi se është respektuar struktura organizative e miratuar sipas urdhërave përkatës të Ministrisë së Drejtësisë dhe shtesave të përkohshme të miratuara nga Bordi.

Nga testi i kryer në lidhje me numrin e punonjësve të miratuar në strukturën organizative, me numrin e punonjësve në fakt, sipas listprezencave, listepagesave dhe pagesave në bankë rezultoi se ato përputhen.

Njëkohësisht është respektuar pozicioni i punës /detyra sipas strukturës së miratuar.

b). Përputhja e pagesave sipas klasave dhe vëndit të punës, shtesat mbi page, kriterëve për cdo vënd pune.

U audituan me zgjedhje listë pagesat për periudhën nën auditim. Në kampionin prej 25% ose 3 muaj për cdo vit ushtrimor u përzgjedh: për vitin 2014 muajt; Shkurt, Qershor, Nëntor, për vitin 2015; muajt

**RAPORT FINAL AUDITIMI
GJYKATA E APELIT TIRANË**

Prill, Gusht, Tetor, për vitin 2016 muajt; Janar, Maj, Shtator, dhe për vitin 2017 muajt; Mars, Korrik, Dhjetor.

Nga kryerja e testeve për saktësinë e llogaritjeve të pages, përputhjes së pages me pozicionin e punës sipas përcaktimeve të bëra në VKM-t përkatëse, shtesave për vjetërsi në shërbim të gjyqtarëve, vjetërsisë në punë të punonjësve administrativ, për arsimin, për vështirësi dhe kushte pune, përputhjen dhe saktësinë e pagave të paguara në bankë sipas punonjësve me pagën neto në listepagesë, rezultojnë se:

1. Në përputhje me nenin 22, pika 3(c) të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiare dhe Kontrollin”, i ndryshuar, është respektuar sistemi i dy nënshkrimeve, listë pagesat janë të nënshkruara nga Kryetari i Gjykatës/nëpunësi autorizues, Kryetari i Degës së Buxhetit/nëpunësi zbatues.

2. Për hartimin e Listepagesës janë mbajtur listë prezencat në përputhje me kërkesat e udhëzimit nr.30 datë 27/12/2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në NJSP” kreu III paragrafi “Dokumentimi i vlerave monetare dhe letrave me vlerë”, pika 69, 71, Udhëzimit të Bordit Nr. 3 datë 07/05/2012 “Për Proçedurat e Ruajtjes, Mbrojtjes dhe Kriteret e Kompetencat për Nxjerrjen nga Përdorimi të Aktiveve në Njësitë e Gjyqësorit”, kap. V, paragrafi i fundit dhe Udhëzimit Nr. 2.datë 06.02.2012 të Ministrisë Financiare.

Nga testimi i kryer në lidhje me përputhjen e ditëve të punës të shënuar në liste pagese me ditët e punës të shënuar në listeprezençë, nuk rezultuan raste mospërputhje.

3. Nga testimi mbi përputhjen dhe saktësinë e pagës neto të paguar në bankë sipas punonjësve me pagën neto në listepagesë, rezultojnë se paga neto e pasqyruar në listepagesë është e njëjta me pagën neto të pasqyruar në llogarine personale të secilit sipas formatit të listepagesës së bankës.

4. Nga ana e degës buxhetit është mbajtur dhe përditësuar Libri i Pagave deri më 31/12/2017 ku është pasqyruar paga, shtesat mbi pagë, ndalesat nga paga dhe paga neto për çdo punonjës për gjithë periudhën e audituar.

5. Nga testimi i kryer në lidhje me aplikimin, llogaritjen dhe pagesën e shtesës së pagës për vështirësi e dëmshmëri etj rezultoi se:

Gjetja # 1. Shtesa e pagës për vështirësi e dëmshmëri për shëndetin për pozicionet e punës: Sekretare gjyqësore, nëpunës gjyqësor dhe sanitare, për 8 punonjës të përhershëm për periudhën Mars-Dhjetor 2017(10 muaj) nuk është kryer në përputhje me VKM nr. 690 dt.09/10/2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr.717 dt.23/06/2009 të KM për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore” të ndryshuar, pika 4/a.... “Masat në përqindje të shkallëve të dëmshmërisë për shëndetin e punonjësve, të përcaktuara në paragrafin e dytë, ndryshojnë, si më poshtë vijon:

i) Në shkallën e parë, në masën 1335 (një mijë e treqind e tridhjetë e pesë) lekë në muaj;

ii) Në shkallën e dytë, në masën 4005 (katër mijë e pesë) lekë në muaj;

iii) Në shkallën e tretë, në masën 5340 (pesë mijë e treqind e dyzet) lekë në muaj;

iv) Në shkallën e katërt, në masën 6675 (gjashtë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë në muaj.”

sa vijon;

Pozicioni punës	Paguar në Fakt	Duhet sipas VKM 690 dt.9/10/2012		
		Shkallet	Pagesa	Paguar më tepër lek/muaj
Sekretare gjyqësore	6,800	III	5340	1,460
Nëpunës gjyqësor	5,100	II	4005	1,095
Sanitare	6,800	III	5340	1,460
Mirmbajtës	5,100	II	4,005	1,095

RAPORT FINAL AUDITIMI
GJYKATA E APELIT TIRANË

Gjetja # 2. *Për një gjyqtar për periudhën nën auditim është paguar shtesë page për gradë shkencore në masën 4200 lek në muaj e pa bazuar në ligjin 9877 datë 18/02/2008''Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë'', i ndryshuar neni 27 pika 1....'' Paga për funksion e gjyqtarit të gjykatës së apelit është e barabartë me 75 për qind të pagës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Pas 15 vjet vjetërsie në shërbim, për çdo vit vjetërsi, kjo pagë, deri në 25 vjet shërbim, shtohet me 2 për qind në vit, por jo më shumë se paga e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.''*

Auditi rekomandon: *Ndërprerjen e pagesave për përfitim të padrjetë për gradë shkencore dhe vështirësi e dëmshmëri për shëndetin, kryerjen e llogaritjeve për vlerën e përfitimeve të padrejta deri në 31/12/2017, kontabilizimin e tyre dhe nxjerrjen e aktit administrativ për rikthimin e tyre në buxhetin e shtetit.*

6.Nga testimi i kryer në lidhje me llogaritjen dhe pagesën e shtesës së pages per vjetërsi në shërbim për gjyqtarët, rezultoi se; llogaritjet janë kryer mbi bazën e vetëdeklarimit të bërë nga vetë gjyqtarët, si dhe fotokopjes së librezave të punës ndërsa llogaritja dhe pagesa e shtesës së pages për vjetërsi në punë e punonjësve të administrates mbështetëse, rezulton se: për punonjësit me page grupi është kryer në përputhje me pikën 2/b të VKM-së Nr.545, datë 11.08.2011, i ndryshuar me VKM Nr.589, date 17.07.2013, ku përcaktohet se.....''Shtesa për vjetërsi në punë, jepet në masën 2% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe llogaritet mbi pagën e grupit'' dhe për punonjësit me page me klasa në përputhje me VKM 717 datë 2.,06.2009 të ndryshuar pika 7,,,,,,'' . Nëpunësve/punonjësve, pagat e të cilëve caktohen sipas lidhjeve nr.I e nr.II dhe nënlidhjeve përkatëse, pas çdo viti pune, u jepet shtesë për vjetërsi pune, në masën 1 për qind mbi pagën bazë për klasë, por jo më shumë se 25 për qind. Për llogaritjen e kësaj shtese njihet vjetërsia e përgjithshme në punë''.

Vjetërsia në shërbim e gjyqtarëve dhe vjetërsia në punë e punonjësve administrativ formalisht është llogaritur nga personi përgjegjës për menaxhimin e burimeve njerëzore dhe kancelari dhe është dërguar në degën e buxhetit pasi nga auditimi rezulton se:

Në 22 punonjës(përfshirë 4 gjyqtarë, 2 ndihmësa ligjorë,13 sekretare gjyqësore dhe 3 punonjes të administratës mbështetëse) vjetërsia në punë e llogaritur nga punonjësi i personelit dhe nënshkruar edhe nga kancelari rezulton me llogaritje të gabuara të cilat janë korrigjuar në momentin e konstatuar nga dega e buxhetit(Në një rast gjyqtarit i është paguar vjetërsia e 3,5 viteve të kaluara njëherësh). Njëkohësisht në tre raste/punonjës, të rekrutuar rishtazi konstatohet se në degën e buxhetit është përcjellë drejtpërdrejt shkresa e lidhjes së mardhënieve të punës të nënshkruar nga kryetari pa përcaktuar klasën e pagës, pagën dhe vjetërsinë në punë ndërkohë që duhet të përcillej nga zyra e personelit.

Gjetja # 3 :*Në sistemin e pagave nuk funksionon sa duhet sistemi i kontrollit të brendshëm përsa i përket zyrës së menaxhimit burimeve njerëzore si dhe monitorimi nga ana e menaxherit përgjegjës, nuk funksionon sa duhet sistemi i dy nënshkrimeve në kuptimin që punonjësi i burimeve njerëzore dhe menaxheri përgjegjës duhet të jenë punonjësit që përcaktojnë pagën dhe elementët shtesë të saj në përputhje me strukturën dhe pozicionet e punës të miratuara (autorizuesi) dhe KDBuxhetit ai që kryen llogaritjen dhe kontabilizimin e pagave(zbatuesi).*

Auditi rekomandon: *Nga ana e GMS të gjykatës të merren masa për rishikimin e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm në fushën e pagave duke përcaktuar qartë detyrat dhe përgjegjësië e punonjësit që mbulon burimet njerëzore dhe procedurat e monitorimit. Njëkohësisht të saktësohen nga ana e burimeve njerëzore vjetërsitë në punë të të gjithë punonjësve duke kërkuar zyrtarisht nga KLD konfirmimin e vjetërsisë së punës për trupën gjyqësore, si dhe rillogaritjen e vjetërsive të administrates mbështetëse bazuar në librezat e punës dhe pas miratimit nga titullari ti dërgoht degës së buxhetit për të kryer verifikimet dhe korrigjimet e mundëshme.*

**RAPORT FINAL AUDITIMI
GJYKATA E APELIT TIRANË**

c). *Zbatimi i dispozitave ligjore për pagat jashtë orarit, në ditë pushimi e festash zyrtare.*

Nga testimi i kryer në lidhje me llogaritjen dhe pagesen e oreve jashtë kohes normale të punës në ditë pushimi e festa zyrtare konstatohet se: Pagesat janë bërë në zbatim të pikës 5, të Udhëzimit “Mbi unifikimin e praktikave për daljen në punë dhe pagesat jashtë kohes normale të punës”, si dhe Udhëzimin nr.1, datë 02.11.2015,(5/1) të Bordit Drejtues të ZABGJ-se.

d). *Përputhshmëria për zbatimin e dispozitave ligjore e nënligjore për pagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, tatimit mbi të ardhurat personale si dhe derdhja e tyre në llogaritë përkatëse.*

Nga auditimi me zgjedhje të listpagesave për periudhën e percaktuar nën auditim, konstatohet se llogaritja e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, sigurimit suplementar, tatimit mbi të ardhurat nga paga, është bërë në zbatim të legjislacionit në fuqi për Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore. Llogaritjet janë bërë për çdo punonjës, janë ndaluar nga paga sigurimet Shoqërore e Shëndetësore duke respektuar kufirin minimal e maksimal, tatimi mbi pagën, dhe njëkohësisht janë xhiruar në institucionet përkatëse, të rakorduara sipas afatëve të percaktuara.

e). *Respektimi i dispozitave ligjore mbi krijimin dhe perdorimin e fondit të vecantë*

Nga auditimi rezultojnë se janë respektuar drejt dispozitat ligjore për krijimin dhe perdorimin e fondit të vecantë.

2. Shpenzimet e funksionimit dhe shpenzime të tjera

U auditua me zgjedhje dokumentacioni i bankës për periudhën nën auditim (për vitin 2014, 78 U.Sh nga 311 U.Sh. gjithsej, muajt Janar, Mars, Maj, nëntor , për vitin 2015, 93 U.SH. nga 371 U.SH. gjithsej muajt shkurt prill, gusht, shtator, Dhjetor, për vitin 2016, 96 USH nga 384 gjithsej, muajt mars, shtator, nëntor, dhe për vitin 2017, 102 USH nga 405 gjithsej, muajt janar, qershor, maj, shtator, nëntor) në një kampion në masën 25% e transaksioneve.

Në përfundim të auditimit rezultojnë se regjistrimet janë kryer në mënyrë extra kontabel nga ana e KDB si dhe janë hedhur në vitin 2016, 2017 në programin programin financiar Alpha Web . Regjistrimet janë bërë korrekt për vlerat dhe për kronologjinë e regjistrimit të ngjarjeve ekonomike .U auditua dokumentacioni shoqëruar i Urdhër Shpenzimeve , si faturat , kontratat , flet hyrjet e magazinës , përmbledhëset e listpagesave dhe listpagesat, etj dhe rezultojnë se vlerat e tyre përputhen me vlerat në urdhër shpenzim.

Dokumentacioni shoqëruar i çdo transaksioni është i konfirmuar me vulën e thesarit, të gjitha dokumentat shoqëruar si dhe urdhër shpenzimet është respektuar sistemi i dyneshkrimeve. Janë kryer rakordimet periodike dhe vjetore me Degën Thesarit, për situacionet e pagesave mujore dhe vjetore të raportuara nga dega e buxhetit .

Vlera totale e situacionit për periudhën nën auditim përputhen me vlerat totale në ditarin e bankës. Pagat e punonjësve janë kaluar në llogaritë personale në bankë dhe janë të pasqyruara në librin e pagave.

Njëkohësisht u bë krahasimi i cmimeve në kontratat e lidhura, në blerjet me vlera të vogla me faturat e lëshuara nga operatorët ekonomikë si dhe flet hyrjeve të magazinës dhe rezultojnë se janë të barabarta.

U audituan llogaritë kreditore të operatorëve ekonomikë dhe rezultojnë se ato janë të rakorduara dhe të likujduara.

Nga auditimi u konstatua se pagesa e avokatëve të thirrur kryesisht, është bërë në përputhje me tarifën e percaktuar në Urdhër Nr. 1284/3 datë 16.3.2005 të Ministrisë Drejtësisë dhe Kryetarit të Dhomës Kombëtare të Avokatisë.

RAPORT FINAL AUDITIMI GJYKATA E APELIT TIRANË

Për pagesën e eksperteve dhe perkthyesve është respektuar udhëzimi i K.M nr. 4 datë 12.12.2012” Për caktimin e masës së shpenzimeve dhe pagesave të ekspertëve dhe dëshmitarëve gjatë procesit gjyqësor” pika IV.

Nga auditimi i shpenzimeve për energji elektrike dhe ujë, konstatohet se faturimi nga ana e operatorëve të energjisë elektrike dhe ujit kryhet mbi bazën e konsumit të matur nëpërmjet matësave të instaluar dhe kontratave të lidhura. Pagesat kryhen rregullisht cdo muaj sipas faturave të operatorëve dhe nuk konstatohen raste të faturave të palikujduara.

Për shërbimet postare konstatohet se fatura e operatorit “Posta Shqiptare” nuk “shoqërohet me kopje të regjistrit postar mujor të operatorit si dhe nuk ka gjurme të rakordimit me regjistrin që mbam gjykata në lidhje me këto shërbime. Nga intervista me K/D/Buxhetit u tha se janë kryer disa verifikime për saktësinë e regjistrit postar me regjistrin e gjykates dhe nuk janë konstatuar diferenca.

Auditimi i veprimeve të Arkës dhe i letrave me vlerë .

Mjetet monetare dhe vlerat tjera pranë arkës (pullat e taksës) ruhen në kasafortën që ndodhet pranë Arkes .

Nga auditimi për veprimet e arkes konstatohet se veprimet me arken mbahen nga punonjesja e zyrës së informacionit (sekretarja e Informacionit) , është mbajtur i vecantë libri i arkes nga arketari dhe ditari i arkes nga dega e buxhetit. Njekohesisht nga arketari është mbajtur i vecantë libri i pullave të taksës. Veprimet me mjetet monetare cash dhe vlerat e tjera pranë arkes janë kryer në përputhje me udhëzimin nr 30 date 27/11/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në NJSP” të ndryshuar. Konstatohet se janë kryer rregullisht akt rakordimit me degen e tatim taksave dhe thesarin. Mbi gjendjen e arkes u mbajt dhe akt konstatimi nr.1 dt 16.01.2018 ku nuk rezultuan diferenca. Gjendja në librin e pullave përputhet me gjendjen në kontabilitet të mbajtur në programin financiar Alpha Web.

Auditimi i veprimeve të magazinës .

U auditua me zgjedhje dokumentacioni i veprimeve të magazinës (*Kampioni për vitin 2014, 37 Fhyrje gjithsej , dhe 22 Flete Dalje nga 89 gjithsej, për vitin 2015, 13 Flet Hyrje dhe 28 Flete Dalje, për vitin 2016, 11 Flete Hyrje dhe 27 Flet dalje, dhe për vitin 2017, 44 flete hyrje dhe 21 Flete dalje.*)

Nga auditimi rezultoi se, dokumentacioni i hyrjeve dhe daljeve të mallrave dhe materialeve në magazinë është plotësuar , në përputhje me legjislacionin në fuqi. F.Hyrjet dhe F.Daljet janë të firmosura nga magazinjeri dhe financieri . Nga sektori i financës, regjistrimet e veprimeve të magazinës, në ditar, janë kryer në mënyrë kronologjike. Nga ana e magazinës është mbajtur libri i magazinës në kartela të vecanta ku janë të pasqyruar të gjitha levizjet dhe gjendjet e artikujve. Ndërmjet kartelave të magazinës dhe llogarisë është kryer rakordimi në sasi e në vlerë çdo muaj. Pajisjet dhe mallrat e inventarit u janë dhënë punonjësve me kartela personale. Materialet nga magazina jepen mbi bazën e një plani shpërndarje , kërkesave që behen nga punonjesit përkatës të administratës dhe urdherave për furnizim nga Kancelari,

Për periudhën nën auditim është kryer inventari fizik i gjendjes së aktiveve afatshkurtera dhe Aktiveve afatgjata të trupëzuara, në magazinë dhe në përdorim nga komisioni i inventarizimit i ngritur me urdher të Kryetarit të gjykates. Nga shqyrtimi këtij dokumentacioni nuk rezultojnë diferenca.

Në flete daljen nr.7, date 19.02.2014 është transferuar mjeti tip Furgon Hyundai për llogari të Gjykates Administrative Shkalla parë, me F/daljen nr.30, date 24.04.2015 transferuar në rezervat e shtetit autoveture,

Procedura e ndjekur është në përputhje me ligjin 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” ndryshuar me ligjin 110/2015 dhe Udhezimin nr.30 date 27/02/2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në NJSP, ndryshuar me udhëzimin nr.24 date 07.12.2016”

**RAPORT FINAL AUDITIMI
GJYKATA E APELIT TIRANË**

Gjykata administron inventarin e automjeteve te transportit gjithsej 2 (dy) autovetura dhe 2(dy) motocikleta ne gjendje pune .

Gjykata ka miratuar limite mujore per konsumin e karburantit per te gjitha automjetet. Nga shqyrtimi dokumentacionit rezulton se limitet jane respektuar dhe konsumi eshte monitoruar nepermjet fleteve te udhetimit te mbajtura per cdo automjet.

Nga auditimi i ushtruar për shërbimet e kryera per riparimin e automjeteve rezultoi se ato janë kryer me procedure blerje emergjence dhe procedure prokurimi “Për blerje me vlere te vogël”. Për autoveturat është mbajtur kartelet për riparimet e kryera dhe pjeset e kembimit te vendosura gjatë riparimit.

Nga auditimi konstatohet nje rritje e shpenzimeve te mirmbajtjes per dy motocikletat qe jane ne perdorim;Nga kartelat financiare per mirmbajtjen e motocikletave rezulton si me poshte:

Shpenzime mirmbajtje/ ne leke		
viti	M/cad457	M/ AH 240
2014	10000	10000
2015	26000	52560
2016	57315	78570
2017	82200	59830

Referuar sa me lart kerkohet te analizohen rastet per kryerjen e sherbimeve te mirmbajtjes se ketyre mjeteve nga nje komision i pasacem i ngritur per te bere vleresimin e defekteve te pesuara, dhe sherbimet te kryhen pasi te jete bere nje miratim paraprak.

Auditi rekomandon: *Te analizohet gjendja aktuale e dy motocikletave dhe te mbahen nen kontroll shpenzimet per mirmbajtjen e tyre ne referim te ligjit 110/2015,per perdorimin me eficence, ekonomi dhe efikasitet te fondeve publike,te behet nje verifikim paraprak nga nje grup i ngritur per te shqyrtuar domosdoshmerine e kryerjes se sherbimeve te mirmbajtjes te shoqeruar me relacion sqarues.*

Gjykata ka ne inventar nje kaldaje(qe kryen sistemin e kondicionimit te godines se gjykates) dhe dy gjenerator.Nga auditimi konstatohet se jane mbajtur kartelat sipas grafikut te venies ne pune te tyre ,furnizimi me karburant eshte bere me urdher te kryetarit te gjykates dhe me procesverbal te daljes se karburantit nga magazina.Furnizimi me karburant eshte kryer sipas normativave te konsumit .

Nga auditimi konstatohet se ne magazine rezulton gjendje karburanti, dhe furnizimi me karburant per automjetet behet me tollona, ne kundershtrim me vendimin nr.561,date 29.07.2016 “Per standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve te karburantit ne njesite e qeverisjes se pergjithshme” ku citohet qe furnizimi me karburant per mjetet efektive te transportit te kryhet vetem nepermjet kartes elektronike me te cilen mundesohen identifikimi i mjetit dhe perdoruesi i saj.

Auditi rekomandon: *Te analizohet gjendja aktuale e karburantit ne magazine dhe te merren masa qe furnizimi i mjeteve te transportit te kryhet vetem me karte elektronike ne zbatim te VKM nr561,date29.07.2016,“Per standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve te karburantit ne njesite e qeverisjes se pergjithshme”.*

4.3. Sistemi i raportimit publik

a) Organizimi, mbajtja e kontabilitetit dhe Pasqyrat Finaciare

Misioni i auditimit u ushtrua edhe në mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare për periudhën 01/01/2014 deri 31/12/2017 .

**RAPORT FINAL AUDITIMI
GJYKATA E APELIT TIRANË**

Nga auditimi i realizuar konstatohet se mbajtja e kontabilitetit dhe hartimi i pasqyrave financiare kryhet bazuar në ligjin Nr. 9228 date 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” nenet 3 dhe 5 të tij ,V.K.M Nr.248, date 10.4.1998 “Për planin kontabel të institucioneve buxhetore” i ndryshuar me VKM nr 25 datë 20/01/2001. Gjithashtu janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit.

Rregjistrimet kontabile janë mbajtur manualisht në exel dhe janë të printuara e të lidhura me dokumentacionin përkatës sipas ditareve për cdo vit ushtrimor.

Veprimet kontabël në këtë institucion janë mbajtur duke u rregjistruar në ditaret : “Arka në lekë”, “ Banka”, “Të ardhurat”, “Shpenzimet“, ditarët e “Hyrjeve dhe Daljeve të magazinës”, ditari i “Veprimeve të Ndryshme” dhe “Libri i Madh“ dhe kartelave analitike të llogarive.

Kontabilizimi i pagave, shpenzimeve , blerjeve, lëvizjeve të magazinës, të aktiveve bëhet në ditare të rregullt të cilat japin në fund të çdo periudhe gjendjen e llogarive dhe shërbenin për nxjerrjen e llogarive në fund të vitit buxhetor, pra të bilancin kontabël.

Nga testimi i kryer në lidhje me mbajtjen e kontabilitetit dhe regjistrimet kontabile të veprimeve ekonomike rezulton se :

- Veprimet ekonomike kanë ndodhur dhe të gjitha transaksionet janë regjistruar me vërtetësi.
- Kane ndodhur të gjitha transaksionet dhe janë regjistruar në periudhën ushtrimore përkatëse.
- Të gjitha aktivet, detyrimet dhe shpenzimet janë pasqyruar në regjistrat e kontabilitetit.
- Ka klasifikim ekonomik të saktë dhe janë kryer në llogaritë e duhura kontabile.
- Transaksionet janë regjistruar në kohë.
- Transaksionet dhe operacionet kanë qenë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet që aplikohen në njësitë publike.

Të gjitha Pasqyrat Financiare në analize, kanë inventarin kontabel të cdo llogarie sipas V.K.M Nr.248, date 10.4.1998 “Per planin kontabël të institucioneve buxhetore”i ndryshuar dhe Udhëzimeve përkatëse vjetore të Ministrisë Financave “Për mbylljen e vitit financiar dhe paraqitjen e raportit vjetor”.

Pasqyrat financiare shoqërohen me raportin vjetor dhe anekset përkatës. Pasqyrat financiare janë hartuar , miratuar dhe janë dorëzuar në degën e Thesarit Tiranë , në Ministrinë e Drejtësisë Drejtorinë Ekonomike dhe pranë Zyres së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor sipas afateve të percaktuara ligjore.

Pasqyrat Financiare paraqesin drejtë e me objektivitet shpenzimet, të ardhurat, aktivet dhe pasivet. Nga auditimi i të dhënave të llogarive në celje të vitit ushtrimor rezulton se vlera e tyre përputhet me gjendjen në mbyllje të vitit paraardhës .

Amortizimi është llogaritur sipas normave të amortizimit mbështetur në Udhëzimin nr.14 datë 28.12.2006 “Për përgatitjen e raportimit të pasqyrave Financiare Vjetore për Institucionet Qendrore, Organet e Pushtetit Vendor dhe njësitë që varen prej tyre. Kërkesa arkëtimi mbi debitorët, pasqyrojnë detyrimin e buxhetit për pagat dhe shtesat e tjera , që paguhet në janar të vitit pasardhës, detyrimet për garanci pasurore dhe gjendjen e pullave të taksave etj.

Regjistri analitik i aktiveve për periudhën nën auditim është mbajtur manualisht në exel.

Në lidhje me programin financiar AlphaWeb.

Veprimtaria ekonomiko financiare për vitin 2015 e në vijim si dhe regjistrimet kontabile duhet të kryheshin në programin financiar “Alpha Web“ të instaluar në gjykatë në fund të vitit 2014 por nga auditimi konstatohet se për vitin 2015 nuk ka regjistrime në program ndërsa për vitin 2016

**RAPORT FINAL AUDITIMI
GJYKATA E APELIT TIRANË**

regjistrimet janë kryer pjesore dhe mbyllja e vitit është kryer me fletë kontable përmbledhëse të cilat nuk të japin informacion të detajuar mbi aktivitetin ekonomik financiar, lëvizjet dhe ndryshimet e aktiveve dhe pasurisë së gjykatës. Për vitin 2017 rregjistrimet vazhdojnë të jenë pjesore dhe si të tilla kanë shkëlur parimin e rregjistrimit në kohën e ndodhjes së ngjarjeve ekonomike.

Informacioni që meret nga programi alpha web nuk është, i plotë , i saktë ,i detajuar dhe si i tillë nga auditimi nuk u muar në konsideratë për auditim.

Njëkohësisht theksojmë se edhe rregjistrimet e kryera për vitin 2017 janë regjistrime të kopjuara nga rregjistrimet manuale në exel pasi gjithë dokumentacioni bazë (F.Hyrje, F.Dalje, M.Arkëtimi, M.Pagesa, Listpagesa etj) janë prodhuar manualisht.

Dega e buxhetit në strukturën e saj ka dy punonjës KDBuxhetit dhe një specialist ekonomist. Në ndarjen e punës ekonomistit i është ngarkuar detyra e rregjistrimeve të veprimeve në këtë program.

Nga auditimi konstatohet se kjo detyrë nuk është përmbushur nga punonjësi i mësipërm për shkak të mungesës së njohurive për të punuar me këtë program, trajnimit të tij, por edhe të mungesës së monitorimit të punës nga KDBuxhetit.

Gjetja # 4: Në lidhje me funksionimin e programit Alpha Web konstatohet rrisht i lartë për investimin e kryer në blerjen dhe shpenzimet vjetore që kryhen për mirmbajtjen e tij pasi edhe pas një periudhe 3 vjecare programi nuk është efektiv, nuk ka realizuar objektivin për të cilin është investuar dhe rrezikon mospërdorimin e tij .

Auditi rekomandon: Duke mbajtur parasysh se programi financiar Alpha Web ka 3 vjet në përdorim dhe punonjësit nuk kanë fituar aftësinë për të menaxhuar aktivitetin ekonomik financiar nëpërmjet tij nga ana e gjykatës të merren masa për trajnimet e punonjësve . Njëkohësisht brenda afateve të përcaktuara të kryhen të gjitha regjistrimet kontabile dhe pasqyrat financiare të vitit 2017 të gjenerohen nga programi si dhe monitorimin e e vazhdueshëm të rregjistrimeve për vitin 2018 e ne vijim duke respektuar parimet e regjistrimeve në kohë , saktësi dhe korrektësi .

b) Inventarizimi i aktiveve .

Për periudhën nën auditim, është realizuar inventarizimi i aktiveve të këtij institucioni në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhim financiar dhe kontrollin” të ndryshuar dhe udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011“Per menaxhimin e aktiveve ne NJSP“, pikës 73 dhe 74.

Për kryerjen e inventarizimeve është ngritur komisioni i inventarizimit me urdhër të brendshëm të kryetarit të gjykatës në përputhje me udhëzimin nr.30 datë 27/12/2011“Per menaxhimin e aktiveve në NJSP“ pika 81.

Nga ana e nëpunësit zbatues, është hartuar lista e aktiveve për inventarizim, në bazë të dhënave të regjistrave kontabël të aktiveve të njësisë

Përfundimet e inventarizimeve dhe nxjerja e rezultateve të tij është miratuar nga nëpunësi autorizues. Për periudhën nën auditim nga kryerja e imventarizimeve nuk kanë rezultuar diferenca

Të tjera:

Gjatë auditimit nuk pati probleme apo çështje që duhet të trajtohen jashtë programit të miratuar të auditimit.

4.4. Sistemi i Prokurimeve me Vlere të Larte dhe Vlere të vogel

Autoriteti Kontraktor “Gjykata Apelit Tirane”, bazuar ne Ligjin Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, VKM-se Nr.1 date 10.01.2007 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i shfuqizuar, Kreu I, pika 3-b”. V.K.M-se Nr.914, date 29.12.2014 “Për miratimin

**RAPORT FINAL AUDITIMI
GJYKATA E APELIT TIRANË**

e rregullave të prokurimit publik”, Kreu I, neni 4. Udhezimit nr.2 date 27.01.2015 “Per hartimin e regjistrit te parashikimit te prokurimit publik dhe regjistrit te realizimit te prokurimit publik. Ka hartuar e derguar, brenda afateve ligjore ne menyre elektronike dhe shkresore ne organin qendrore ZABGJ, Regjistrin e Parashikimit dhe Realizimit te Prokurimeve Publike per vitin 2014, 2015, 2016 dhe 2017. Kjo e fundit si organ qendrore, me miratimin e regjistrit te parashikimit te prokurimeve publike për vitin 2014, 2015, 2016 dhe 2017, ja ka derguar Autoritetit Kontraktore per zbatim. Në rastet e ndryshimeve nga AK është bërë kërkesa për ndryshimin dhe pas miratimit janë kryer veprimet perkatese.

Nga auditimi mbi prokurimet publike për periudhen nen auditim, rezultoi se:

Auditimi i përputhshmërisë ligjore në lidhje me procedurat e objekteve të prokurimit, u përqendrua kryesisht në segmente të tenderimit dhe kryesisht mbi vlerën e prokurimit të parashikuar duke e krahasuar me vlerën e prokurimit të realizuar; në përlllogaritjen e vlerës së fondit limit të kontratave të publikuara; si edhe në përzgjedhjen e operatorëve ekonomik fitues, në lidhjen dhe zbatimin e kontratave të ofertuesve fitues. Kështu, duke u nisur nga baza ligjore e mësipërme dhe nga treguesit e audituar, më poshtë po japim në mënyrë të përmbledhur auditimin mbi procedurat e prokurimeve publike të realizuara nga Gjykata Apelit Tirane.

- Sipas RPPP, per vitin 2014 jane planifikuar per tu zhvilluar 5(pese) procedura prokurimi me vlere te larte “Kerkese per Propozim”, me fond limit te pergjithshem 7 800 mije leke. Referuar RRPP gjate vitit 2014 jane realizuar 5(pese) procedura prokurimi me vlere te larte “Kerkese per Propozim, konkretisht; 4(kater) per kontrata blerje malli dhe 1(nje) per kontrate sherbimi.

- Sipas RPPP, per vitin 2015 jane planifikuar per tu zhvilluar 6(gjashte) procedura prokurimi me vlere te larte “Kerkese per Propozim”, me fond limit te pergjithshem 11 000 mije leke me tvsh. Referuar RRPP gjate vitit 2015 jane realizuar 5(pese) procedura prokurimi me vlere te larte “Kerkese per Propozim, konkretisht; 4(kater) per kontrata blerje malli dhe 1(nje) per kontrate sherbimi. Procedura e prokurimit “Blerje Paisje te tjera (perde)” e parashikuar per tu zhvilluar me proceduren e prokurimit “Kerkese per propozim” ne vleren 1000 mije leke, eshte realizuar me proceduren e prokurimit “Me vlere te vogel”.

- Sipas RPPP, per vitin 2016 jane planifikuar per tu zhvilluar 3(tre) procedura prokurimi me vlere te larte “Kerkese per Propozim”, me fond limit te pergjithshem 7 550 mije leke me tvsh. Referuar RRPP gjate vitit 2016 jane realizuar 3(tre) procedura prokurimi me vlere te larte “Kerkese per Propozim, konkretisht; 2(dy) per kontrata blerje malli dhe 1(nje) per kontrate sherbimi.

- Sipas RPPP, per vitin 2017 jane planifikuar per tu zhvilluar 5(pese) procedura prokurimi me vlere te larte “Kerkese per Propozim”, me fond limit te pergjithshem 13 100 mije leke me tvsh. Referuar RRPP gjate vitit 2017 jane realizuar 5(pese) procedura prokurimi me vlere te larte “Kerkese per Propozim” me vlere te larte “Kerkese per Propozim, konkretisht; 1(nje) per kontrate punime, 3(tre per kontrata blerje malli dhe 1(nje) per kontrate sherbimi.

Per periudhen nen auditim 2014 - 2017 nga AK jane realizuar 18 procedura prokurimi me vlere te larte “Kerkese per Propozim”, me zgjedhje u audituan procedurat e meposhme:

Te dhenat ne leke

Nr	Viti	Objekti i Prokurimit	Vlera ne leke e Prokuruar me TVSH	Vlera ne leke e fituar me TVSH	Diferenca	Lloi procedures
1	2017	Blerje Paisje Mobilje	1 280 000	955 080	-324 920	“Kerkese per propozim”
2		Sherbim Sigurie	2 244 023.29	1 591 182.77	#####	“Kerkese per propozim”
3		Blerje Tонера	2 500 000	2 086 872	-413 128	“Kerkese per propozim”
4		Blerje Karburanti	2 500 000	2 500 000	-	“Kerkese per propozim”
1	2016	Blerje Karburanti	2 272 000	2 272 000	-	“Kerkese per propozim”

**RAPORT FINAL AUDITIMI
GJYKATA E APELIT TIRANË**

2		Blerje Tonera	2 400 000	1 955 760	-444 240	“Kerkese per propozim”
1	2015	Blerje Paisje Elektronike	1 700 000	1 531 354	-168 646	“Kerkese per propozim”
2		Blerje Tonera	2 300 000	2 210 119	-89 881	“Kerkese per propozim”
1	2014	Blerje Karburanti	2 500 000	2 500 000	-	“Kerkese per propozim”
2		Sherbim Sigurie	1 200 000	900 418	-299 418	“Kerkese per propozim”
		TOTALI :	18 651 999	16 911 766	1 740 233	

Sic shihet nga pasqyra, u audituan 10(dhete) procedura prokurimi me vlere te larte ose **55.5 %** te procedurave te realizuar nga AK per periudhen nenauditim. Te gjitha te realizuar me proceduren e prokurimit “Kerkese per propozim” me fond limit te korrektuar me tvsh ne vleren **18 651 999 leke** dhe me kontrata te lidhur ne vleren **16 911 766 leke me tvsh**. Nga analiza e prokurimeve me vlere te larte te realizuar nga AK te audituar, rezulton se jane kursyer buxhetit te shtetit nje vlere prej **1 740 233 leke** ose **9.3 %** te fondit te prokuruar. Te cilat jane perdorur per nevojat e AK ne drejtime te tjera mbas kerkeses dhe ndryshimit ne RPPP. Ne llogaritjet e bera nuk eshte perfshire sherbimi i sigurise 2017, per mosperputhje te vleres te prokuruar me vleren e kontrates te lidhur, si rezultat i ndryshimit te periudhes/kohes te sherbimit.

Per tenderat e audituar, ne perfundim te auditimit dhe ballafaqimeve gjendja paraqitet si me poshte:

Per vitin 2017

1. Tenderi i zhvilluar ne platformen elektronike me objekt prokurimi “**Blerje Paisje Mobilje**”, realizuar ne vitin 2017, me pjesmarrje ne konkurim te 6 OE, nga keto 3(tre) te kualifikuar dhe 3(tre) te skualifikuar, pa asnje ankese dhe me te dhena te tjera si ne tabelen e meposhme:

Të dhëna të përgjithshme për tenderin:

Të dhëna për tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e prokurimit
A	B	C
1. Urdhër Prokurimi Nr.53 date 11.05.2017. 2. Fondi limit - pa tvsh 1 066 667 leke. - me tvsh 1 280 000 leke. 3. Pr.Prok. “Kerkese per Propozim”, me EL. 4. Data e zhvillimit te tenderit 23.05.2017. 5. Morën pjesë në tender 6 OE. 6. Fituesi: “SHAGA” shpk. 7. Data e lidhjes te kontratës 19.06.2017. 8. Vlera e kontratës: 955 080 leke me tvsh. 9. Diferenca me fondin limit 324 920 lekë me tvsh. 10. Lik.kont. ne shumen 955 080 leke ose 100 %.	1.Lertida Balili, Kryetare 2.Hanke Suçi, Anëtare 3.Elda Isakaj, Anëtare	1.Elona Lipivani, Juriste 2.Flora Shakaj, Anetare 3.Elvera Pitarka, Anetare

Nga verifikimi i dokumentave ne dosjen perkatese dhe sistemin elektronik per kete tender, rezultoi se:

I. Lidhur me përlllogaritjen e vlerës të kontratës.

Me Urdherin e Kryetarit te Autoritetit Kontraktor Nr.54 date 11.05.2017 eshte ngritur Njesia e Prokurimit te ciles i eshte ngarkuar si detyre edhe hartimi i specifikimeve teknike dhe perlllogaritja e fondit limit. Ne mbeshtetje te urdherit te mesiperem, komisioni i ngritur per kete qellim ka hartuar specifikimet teknike dhe ka bere argumentimin e fondit limit duke i pasqyruar ne procesverbalin Nr.1 date 11/05/2017.

Ne procesverbalin e mbajtur nga NjP thuhet se perlllogaritja e fondit limit eshte bere duke u bazuar ne kontratat e mepareshme te se njejtës natyre, nuk thuhet se kujt kontrate konkretisht te cilit viti/e mbi bazen e te cilave jane bere llogaritjet perkatese. Thjeshte eshte evidentuar se Fondi limit do te jete ne vleren 1 066 667 leke pa tvsh dhe 1 280 000 leke me tvsh.

**RAPORT FINAL AUDITIMI
GJYKATA E APELIT TIRANË**

Sipas RPPP per vitin 2017, derguar me shkresen nr.73, date 30.01.2017 dhe nr.85/14 prot. date 23.11.2017 nga ZABGJ ne AK "Gjykata Apelit Tirane", fondi limit i pergjithshem per "Blerje Paisje Mobilje" eshte parashikuar ne vleren 1 400 000 leke me tvsh. Ne fakt ky fond eshte prokuruar ne dy pjese. Ne procesverbalin e perlllogaritjes te fondit limit dhe ne urdherin e prokurimit nuk jepen arsyet e coptimit te fondit te parashikuar per tu prokuruar me proceduren e prokurimit "Kerkese per propozim" ne muajin mars dhe prokurimi i pjeses tjeter te ketij fondi me proceduren e prokurimit "Me vlere te vogel".

II. Mbi hartimin e dokumentave të tenderit.

Njesia e Prokurimit e ngritur me urdherin Nr.54 date 11.05.2017 ka hartuar procesverbalin Nr.2 date 11.05.2017 "Hartimi i dokumentave te tenderit". Bazuar ne dokumentat standart te APP-se janë plotesuar kriteret e kualifikimit, ku përfshihen (kriteret e pergjitheshme dhe kriteret e vecanta te kualifikimit: kapaciteti ligjore, ekonomik dhe financiar dhe teknik) ne perputhje me legjislacionin e prokurimit publik.

Në zbatim të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, VKM nr.914 date 29/12/2014 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik". Dokumentat e tenderit pasi jane firmosur nga te gjithe anetaret e NjP, se bashku me njoftimin e kontrates jane derguar ne forme elektronike per tu publikuar, ne faqen zyrtare te internetit te APP-se dhe ne Buletinin e APP-se. Nga personi i autorizuar per te kryer veprimet ne sistemin elektronik jane ftuar per te marre pjese ne kete procedure prokurimi 5 (pese) operatore ekonomik. Njoftimi i kontrates eshte publikuar ne faqen zyrtare te APP ne daten 12.05.2017 dhe ne Buletinin e APP-se nr.19, date 15 Maj 2017.

III. Mbi vlerësimin e ofertave dhe përzgjedhjen e ofertës fituese.

Me Urdherin nr.55 Prot. date 11/05/2017 eshte ngritur KVO-ja. Sipas Njoftimit te kontrates te publikuar ne faqen e internetit te APP-se dhe shpallur ne Buletinin e kesaj te fundit, tenderi eshte zhvilluar ne daten 23.05.2017.

Anetaret e KVO-se kane hyre ne sistemin elektronik ne daten dhe oren e caktuar sipas njoftimit te publikuar ne faqen e internetit te APP-se. Ne mbeshtetje te procesverbalit Nr.3 date 23.05.2017 rezultojne te kene paraqitur oferta ne menyre elektronike 6 OE:

Ne mbeshtetje te procesverbalit Nr.4, date 25.05.2017 "Per shqyrtimin dhe vleresimin e ofertave". Nga shqyrtimi i dokumentacionit ligjor-teknik-administativ dhe ofertave ekonomike te paraqitura/dorezuara nga OE pjesmarres ne kete procedure prokurimi, eshte vleresuar si oferte e sukseshme oferta e paraqitur nga shoqeria "SHAGA" shpk, ne vleren me te ulet 795 900 leke pa tvsh. Njoftimi i klasifikimit ne sistemin elektronik eshte bere ne daten 25.05.2017.

Mbas perfundimit te afateve te ankimimit KVO-ja ka hartuar Raportin permbledhes ne daten 02/06/2017 per Kryetarin e AK per te miratuar proceduren e shqyrtimit, vleresimit dhe krahasimit te ofertave si dhe shpalljen e fituesit per oferten me te favorshme te paraqitur nga shoqeria "SHAGA" shpk, ne vleren me te ulet 795 900 leke pa tvsh.

Po ne daten 02.06.2017 eshte bere Njoftim Fituesit, publikuar ne Buletinin e APP-se.

IV. Në lidhje me zbatimin e kontrates të ofertuesit fitues në proceduren e prokurimit.

Eshte hartuar procesverabli nr.78/2 prot. Date 14.06.2017 per verifikimin dhe marrjen ne dorezim te dokumentacionit, administrativ-ligjor, ekonomik e financiar dhe teknik te tenderit me objekt prokurimi "Blerje Paisje Mobilje" te paraqitura nga shoqeri e shpallur fituese "SHAGA" shpk.

Nga verifikimi dhe krahasimi i dokumentacionit te paraqitur ne menyre shkresore me dokumentacionin e paraqitur nga shoqeria e shpallur fituese "SHAGA" shpk ditën e zhvillimit te tenderit, elektronikisht per kete procedure prokurimi nuk rezultuan ndryshime dhe mungesa ne dokumentacion.

**RAPORT FINAL AUDITIMI
GJYKATA E APELIT TIRANË**

Mbas sigurimit te kontrates ne masen 10% te vleres nga shoqeria e shpallur fituese "SHAGA" shpk është lidhur Kontrata nr.77 prot. date 19.06.2017 me objekt "Blerje Paisje Mobilje", ne vleren 795 900 leke pa tvsh dhe 955 080 leke me tvsh.

Po ne daten 19.06.2017 eshte derguar Njoftimi i kontrates te nenshkruar per tu publikuar ne Buletinin e APP-se, rezulton te jete publikuar nga kjo e fundit.

Malli eshte marre ne dorezim nga komisioni i ngritur per kete qellim me urdher te vecante te nxjerre nga Kryetari i AK.

Dosja e tenderit eshte sistemuar, inventarizuar, protokolluar dhe arkivuar ne Arkiven e Gjykates.

2. Tenderi i zhvilluar ne rruge elektronike me objekt "Sherbimi i Ruajtjes dhe i sigurise fizike me Roje private", per periudhen 19.02.2017 - 31.12.2017 (315 dite), me vlere mujore 180 531 leke pa tvsh, per 1 vend roje me 3.5 roje/muaj, me pjesmarrje ne konkurim te 23 OE, te kualifikuar 19 dhe te skualifikuar 4, me 1(nje) ankese ne AK dhe 1(nje) ne KPP per dokumentat e tenderit. Me 5(pese) ankesa ne AK per klasifikimin dhe vleresimin e ofertave dhe 1(nje) ne KPP dhe me te dhena te tjera si me poshte:

Të dhëna të përgjithshme për tenderin:

Të dhëna për tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e prokurimit
A	B	C
1.Urdhër Prokurimi Nr.12/1 Prot. Datë 16.02.2017 2.Fondi limit -pa tvsh 1 870 019.41 leke. -me tvsh 2 244 023.29 leke, per periudhen 19.02.2017 - 31.12.2017. 3.Pr.Prok. "Kerkese per propozim", me EL. 4.Data e zhvillimit te tenderit 27.02.2017, ora 11.0 5.Ftesa per oferte 5 operatorë ekonomikë. 6.Fituesi "ARBANA" sh.p.k. 7.Data e lidhjes te kontratës 02.05.2017. 8.Vlera e kontratës 1 591 182.77 leke me tvsh, per periudhen 02.05.2017 - 31.12.2017. 9.Difer. mes f. limit e kont. # lekë me tvsh. 10.Lik. kontratës kontratës # leke,ose 100 %.	1.Lertida Balili, Kryetare 2.Hanke Suçi, Anëtare 3.Elda Isakaj, Anëtare	1.Elona Lipivani, Juriste 2.Flora Shakaj, Anetare 3.Elvira Pitarka, Anetare

Nga verifikimi i dokumentave ne dosjen perkatese dhe sistemin elektronik per kete tender, rezultoi se:

I. Lidhur me përlogaritjen e vlerës së kontratës.

Sipas RPPP per sherbimin e sigurise dhe ruajtjes se godine derguar nga ZABGJ-se me shkresen nr.73 prot. date 30.01.2017 ka qene parashikuar fondi limit i pergjithshem ne vleren 2 600 mije leke me tvsh, shtuar/ndryshuar me shkresen nr.85/14 prot. date 23.11.2017 ne vleren 2 700 mije leke me tvsh, per vitin 2017.

Njesia e prokurimit e ngritur me Urdherin Nr.12 prot. date 16.02.2017, ka hartuar specifikimet teknike si dhe ka bere perlllogaritjen e vleres te kontrates duke i pasqyruar ne Procesverbalin nr.1, date 16/02/2017 ne te cilin evidentohet perlllogaritja e vleres limit te kontrates dhe specifikimet teknike/termat e references per kete procedure prokurimi, per periudhen 19/02/2017 - 31/12/2017. Fondi limit i llogaritur eshte ne vleren 1 870 019.41 leke pa tvsh, per 1 vend roje, me 3.5 roje ose 51 580.31 leke pa tvsh ne muaj per nje roje, 180 531.08 leke pa tvsh, per nje muaj ne nje vend roje(3.5 roje x 51 580.31 leke).

Perlllogaritja e fondit limit nga NjP nuk eshte bere ne perputhje me rekomandimet e KPP dhe APP te dates 06.02.2017. Per te gjitha procedurat e prokurimit te shpallura mbas dates 13.02.2017, perlllogaritja e vleres limit te kontrates duhet te behej sipas rekomandimeve te KPP dhe APP. Kjo bazuar ne njoftimin e APP-se, derguar AK me shkresen nr.2511/1 date 07.02.2017. Konkretisht ne

**RAPORT FINAL AUDITIMI
GJYKATA E APELIT TIRANË**

perlllogaritjen e fondit limit nuk duhet te perfshiheshin shpenzimet per armatim, nderlidhje dhe veshje ne vleren 4 223.68 leke/roje ne muaj ose 14 782.88 leke ne muaj per 1(nje) vendroje.

II. Mbi hartimin e dokumentave të tenderit.

Në Urdhër Prokurim Nr.12/1, Prot. datë 16/02/2017 është përcaktura që procedura e prokurimit të jetë “Kerkese per propozim”. Njesia e prokurimit e ngritur me Urdherin Nr.12 prot. date 16.02.2017, ne Procesverbalin nr.2 te dates 16/02/2017 ka argumentuar vendosjen e kriterëve per kualifikim, ku përfshihen (kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomik, kapaciteti ekonomik dhe financiar, kapaciteti teknik si dhe kriteret e përgjithshme të kualifikimit të përcaktuara në DST dhe në legjislacionin e prokurimit publik.

Mbas përfundimit të hartimit dhe miratimit të dokumentave te tenderit nga NjP, në zbatim të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, VKM-se nr.914, date 29.12.2014 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit” i ndryshuar, personi i autorizuar eshte futur ne sistemin elektronik, ka hedhur Njoftimin e kontrates dhe dokumentat e tenderit, si dhe jane ftuar 5 OE per te marre pjese ne kete procedure prokurimi. Publikuar ne faqen zyrtare te APP ne daten 17/02/2017 dhe botuar ne Buletinin e APP-se, Nr.7, date 20 shkurt 2017.

Ne daten 21.02.2017 nga Shoqeria “Start 2000” shpk eshte bere ankese ne lidhje me kerkesat e vendosura per kualifikim nga NjP, protokolluar ne gjykate me nr.781 Prot. date 21.02.2017, ankimuesi pretendon se koficienti i llogaritur 3.5 roje per nje vendroje nuk eshte i sakte pasi duhet te jete 3.9 roje per nje vendroje, si dhe vertetimi per gjendjen financiare ne banka 5 dite perpara hapjes te procedures, ankimuesi pretendon se afati duhet te jete 28 dite perpara. Per keto arsye ankimuesi ka kerkuar pezullimin e procedures te prokurimit, ndryshimin e koficientit te rojeve per nje vendroje dhe i kerkeses per gjendjen financiare ne banke.

Me urdherin e Kryetarit te AK Nr.830 Prot. date 22.02.2017 eshte pezulluar procedura e prokurimit, eshte caktuar KVO-ja per shqyrtimin e ankeses. Me shkresen nr.823 Prot. date 23.02.2017 eshte kthyer pergjigja per OE “STAR 2000” shpk, duke mos marre parasyshe asnjë nga kerkesat e bera.

III.Mbi vlerësimin e ofertave dhe përzgjedhjen e ofertës fituese.

Me Urdherin nr.12/2, Prot. date 16/02/2017 eshte ngritur KVO-ja, kjo e fundit, ne mbeshtetje te njoftimit te kontrates ka mbyllur afatin e dorëzimit të ofertave në datën 27/02/2017.

Ne mbeshtetje te Procesverbalit Nr.3, date 27.02.2017 “Hapja e procedures”, rezulton te kene marre pjese ne konkurim 23 OE.

Shoqeria “STAR 2000” shpk e ka vijuar ankesen ne KPP, kjo e fundit me vendimin nr.293/1 Prot., date 27.02.2017 ka urdheruar AK per pezullimin e procedures te prokurimit. Me nr. 23/1., date 28.02.2017, AK ka pezulluar procedure e prokurimit deri ne shqyrtimin dhe marrjen e vendimit perfundimtare nga KPP.

KPP me vendimin nr.106/2017 ka vendosur te mos pranoje ankesen e bere nga OE “STAR - 2000”shpk, te lejoje AK te vazhdoje me hapat e metejshe me te procedures te prokurimit.

Ne procesverbalin Nr.5, date 13.03.2017 “Shqyrtimi dhe vleresimi i ofertave” eshte pasqyruar shqyrtimi i dokumentave administrativ, ligjor, ekonomiko-financiar, teknik te paraqitur nga OE pjesmarres. Nga KVO-ja jane kualifikuar 19 OE dhe skualifikuar 4 ofertuesit e tjere. Mbas klasifikimit perfundimtar ne sistemin elektronik date 15.03.2017 eshte bere ankese ne daten 21.03.2017 nga OE “Myrto Security” shpk, protokolluar ne gjykate me nr.1031 Prot. date 23.03.2017 ne gjykate, nga OE pretendohet se nga 6 OE nuk jne respektuar kerkesat e percaktuara ne Dokumentat e Tenderit dhe aktet ligjore dhe nenligjore ne fuqi. Me shkresen nr.35 Prot. date 23.03.2017 eshte pezulluar procedura e prokurimit, eshte caktuar komisioni per shqyrtimin e ankeses. Me shkresen nr.1031/1 prot. date 23.03.2017 eshte kthyer pergjigja ankimuesit, duke mos marre parasyshe asnje nga pretendimet e tij.

Po keshtu nga OE “DEA SECURITY” shpk eshte bere ankese ne daten 20.03.2017, protokolluar ne daten 20.03.2017 ne gjykate me nr.5293 Prot. Me shkresen nr.37 Prot. Date 29.03.2017 eshte

**RAPORT FINAL AUDITIMI
GJYKATA E APELIT TIRANË**

pezulluar procedura e prokurimit, eshte caktuar komisioni per shqyrtimin e ankeses. Me shkresen nr.1132/1 prot. date 30.03.2017 eshte kthyer pergjigja ankimesit, duke shpjeguar sqarimet e kerkuara ne KPP me shkresen nr.1159 Prot. Date 30.03.2017 per vendosjen e tre shifrove mbas presjes dhjetore. Nga KPP me shkresen nr.5208/1 Prot. Date 13.04.2017 eshte kthyer pergjigja se KVO ka perfunduar fazen e rivleresimit dhe mund te vazhdoje me fazen tjeter "Njoftim Fituesit"

Sistemi lejon kuotimin deri ne tre shifra pas pikes, duke bere me pas automatikisht konvertimin. Ne mbeshtetje te Procesverbalit Nr.6, date 04.04.2017 nga KVO-ja eshte bere rivleresimi i ofertave dhe OE "DEA SECURITY" shpk eshte i renditur i 17-i.

Po keshtu nga OE "Nazeri 2000" eshte bere ankesa ne daten 20.03.2017, protokolluar ne gjykate po ne daten 20.03.2017 me nr. 5293 prot. Me shkresen nr.38 Prot. date 29.03.2017 eshte pezulluar procedura e prokurimit, eshte caktuar komisioni per shqyrtimin e ankeses. Me shkresen nr. 1132/1 prot. date 30.03.2017 eshte kthyer pergjigja ankimesit, nuk jane marre parasyshe pretendimet e tij. Ankesat e bera nga OE "Nazeri 2000" shpk dhe "Dea Security" shpk jane dorezuar nje here ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Tirane dhe nga aty jane derguar zyrtarisht ne Gjykatën e Apelit Tirane.

Prane AK jane bere ankesa edhe nga OE "Aulona Pol 1" shpk dhe "Resi-03" shpk, ankesat jane shqyrtuar brenda afateve ligjore.

OE "Nazeri 2000" shpk e ka vijuar ankesen e tij ne KPP, date 07.04.2017, kjo e fundit me Vendimin Nr.224/2017 ka vendosur te mos pranoje ankesen e bere, duke lejuar AK te vazhdoje proceduren e prokurimit.

KVO-ja ka hartuar Raporti permbledhes ne daten 18.04.2017 per Kryetarin e AK per te miratuar proceduren e shqyrtimit, vleresimit dhe krahasimit te ofertave si dhe shpalljen e fituesit per oferten me te favorshme te paraqitur nga shoqeria "Arbana" sh.a , me vlere me te ulet 165 748.20 leke/muaj, ne nje vendroje me 3.5 roje.

Ne daten 18.04.2017 eshte bere Njoftim Fituesit per OE "Arbana" sh.a. Publikuar ne Buletinin e APP-se nr.16 date 24 Prill 2017.

IV. Në lidhjen dhe zbatimin e kontrates të ofertuesit fitues në procedurën e prokurimit

Nga Titullari i Gjykeses Apelit Tirane, është lidhur Kontrata me Nr. 48 Prot. datë 02/05/2017 me Shoqerine "ARBANA" sha, ne vleren 1 325 985.64 leke pa tvsh dhe 1 591 182.77 leke me tvsh, me vlere mujore 165 748.20 leke pa tvsh, per 1 vendroje me 3.5 roje ne muaj per periudhen 02/05/2017 - 31/12/2017.

Sigurimi i kontrates eshte bere ne daten 02.05.2017, ne shumen 159 184 leke, 10% te vleres. Nga KVO-ja nuk eshte hartuar nje procesverbal i vecante apo flete inventari ku te pasqyrohen te gjitha dokumentat e dorezuara nga OE i shpallur fitues.

Nga OE i shpallur fitues nje pjese e dokumentave jane dorezuar mbas lidhjes te kontrates, kjo sipas vertetimit noterjal nr.2103 Rep. date 10.05.2017, kontrata eshte lidhur ne daten 02.05.2017. Nga ana e AK eshte bere Njoftimi i Kontrates te nenshkruar, botuar ne Buletinin e APP-se Nr.22 te dates 06 Qershor 2016.

Nuk eshte hartuar dhe miratuar Rregullorja e Brendshme "Per ruajtjen dhe sigurimin fizik te objektit", kjo jo ne perputhje me DST dhe kontraten e lidhur.

Nga ana e AK nuk eshte nxjerre Urdheri i Brendshem per ngritjen e komisionit te mbikqyrjes se zbatimit te Kontrates Nr. 48 Prot. datë 02/05/2017 me Shoqerine "ARBANA" sha.

Kjo jo ne perputhje me nenin 77, pika 3 te VKM-se nr.914, date 29.12.2014 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik"..... "Për t'u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës dhe në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë.....".

**RAPORT FINAL AUDITIMI
GJYKATA E APELIT TIRANË**

Dosja e tenderit është inventarizuar, protokolluar dhe arkivuar, në përputhje me nenin 30, të Udhëzimit “Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë” miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave në zbatim të nenit 3 e 29 të Ligjit nr.9154, datë 06.11.2003, “Për Arkivat”.

3. Tenderi i zhvilluar ne sistemin elektronik me objekt prokurimi “Blerje Tonera per Printer dhe Fotokopje”, realizuar ne vitin 2017, me pjesmarrije ne konkurim te 6(gjasht) operatoreve ekonomik, te kualifikuar 2(dy) dhe te skualifikuar 4(kater), pa asnje ankese dhe me te dhena te tjera si me poshte:

Të dhëna të përgjithshme për tenderin:

Të dhëna për tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e prokurimit
A	B	C
1.Urdhër Prokurimi Nr. 33 Prot. Datë 17.03.2017. 2.Fondi limit -pa tvsh 2 083 383 leke. -me tvsh 2 500 000 leke. 3.Pr.Prok. “Kerkese per propozim“, me El. 4.Data e zhvillimit te tenderit 04.04.2017,ora 11.00 5.Ftesa per oferte 5 operatorë ekonomikë. 6.Fituesi “Mond Office” sh.p.k. 7.Data e lidhjes te kontratës 08.05.2017. 8.Vlera e kontratës 2 086 872 leke me tvsh. 9.Difer. mes f. limit e kont. 413 128 lekë me tvsh. 10.Lik. kontratës 2 086 872 leke, ose 100 %.	1.Lertida Balili, Kryetare 2.Hanke Suci, Anëtare 3.Elda Isakaj, Anëtare	1.Elona Lipivani, Juriste 2.Flora Shakaj, Anetare 3.Elvira Pitarka, Anetare

Nga verifikimi i dokumentave ne dosjen perkatese dhe sistemin elektronik per kete tender, rezultoi se:

I. Lidhur me përlllogaritjen e vlerës së kontratës.

Njesise se Prokurimit te ngritur me urdherin e Kryetarit te AK, nr.32, prot. date 17.03.2017 i eshte ngarkuar si detyre dhe hartimi i specifikimeve teknike dhe perlllogaritja e fondit limit. Ne mbeshtetje te urdherit te mesiperm, komisioni ka hartuar procesverbalin Nr.1 te dates 17.03.2017 ne te cilin ka pasqyruar perlllogaritjen e vleres limit te kontrates dhe specifikimet teknike. Perlllogaritja e fondit limit eshte bere ne baze te testimit te tregut dhe kontratave te mepareshme te lidhura nga AK per keto artikuj. Sipas evidentimeve ne procesverbalin e dates 17.03.2017, fondi limit per “Blerje Tonera” eshte perlllogaritur ne vleren 2 083 383 leke pa tvsh dhe 2 500 059 leke me tvsh, bazuar ne ofertat e marra ne treg nga OE:

1. “Colombo” sh.p.k, me vlere oferte 2 083 383 leke pa tvsh dh 2 500 059 leke me tvsh.
2. Denis Vlesha, PF, me vlere oferte 2 108 667 leke pa tvsh dhe 2 530 400 leke me tvsh.
3. Floriar Arapi, PF, me vlere oferte 2 092 667 leke pa tvsh dhe 2 511 200 leke me tvsh.

Per llogaritjen e fondit limit eshte marre oferta me vlere me te ulet e paraqitur nga OE “Colombo” shpk ne shumen 2 083 383 leke pa tvsh dh 2 500 059 leke me tvsh. Nuk eshte marre/llogaritur si mesatare e tre ofertave.

Sipas RPPP per vitin 2017, derguar nga ZABGJ me shkresen nr.73, date 30.01.2017 ne AK “Gjykata Apelit Tirane”, fondi limit i pergjithshem per “Blerje Tonera” eshte parashikuar ne vleren 2 500 000 leke me tvsh, po aq sa eshte llogaritur dhe pasqyruar nga NjP ne procesverbalin e mesiperm.

II. Mbi hartimin e dokumentave të tenderit.

Me Urdherin nr.32, prot. date 17.03.2017 eshte ngritur NjP e njejte me ate te shenuar ne Urdhër Prokurimi Nr.33 Prot. datë 17.03.2017 ku eshte përcaktura që procedura e prokurimit të jetë “Kerkese per propozim”. Ne Procesverbalin Nr.2 date 17.03.2017 jane pasqyruar kriteret per kualifikim sipas natyres dhe vellimit te kontrates. Në referim të DST nga NjP janë vendosur kriteret e kualifikimit, ku përfshihen (kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomik, kapaciteti ekonomik dhe financiar, kapaciteti

**RAPORT FINAL AUDITIMI
GJYKATA E APELIT TIRANË**

teknik si dhe kriteret e përgjithshme të kualifikimit të përcaktuara në DST dhe në legjislacionin e prokurimit publik.

Në zbatim të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, VKM-se nr.914, date 29.12.2014 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit” i ndryshuar, personi i autorizuar per te kryer veprimet ne sistemin elektronik eshte futur ne sistem, ka hedhur dokumentat e tenderit bashke me njoftimin e kontrates si dhe ka ftuar 5(pese) OE per te marre pjese ne kete procedure prokurimi.

Njoftimi i kontrates eshte botuar ne Buletinin e APP-se Nr.7, date 22 Shkurt 2016.

III. Mbi vlerësimin e ofertave dhe përzgjedhjen e ofertës fituese.

Me Urdherin nr.33/1, Prot, date 17.03.2017 eshte ngritur KVO-ja, kjo e fundit, ka mbyllur afatin e dorëzimit të ofertave në datën 04/04/2017.

Bazuar ne Procesverbalit Nr.3 date 04/04/2017 “Hapja e procedures” me objekt “Blerje Tонера” ne kete procedure prokurimi kane paraqitur oferta ne menyre elektronike 6(gjashte) OE;

Sipas procesverbalit Nr.4, date 07.04.2017 “Shqyrtimi dhe vleresimi i ofertave”, KVO-ja mbas vleresimit te dokumentave ligjore, administartiv, teknik dhe financiar te paraqitur nga OE pjesmarres ne proceduren “Kerkese per propozim” me objekt prokurimi “Blerje Tонера per Printera dhe fotokopje” ka kualifikuar 2(dy) OE dhe skualifikuar 4(kater). KVO-ja ka vleresuar si oferte te sukseshme, oferten e paraqitur nga OE “Mond office” sh.p.k ne vleren 1 739 060 leke pa tvsh. Njoftimi i klasifikimit eshte bere ne daten 07.04.2017.

Nga KVO-ja eshte hartuar Raporti permbledhes per Kryetarin e AK, ku ky i fundit vihet ne dijeni ne lidhje me zhvillimin e procedures te prokurimit me objekt “Blerje Tонера” dhe i propozohet per miratimin e procedures dhe shpalljen fitues te ofertes te paraqitur nga OE “Mond office” sh.p.k ne vleren 1 739 060 leke pa tvsh, si oferte e sukseshme.

Njoftimi i fitusit eshte derguar per tu publikuar ne faqen e APP-se ne daten 18.04.2017, publikuar ne Buletinin e APP-se Nr.16, date 24 Prill 2017.

IV. Në lidhjen dhe zbatimin e kontrates të ofertuesit fitues në proceduren e prokurimit.

Nuk eshte mbajtur procesverabli ne lidhje dorezimin dhe shqyrtimin e dokumentacionit administrativ-ligjor, teknik dhe financiar te tenderit me objekt “Blerje Tонера” nga shoqeria e shpallur fituese.

Nga AK është lidhur Kontrata Nr. 52 Prot. datë 08/05/2017 me OE “Mond Office” sh.p.k, ne vleren 1 739 060 leke pa tvsh dhe 2 086 872 leke me tvsh.

Nga AK eshte bere Njoftimi i Kontartes te nenshkruar, publikuar ne Buletinin e APP-se Nr.19, date 15 Maj 2017.

Komisioni i ngritur me urdher te vecante te Kryetarit AK, ka marre ne dorezim mallin e furnizuar nga shoqeria “Mond Ofifice”sh.p.k, ne perputhje me kontraten e lidhur.

Dosja e tenderit eshte inventarizuar, protokolluar dhe arkivuar, në përputhje me nenin 30, të Udhëzimit “Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë”, miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave në zbatim të nenit 3 e 29 të Ligjit nr.9154, datë 06.11.2003, “Për Arkivat”.

4. Tenderi i zhvilluar ne platformen elektronike me objekt “Blerje karburanti” me 2 Lote, realizuar ne vitin 2017, me pjesmarrje ne konkurim te 2 OE, per Lotin e I-re, 2(dy) te kualifikuar dhe per Lotin e II-te, 1(nje) te kualifikuar, pa asnje ankese dhe me te dhena te tjera si ne tabelen e meposhme:

**RAPORT FINAL AUDITIMI
GJYKATA E APELIT TIRANË**

Të dhëna të përgjithshme për tenderin:

Të dhëna për tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e prokurimit
A	B	C
1. Urdhër Prokurimi Nr.49 date 08.05.2017. 2. Fondi limit - pa tvsh 2 083 334 leke. - Loti i 1, blerje Gazoili D1 1 809 734 leke. - Loti i 2, blerje Benzine pa plumb 273 600 leke. - me tvsh 2 500 000 leke. 3. Pr.Prok. "Kerkese per Propozim", me EL. 4. Data e zhvillimit te tenderit 22.05.2017. 5. Morën pjesë në tender 2 OE. 6. Fituesi: Loti I-re - "EROIL" sh.a Loti II-te - "KASTRATI" sh.p.k. 7. Data e lidhjes te kontratës 19.06.2017. 8. Vlera e kontratës: - L.1 per Gazoil D1, 2 171 680 leke pa tvsh. - L.2 per Benzin, ##### leke pa tvsh. 9. Diferenca me fondin limit # lekë pa tvsh. 10. Lik.kont. ne shumen # leke ose 100 %.	1.Lertida Balili, Kryetar 2.Hanke Suci, Anëtare 3.Elda Isakaj, Anëtar	1.Elona Lipivani, Juriste 2.Flora Shakaj, Anetare 3.Elvira Pitarka, Anetare

Nga verifikimi i dokumentave ne dosjen perkatese dhe sistemin elektronik per kete tender, rezultoi se:

I. Lidhur me përlogaritjen e vlerës të kontratës.

Me Urdherin e Kryetarit te Autoritetit Kontraktor Nr.50 Prot. date 08.05.2017 eshte ngritur Njesia e Prokurimit te ciles i eshte ngarkuar si detyre edhe hartimi i specifikimeve teknike dhe perlogaritja e fondit limit. Ne mbeshtetje te urdherit te mesiperem, komisioni i ngritur per kete qellim ka hartuar specifikimet teknike dhe ka bere argumentimin e fondit limit duke i pasqyruar ne procesverbalin Nr.1 date 08/05/2017.

Perlogaritja e fondit limit nuk eshte vleresuar bazuar ne cmimet e karburantit te publikuara ne Buletinin e fundit te Njoftimeve Publike te APP-se, por ne cmimet e publikura ne daten 14.02.2017 (Diezel 10ppm: 169 leke/liter dhe Benzine 95: 172 leke/liter). Procesverbali per llogaritjen e fondit limit eshte hartuar ne daten 08.05.2017 per gjithe vitin, konkretisht per 1920 litra benzin, ne vleren 273 600 leke pa tvsh dhe 328 320 leke me tvsh dhe 12927 litra nafte ne vleren 1 809 734 leke pa tvsh dhe 2 171 680 leke me tvsh, perkatesisht 142.5 leke/liter dhe 140 leke/liter pa tvsh. Per te dy artikujt bashke fondi limit i llogaritur nga NjP eshte vleresuar ne shumen 2 500 000 leke me tvsh.

Sipas RPPP per vitin 2017, derguar nga ZABGJ me shkresen nr.73, date 30.01.2017 ne AK "Gjykata Apelit Tirane", fondi limit i pergjithshem per "Blerje Karburant dhe vaj" eshte parashikuar ne vleren 2 500 000 leke me tvsh, po aq sa eshte llogaritur nga NjP ne procesverbalin e lartepemendur.

II. Mbi hartimin e dokumentave të tenderit.

Njesia e Prokurimit e ngritur me urdherin Nr.49 date 08.05.2017 ka hartuar procesverbalin Nr.2 date 08.05.2017 "Mbi hartimin e dokumentave te tenderit". Bazuar ne dokumentat standart te APP-se janë plotesuar kriteret e kualifikimit, ku përfshihen (kriteret e pergjitheshme, kriteret e vecanta dhe kapaciteti ekonomik dhe financiar) ne perputhje me legjislacionin e prokurimit publik.

Ne dokumentat e tenderit shtojca Nr.10 eshte kerkur qe furnizimi me karburant do te kryhet me tollona, nuk eshte percaktuar qe furnizimi do te behet sipas SHËRBIMIT TË KARTAVE ELEKTRONIKE të furnizimit në zbatim të VKM nr 561 datë 29.07.2016 "Për standartizimin dhe disiplinimin e shërbimit të karburantit në Njësitë e Qeverisjes se Pergjithshme".

Në zbatim të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, VKM nr.914 date 29/12/2014 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik". Dokumentat e tenderit pasi jane

**RAPORT FINAL AUDITIMI
GJYKATA E APELIT TIRANË**

firnosur nga te gjithë anetaret e NjP, se bashku me njoftimin e kontrates jane derguar ne forme elektronike per tu publikuar, ne faqen zyrtare te internetit te APP-se dhe ne Buletinin e APP-se. Nga personi i autorizuar per te kryer veprimet ne sistemin elektronik jane ftuar per te marre pjese ne kete procedure prokurimi 5 (pese) operatore ekonomik. Njoftimi i kontrates eshte publikuar ne Buletinin e APP-se nr.19, date 15 Maj 2017.

III. Mbi vlerësimin e ofertave dhe përzgjedhjen e ofertës fituese.

Me Urdherin nr.51 Prot. date 08/05/2017 eshte ngritur KVO-ja. Sipas Njoftimit te kontrates te publikuar ne faqen e internetit te APP-se dhe shpallur ne Buletinin e kesaj te fundit, tenderi eshte zhvilluar ne daten 22.05.2017.

Anetaret e KVO-se kane hyre ne sistemin elektronik ne daten dhe oren e caktuar sipas njoftimit te publikuar ne faqen e internetit te APP-se. Ne mbeshtetje te procesverbalit Nr.3 date 22.05.2017 rezultojne te kene paraqitur oferta ne menyre elektronike OE:

Per Lotin I-re:

1. "Kastrati" shpk, me marzh fitimi 8.7% per Gazoil D1.
2. "EROIL" shpk, me marzh fitimi te shprehur ne perqindje 8.6 % per Gazoil D1.

Per Lotin II-te:

1. "Kastrati" shpk, me marzh fitimi 9.7% per Benzin pa plumb 10ppm.

Ne mbeshtetje te procesverbalit Nr.4, date 25.05.2017 "Per shqyrtimin dhe vleresimin e ofertave". Nga shqyrtimi i dokumentacionit ligjor-teknik-administartiv dhe ofertave ekonomike te paraqitura/dorezuara nga OE pjesmarres ne kete procedure prokurimi, eshte vleresuar si oferte e sukseshme per Lotin I-re oferta e paraqitur nga shoqeria "EROIL" shpk, me marzh fitimi te shprehur ne perqindje 8.6 % per Gazoil D1 dhe per Lotin II-te shoqeria "Kastrati" sh.p.k me marzh fitimi 9.7% per Benzin pa plumb 10ppm.

Mbas mbarimit te afateve te ankimimit nga ana e KVO-se ne daten 02.06.2017 eshte pregaditur raporti permbledhes per proceduren e shqyrtimit, vleresimit dhe krahasimit te ofertave per miratimin e kualifikimin per Lotin I-re te shoqerise "EROIL" shpk, me marzh fitimi te shprehur ne perqindje 8.6 % per Gazoil D1 dhe per Lotin II-te te shoqerise "Kastrati" sh.p.k me marzh fitimi 9.7% per Benzin pa plumb 10ppm.

Formulari i Njoftimit te Fituesit eshte derguar per tu publikuar ne faqen e internetit te APP-se ne daten 02.06.2017, publikuar ne Buletinin e APP-se Nr.23, date 12 Qershor 2017.

IV. Në lidhje me zbatimin e kontrates të ofertuesit fitues në proceduren e prokurimit.

Nga ana e KVO-se nuk eshte hartuar procesverabli per verifikimin e dokumentacionit administrativ, ligjor dhe teknik te tenderit me objekt prokurimi "Blerje Karburanti" te paraqitur ne menyre shkresore nga shoqeria e shpallura fituese: "EROIL" sh.p.k per Lotin e I-re, perpara lidhjes te kontrates.

Nga verifikimi dhe krahasimi i dokumentacionit te paraqitur ne menyre shkresore me dokumentacionin e paraqitur nga shoqeria e shpallura fituese, ditën e zhvillimit te tenderit, elektronikisht per kete procedure prokurimi nuk rezultuan ndryshime dhe mungesa ne dokumentacion e paraqitur nga shoqeria e shpallur fituese "EROIL" sh.p.k per Lotin e I-re.

Shoqeria "Kastrati" sh.p.k e shpallur fituese per Lotin e II-te "Blerje Benzine" nuk eshte paraqitur per te lidhur kontraten. Ne kerkesat per kualifikim nuk eshte kerkuar sigurimi i ofertes (jo e domosdoshme per kete procedure prokurimi sipas ndryshimeve ne VKM) per rrjedhoje ndaj operatorit ekonomik te shpallur fitues per lotin e dyte nuk eshte zbatuar asnje saksion. Duke qene OE i vetem qe eshte kualifikuar per kete lot, nuk eshte bere e mundur kalimi tek operatori i dyte. Per rrjedhoje procedura e prokurimit per lotin e 2-te, me objekt prokurimi "Blerje Benzine"ka deshtuar.

Nga AK është lidhur Kontrata me objekt "Blerje Karburanti" per Lotin e I-re: Blerje Gazoil D1(Eurodizel) 10PPM, me Nr. 76 Prot. datë 19.06.2017, per 12 927 litra nafte, ne vleren 1 809 734 leke pa tvsh, me marzh fitimi 8.6 %.

**RAPORT FINAL AUDITIMI
GJYKATA E APELIT TIRANË**

Sic e theksuam edhe me larte ne kontraten e lidhur eshte parashikuar qe furnizimi do te behet me tollona dhe jo me karte elektronike. Ne kontraten e lidhur pasqyrohet vetem vlera pa tvsh, nuk evidentohet vlera me tvsh, sa/si dhe eshte bere likujdimi.

Ne dosje mungon autorizimi/urdheri i Titullarit per monitorimin e zbatimit te kontrates dhe sigurimi i kontrates (eshte bashkangjitur Ush).

Dosja e tenderit eshte inventarizuar, protokolluar dhe arkivuar, në përputhje me nenin 30, të Udhëzimit “Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë”, miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave në zbatim të nenit 3 e 29 të Ligjit nr.9154, datë 06.11.2003, “Për Arkivat”.

Sipas RPPP, procedura e prokurimit eshte parashikuar te zhvillohet gjate muajit janar-shkurt, ne fakt ka nisur ne muajin maj dhe ka perfunduar ne muajin qershor.

Per vitin 2016

1. Tenderi i zhvilluar ne platformen elektronike me objekt **“Blerje karburanti” me 2 Lote**, realizuar ne vitin 2016, me pjesmarrje ne konkurim te 3(tre) OE per Lotin e I-re dhe 3(tre) OE per Lotin 2, te kualifikuar 3(tre) per Lotin 1 dhe 3(tre) per Lotin 2-te, asnje te skualifikuar, pa asnje ankese dhe me te dhena te tjera si ne tabelen e meposhme:

Të dhëna të përgjithshme për tenderin:

Të dhëna për tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e prokurimit
A	B	C
1. Urdhër Prokurimi Nr.63 date 30.03.2016. 2. Fondi limit - pa tvsh 1 893 334 leke. - Loti i 1, blerje Gazoili D1 1 666 667 leke. - Loti i 2, blerje Benzine 226 667 leke. - me tvsh 2 272 000 leke. 3. Pr.Prok. “Kerkese per Propozim”, me EL. 4. Data e zhvillimit te tenderit 11.04.2016. 5. Morën pjesë në tender 3 OE. 6. Fituesi: Loti I-re - “KASTRATI” sha. Loti II-te - “KASTRATI” sha. 7. Data e lidhjes te kontratës 26.04.2016. 8. Vlera e kontratës: - L.1 per Gazoil D1, 1 666 667 leke pa tvsh. - L.2 per Benzin, 226 667 leke pa tvsh. 9. Diferenca me fondin limit 0 lekë pa tvsh. 10. Lik.kont. ne shumen # leke ose 100 %.	1.Lertida Balili, Kryetare 2.Hanke Suci, Anëtare 3.Briselda Xhelo, Anëtare	1.Eglli Haxhiraj, Jurist 2.Flora Shakaj, Anetare 3.Elvira Pitarka, Anetare

Nga verifikimi i dokumentave ne dosjen perkatese dhe sistemin elektronik per kete tender, rezultoi se:

I. Lidhur me përlllogaritjen e vlerës të kontratës.

Me Urdherin e Kryetarit te Autoritetit Kontraktor Nr.64 Prot. date 30.03.2016 eshte ngritur Njesia e Prokurimit te ciles i eshte ngarkuar si detyre edhe hartimi i specifikimeve teknike dhe perlllogaritja e fondit limit. Ne mbeshtetje te urdherit te mesiperem, komisioni i ngritur per kete qellim ka hartuar specifikimet teknike dhe ka bere argumentimin e fondit limit duke i pasqyruar ne procesverbalin Nr.1 date 31.03.2016.

Perlllogritja e fondit limit eshte vleresuar bazuar ne cmimet e publikura ne daten 29.02.2016 (Diezel 10ppm:153 leke/liter dhe Benzine 95: 154 leke/liter). Procesverbali per llogaritjen e fondit limit eshte hartuar ne daten 31.03.2016 per gjithe vitin, konkretisht per 12500 litra Nafte, ne vleren 1 666 667 leke pa tvsh dhe 2 000 000 leke me tvsh dhe 1700 litra Benzin ne vleren 226 667 leke pa tvsh dhe 272 000 leke me tvsh, perkatesisht 142.5 leke/liter pa tvsh dhe 140 leke/liter pa tvsh. Per te

**RAPORT FINAL AUDITIMI
GJYKATA E APELIT TIRANË**

dy artikujt bashke fondi limit i llogaritur nga NjP eshte vleresuar ne shumen 1 893 334 leke pa tvsh dhe 2 272 000 leke me tvsh.

Jane planifikuar 80 litra benzin per 1(nje) motorr, 960 litra ne vit, per te dy motorrat 160 litra benzin ne muaj qe i takon 1920 litra benzin ne vit per te dy motorrat. Planifikimi i karburantit per motorrat eshte bere ne baze te normatives te harxhimit 3.5 litra/100 km. Ne vleresimin e grupit te auditimit kjo normative duhet te rishikohet. Po keshtu jane parashikuar 240 litra Gazoil D1 per gjeneratorin, 7392 litra per sistemin e ngrohjes. Ne total 12 500 litra Nafte dhe 1 700 litra Benzin. Sipas RPPP, i ndryshuar per vitin 2016, derguar nga ZABGJ me shkresen nr.83/4, date 12.04.2016 ne AK "Gjykata Apelit Tirane", fondi limit i pergjithshem per "Blerje Karburant dhe vaj" eshte parashikuar ne vleren 2 700 mije leke me tvsh.

II. Mbi hartimin e dokumentave të tenderit.

Ne Urdherin e Prokurimit Nr.63 Prot. Date 30.03.2016 nuk eshte percaktura qe procedura e prokurimit do te jete me 2 Lote.

Njesia e Prokurimit e ngritur me urdherin Nr.64 date 30.03.2016 ka hartuar procesverbalin Nr.2 date 31.03.2016 "Mbi hartimin e dokumentave te tenderit". Bazuar ne dokumentat standart te APP-se jane plotesuar kriteret e kualifikimit, ku përfshihen (kriteret e pergjitheshme, kriteret e vecanta dhe kapaciteti ekonomik dhe financiar) ne perputhje me legjislacionin e prokurimit publik.

Në zbatim të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, VKM nr.914 date 29/12/2014 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik". Dokumentat e tenderit pasi jane firmosur nga te gjithe anetaret e NjP, se bashku me njoftimin e kontrates jane derguar ne forme elektronike per tu publikuar, ne faqen zyrtare te internetit te APP-se dhe ne Buletinin e APP-se. Nga personi i autorizuar per te kryer veprimet ne sistemin elektronik jane ftuar per te marre pjese ne kete procedure prokurimi 5 (pese) operatore ekonomik te pa miratuar/argumentuar me pare ne procesverbalin e hartimit te dokumentave te tenderit. Njoftimi i kontrates per Lotin I-re "Blerje Gazoil D1 (Eurodizel) 10 PPM" eshte publikuar ne Buletinin e APP-se nr.13, date 04 Prill 2016 dhe per Lotin 2 "Blerje Benzine pa plumb 10 PPM" eshte publikuar ne Buletinin e APP-se nr.14, date 11 Prill 2016, ne ditën qe eshte zhvilluar procedura e prokurimit per kete lot.

III. Mbi vlerësimin e ofertave dhe përzgjedhjen e ofertës fituese.

Me Urdherin nr.65 Prot. date 30/03/2016 eshte ngritur KVO-ja. Sipas Njoftimit te kontrates te publikuar ne faqen e internetit te APP-se dhe shpallur ne Buletinin e kesaj te fundit, tenderi eshte zhvilluar ne daten 11.04.2016.

Anetaret e KVO-se kane hyre ne sistemin elektronik ne daten dhe oren e caktuar sipas njoftimit te publikuar ne faqen e internetit te APP-se. Ne mbeshtetje te procesverbalit Nr.3 date 11.04.2016 "Hapja e procedures te prokurimit", rezultojne te kene paraqitur oferta ne menyre elektronike OE:

Per Lotin I-re "Blerje Gazoil D1 (Eurodizel) 10 PPM" :

1. "Kastrati" shpk, me marzh fitimi 8.9%.
2. "Bolv-oil" shpk, me marzh fitimi 10.44 % .
3. "A\$T" shpk, me marzh fitimi 11.8 %.

Per Lotin II-te "Blerje Benzine pa plumb 10 PPM" :

1. "Kastrati" shpk, me marzh fitimi 8.9%.
2. "Bolv-oil" shpk, me marzh fitimi 11.89 % .
3. "A\$T" shpk, me marzh fitimi 11.8 %.

Ne mbeshtetje te procesverbalit Nr.4, date 13.04.2016 "Per shqyrtimin dhe vleresimin e ofertave". Nga shqyrtimi i dokumentacionit ligjor-teknik-administartiv dhe ofertave ekonomike te paraqitura/dorezuara nga OE pjesmarres ne kete procedure prokurimi, eshte vleresuar si oferte e sukseshme per Lotin I-re oferta e paraqitur nga shoqeria "Kastrati" sha, me marzh fitimi te shprehur ne

**RAPORT FINAL AUDITIMI
GJYKATA E APELIT TIRANË**

perqindje 8.9 % per Gazoil D1 dhe per Lotin II-te shoqeria "Kastrati" sha me marzh fitimi 8.9% per Benzin pa plumb 10ppm. Njoftimi i klasifikimit ne sistemin elektronik eshte bere ne daten 13.04.2016. Mbas mbarimit te afateve te ankimimit nga ana e KVO-se ne daten 21.04.2016 eshte pregaditur raporti permbledhes per proceduren e shqyrtimit, vleresimit dhe krahasimit te ofertave per miratimin e kualifikimin per Lotin I-re te shoqerise "Kastrati" shpk, me marzh fitimi te shprehur ne perqindje 8.9 % per Gazoil D1 dhe per Lotin II-te te shoqerise "Kastrati" sh.p.k me marzh fitimi 8.9 % per Benzin pa plumb 10ppm.

Formulari i Njoftimit te Fituesit eshte derguar per tu publikuar ne faqen e internetit te APP-se ne daten 21.04.2016. Njoftimi i fituesit eshte publikuar ne Buletinin e APP-se Nr.16, date 25 Prill 2016.

IV. Në lidhje me zbatimin e kontrates të ofertuesit fitues në proceduren e prokurimit. Nga ana e KVO-se nuk eshte hartuar procesverabli per verifikimin e dokumentacionit administrativ, ligjor dhe teknik te tenderit me objekt prokurimi "Blerje Karburanti" te paraqitur nga shoqeria e shpallura fituese: "Kastrati" sh.a per te dyja Lotet.

Nga verifikimi dhe krahasimi i dokumentacionit te paraqitur ne menyre shkresore me dokumentacionin e paraqitur nga shoqeria e shpallur fituese: "Kastrati" sh.a per te dyja Lotet, ditën e zhvillimit te tenderit, elektronikisht per kete procedure prokurimi nuk rezultuan ndryshime dhe mungesa ne dokumentacion e paraqitur nga shoqeria "Kastrati" sh.a e shpallur fituese.

Ne daten 26.04.2016 me operatorin ekonomik "Kastrati" sh.a i shpallur fitues per te dyja Lotet eshte lidhur kontrata e furnizimit me 12 500 litra Nafte, me marzh fitimi te shprehur ne perqindje 8.9 % dhe 1700 litra Benzin me marzh fitimi te shprehur ne perqindje 8.9 %.

Njoftimi i kontrates te nenshkruar per Lotin 1 "Blerje Gazoil D1(Eurodizel) 10PPM" esht bere ne daten 26.04.2016, publikuar ne Buletinin e APP-se nr.17, date 03 Maj 2016.

Njoftimi i kontrates te nenshkruar per Lotin 2 "Blerje Benzine pa plumb 10PPM" eshte bere ne daten 26.04.2016, publikuar ne Buletinin e APP-se nr.17, date 03 Maj 2016.

Ne dosje mungon autorizimi/urdheri i Titullarit per monitorimin e zbatimit te kontrates dhe sigurimi i kontrates (eshte bashkangjitur Ush).

Dosja e tenderit eshte inventarizuar, protokolluar dhe arkivuar, në përputhje me nenin 30, të Udhëzimit "Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë", miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave në zbatim të nenit 3 e 29 të Ligjit nr.9154, datë 06.11.2003, "Për Arkivat".

2. Tenderi i zhvilluar ne sistemin elektronik me objekt prokurimi "Blerje Tонера per Printer dhe Fotokopje", realizuar ne vitin 2016, me pjesmarrje ne konkurim te 6(gjasht) operatoreve ekonomik, te kualifikuar 2(dy) dhe te skualifikuar 4(kater), pa asnje ankese dhe me te dhena te tjera si me poshte:

Të dhëna të përgjithshme për tenderin:

Të dhëna për tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e prokurimit
A	B	C
1.Urdhër Prokurimi Nr. 55 Prot. Datë 23.03.2016. 2.Fondi limit -pa tvsh 2 000 000 leke. -me tvsh 2 400 000 leke. 3.Pr.Prok. "Kerkese per propozim", me El. 4.Data e zhvillimit te tenderit 11.04.2016,ora 11. 5.Ftesa per oferte 5 operatorë ekonomikë. 6.Fituesi "Erison Company" sh.p.k. 7.Data e lidhjes te kontratës 18.05.2016. 8.Vlera e kontratës 1 955 760 leke me tvsh vsh. 9.Difer. mes f. limit e kont. 444 240 lekë me tvsh. 10.Lik. kontratës 1 955 760 leke, ose 100 %.	1.Lertida Balili,Kryetare 2.Hanke Suci, Anëtare 3.Briselda Xhelo,Anëtare	1.Egli Haxhiraj, Juriste 2.Flora Shakaj, Anetare 3.Elvira Pitarka, Anetare

**RAPORT FINAL AUDITIMI
GJYKATA E APELIT TIRANË**

Nga verifikimi i dokumentave ne dosjen perkatese dhe sistemin elektronik per kete tender, rezultoi se:

I. Lidhur me përlogaritjen e vlerës së kontratës.

Njesise se Prokurimit te ngritur me urdherin e Kryetarit te AK, nr.56, prot. date 23.03.2016 i eshte ngarkuar si detyre dhe hartimi i specifikimeve teknike dhe perlllogaritja e fondit limit. Ne mbeshtetje te urdherit te mesiperm, komisioni i ngritur per kete qellim ka hartuar procesverbalin Nr.1 te dates 23.03.2016 ne te cilin ka pasqyruar perlllogaritjen e vleres limit te kontrates dhe specifikimet teknike. Perlllogaritja e fondit limit eshte bere ne baze te testimit te tregut.

Fondi limit i perlllogaritur nga NjP per proceduren e prokurimit “Kerkese per propozim” me objekt “Blerje Tонера per Printer dhe Fotokopje” eshte 2 000 000 (dy milion) leke pa TVSH, po aq sa eshte parashikuar ne RPPP i ndyeshuar per vitin 2016, derguar nga ZABGJ me shkresen nr.83/4 date 12.04.2016.

II. Mbi hartimin e dokumentave të tenderit.

Me Urdherin nr.56, prot. date 23.03.2016 eshte ngritur NjP e njejte me ate te shenuar ne Urdhër Prokurimi Nr.55 Prot. datë 23.03.2016 ku eshte përcaktura që procedura e prokurimit të jetë “Kerkese per propozim”. Ne Procesverbalin Nr.2 date 23.03.2016 jane vendosur kriteret per kualifikim sipas natyres dhe vellimit te kontrates. Në referim të DST nga NjP janë vendosur kriteret e kualifikimit, ku përfshihen (kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomik, kapaciteti ekonomik dhe financiar, kapaciteti teknik si dhe kriteret e përgjithshme të kualifikimit të përcaktuara në DST dhe në legjislacionin e prokurimit publik.

Në zbatim të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, VKM-se nr.914, date 29.12.2014 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit” i ndryshuar, personi i autorizuar per te kryer veprimet ne sistemin elektronik eshte futur ne sistem, ka hedhur dokumentat e tenderit bashke me njoftimin e kontrates si dhe ka ftuar 5(pese) OE per te marre pjese ne kete procedure prokurimi.

Njoftimi i kontrates eshte botuar ne Buletinin e APP-se Nr.12, date 29 Mars 2016.

Ne daten 29.03.2016, nga OE “Infosoft office” shpk eshte bere kerkese per sqarim ne lidhje me dokumentat e tenderit. Per rrjedhoje procedura e prokurimit eshte pezulluar ne daten 31.03.2016, eshte kthyer pergjigja kerkusit dhe eshte bere shtojca per modifikimin e dokumentave te tenderit, e cila eshte hedhur ne sistemin elektronik, si dhe eshte shtyre afati i zhvillimit te procedures prokurimit ne daten 11.04.2016.

III. Mbi vlerësimin e ofertave dhe përzgjedhjen e ofertës fituese.

Me Urdherin nr.57 Prot, date 23.03.2016 eshte ngritur KVO-ja, kjo e fundit, ka mbyllur afatin e dorëzimit të ofertave në datën 11/04/2016.

Ne mbeshtetje te Procesverbalit Nr.3 date 11/04/2016 “Hapja e procedures” me objekt “Blerje Tонера” ne kete procedure prokurimi kane paraqitur oferta ne menyre elektronike 5(pese) OE; Ne procesverbal evidentohet se oferta e OE “Erisoni Company” ka probleme ne hapjen e ofertes, nga AK eshte bere kerkese ne APP ne lidhje me problemin e hazur, nga kjo e fundit pergjigja eshte dhene pasi eshte zgjidhur problemi nga Sp.IT te AK, duke bere te mundur hapjen e ofertes e cila nuk ka qene e dekuruar.

Ne daten 14.04.2014 ne mbeshtetje te kerkeses te bere me mesazh nga sistemi elektronik nga AK kane depozituar mostrat 3(tre) OE.

Sipas procesverbalit Nr.4, date 18.03.2016 “Shqyrtimi dhe vleresimi i ofertave”(muaji lapsus), KVO-ja mbas vleresimit te dokumentave ligjore, administartiv, teknik dhe financiar te paraqitur nga OE pjesmarres ne proceduren “Kerkese per propozim” ka kualifikuar 3(tre) OE dhe skualifikuar 2(dy) OE. Skualifikimi i ketyre dy OE eshte bere per arsye se nuk kane depozituar mostrat e mallrave prane AK gjate fazes te vleresimit te ofertave, megjithese oferta e paraqitur nga OE “Mondi office” shpk

RAPORT FINAL AUDITIMI GJYKATA E APELIT TIRANË

eshte me e ulta, ne vleren 1 513 110 leke pa tvsh, eshte skualifikuar. KVO-ja ka vleresuar si oferte te sukseshme, oferten e paraqitur nga OE "Erison Company" sh.p.k ne vleren 1 629 800 leke pa tvsh.

Kerkesa e AK per depozitim e mostrave te mallit nga OE konkrues gjate fazes te vleresimit te ofertave eshte disi e egzagjeruar. Pasi kjo kerkesa ka te beje me cilesine e mallit te kerkuar dhe se mund te eliminohet ne momentin e marrjes ne dorezim te mallit. Ne se malli i furnizuar nga OE i shpallur fitues, nuk eshte ne perputhje me specifikimet teknike te kerkuara, nuk merret ne dorezim. Perfshirja ne kerkesat per kualifikim e certifikates te origjines se mallit dhe certifikates te cilesise ISO dhe mos kerkimi i mostrave te mallit gjate fazes te vleresimit te ofertave do te shtonte konkurencen ndermjet OE konkrues, si dhe do te rriste pjesmarrjen e OE ne kete procedure prokurimi.

OE te shpallur fitues ne dosjen fizike i mungon Vertetimi nga nje banke per gjendjen financiare, e cila duhet te jete jo me pak se 10 % e fondit limit, ne sistem eshte i hedhur ky dokument.

Per cilesine e mallit eshte vetem nje deklarate e OE qe malli eshte brenda Standarteve Europiane, nuk jane katalogjet e produkteve te kerkuara, sebashku me karakteristikat e mallit te kerkuar etj.

Ne dosje gjithashtu mungon procesverbali i kthimit te mostarve OE te kualifikuar por jo fitues.

Njoftimi i klasifikimit eshte bere ne daten 18.04.2016.

Ne dosje mungon Raporti permbledhes per Kryetarin e AK, ku ky i fundit duhet te vihet ne dijeni ne lidhje me zhvillimin e procedures te prokurimit me objekt "Blerje Tонера" dhe ti propozohet per miratimin e procedures dhe shpalljen fitues te ofertes te paraqitur nga OE "Erison Company" sh.p.k ne vleren 1 629 800 leke pa tvsh, si oferte e sukseshme.

Njoftimi i fitusit eshte derguar per tu publikuar ne faqen e APP-se ne daten 26.04.2016, publikuar ne Buletinin e APP-se Nr.17, date 03 Maj 2016.

IV. Në lidhjen dhe zbatimin e kontrates të ofertuesit fitues në proceduren e prokurimit.

Nuk eshte mbajtur procesverabli ne lidhje me dorezimin dhe shqyrtimin e dokumentacionit administrativ-ligjor, teknik dhe financiar te tenderit me objekt "Blerje Tонера" nga shoqeria e shpallur fituese "Erisoni Company" sh.p.k.

Ne dosjen fizike mungon sigurimi i kontrates (eshte bashkangjitur Ush ne lidhjen e bankes).

Nga AK është lidhur Kontrata Nr. 1972 Prot. datë 18/05/2016 me OE "Erisoni Company" shpk sh.p.k, ne vleren 1 629 800 leke pa tvsh dhe 1 955 760 leke me tvsh.

Nga AK eshte bere Njoftimi i Kontartes te nenshkruar ne daten 18.05.2016 ne APP, publikuar nga kjo e fundit ne Buletinin Nr.19, date 15 Maj 2016.

Ne dosjen fizike mungon urdheri i nxjerre nga Kryetari i AK per mbikqyrjen dhe zbatimin e kontrates me objekt "Blerje Tонера per Printer dhe Fotokopje" lidhur midis Gjykates Apelit Tirane dhe shoqerise "Erisoni Company" shpk.

Dosja e tenderit eshte inventarizuar, protokolluar dhe arkivuar, në përputhje me nenin 30, të Udhëzimit "Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë", miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave në zbatim të nenit 3 e 29 të Ligjit nr.9154, datë 06.11.2003, "Për Arkivat".

Per vitin 2015:

1. Tenderi i zhvilluar ne sistemin elektronik me objekt prokurimi "**Blerje Paisje Elektronike**", realizuar ne vitin 2015, me pjesmarrje ne konkurim te 5(pese) operatoreve ekonomik, te kualifikuar 4(kater) dhe te skualifikuar 1(nje), me 1(nje) ankese ne AK dhe 1(nje) ankese ne KPP per klasifikimin dhe vleresimin e ofertave dhe me te dhena te tjera si me poshte:

Të dhëna të përgjithshme për tenderin:

**RAPORT FINAL AUDITIMI
GJYKATA E APELIT TIRANË**

Të dhëna për tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e prokurimit
A	B	C
1.Urdhër Prokurimi Nr. 90/1 Prot.Datë 23.03.2015. 2.Fondi limit -pa tvsh 1 416 667 leke. -me tvsh 1 700 000 leke. 3.Pr.Prok. “Kerkese per propozim“, me El. 4.Data e zhvillimit te tenderit 06.04.2015,ora 11.00 5.Ftesa per oferte 5 operatorë ekonomikë. 6.Fituesi “BNT Elektroniks” sh.p.k. 7.Data e lidhjes te kontratës 30.06.2015. 8.Vlera e kontratës 1 531 354 leke me tvsh. 9.Difer. mes f. limit e kont. 168 646 lekë me tvsh. 10.Lik. kontratës 1 531 354 leke, ose 100 %.	1.Arber Kushe, Kryetar 2.Hanke Suci, Anëtare 3.Erlin Hajdini, Anëtar	1.Egli Haxhiraj, Juriste 2.Aurora Bardhi, Anetare 3.Elvira Pitarka, Anetare

Nga verifikimi i dokumentave ne dosjen perkatese dhe sistemin elektronik per kete tender, rezultoi se:

I. Lidhur me përlogaritjen e vlerës së kontratës.

Njesise se Prokurimit te ngritur me urdherin e Kryetarit te AK, nr.90, prot. date 23.03.2015 i eshte ngarkuar si detyre dhe hartimi i specifikimeve teknike dhe perlllogaritja e fondit limit. Ne mbeshtetje te urdherit te mesiperm dhe kerkesave te bera nga Specialistet e IT-se ne daten 23.01.2015 dhe 28.01.2015 dhe te miratuara nga kancelari, komisioni ka hartuar procesverbalin Nr.1 te dates 25.03.2015 ne te cilin ka pasqyruar perlllogaritjen e vleres limit te kontrates dhe specifikimet teknike. Perlllogaritja e fondit limit nga NjP eshte bere ne baze te testimi te tregut. Ne procesverbalin e dates 25.03.2015 evidentohet: fondi limit per tenderin me procedure prokurimi “Kerkese per propozim” dhe objekt “Blerje paisje elektronike” do te jete 1 416 667 leke pa tvsh eshte vene ne dispozicion nga buxheti i shtetit per vitin 2015 ”.

Vertete ne RPPP per vitin 2015, derguar me shkresen e ZABGJ-se nr.54, date 04.02.2015 ne AK “Gjykata Apelit Tirane”, fondi limit i pergjithshem per “Blerje Paisje elektronike” eshte parashikuar ne vleren 1 416 667 leke pa tvsh dhe 1 700 000 leke me tvsh, po aq sa eshte llogaritur nga NjP ne procesverbalin e mesiperm.

Ne RPPP per vitin 2015 eshte derguar fondi limit i pergjithshem i parashikuar dhe nuk mund te sherbeje apo perdoret si Fond Limit per proceduren e prokurimit qe do te zhvillohet nga AK, ky i fundit duhet te perlllogaritet nga NjP ose komision i vecante perpra nxjerrjes te Urdher Prokurimi nga Kryetari i AK.

Nuk konstatohen diferenca midis fondit limit te pergjithshem te parashikuar ne RPPP me fondin limit te perlllogaritur nga NjP dhe fondit te prokuruar nga AK.

II. Mbi hartimin e dokumentave të tenderit.

Ne Urdherin nr.90, prot. date 23.03.2015 eshte ngritur NjP e njejte me ate te shenuar ne Urdhër Prokurimi Nr.90/1 Prot. datë 23.03.2015 ku eshte përcaktura që procedura e prokurimit të jetë “Kerkese per propozim”. Ne Procesverbalin Nr.2 date 25.03.2015 jane vendosur kriteret per kualifikim sipas natyres dhe vellimit te kontrates. Në referim të DST nga NjP janë vendosur kriteret e kualifikimit, ku përfshihen (kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomik, kapaciteti ekonomik dhe financiar, kapaciteti teknik si dhe kriteret e përgjithshme të kualifikimit të përcaktuara në DST dhe në legjislacionin e prokurimit publik.

Në zbatim të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, VKM-se nr.914, date 29.12.2014 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit” i ndryshuar, personi i autorizuar per te kryer veprimet ne sistemin elektronik eshte futur ne sistem, ka hedhur dokumentat e tenderit bashke me njoftimin e kontrates dhe ka ftuar 5(pese) OE per te marre pjese ne kete procedure prokurimi.

**RAPORT FINAL AUDITIMI
GJYKATA E APELIT TIRANË**

Njoftimi i kontrates nuk eshte nenshkruar nga Kryetari i AK perpara se te dergohet per tu publikuar ne sistemin elektronik te APP-se.

NjP nuk ka miratuar 5 OE qe do te ftohen per te marre pjese ne kete procedure prokurimi perpara se te kryhen veprimet ne sistemin elektronik nga personi i autorizuar per te kryer veprimet ne sistemin elektronik.

Njoftimi i kontrates eshte botuar ne Buletinin e APP-se te dates 30 Mars 2015.

III. Mbi vleresimin e ofertave dhe përzgjedhjen e ofertës fituese.

Me Urdherin nr.90/2 Prot, date 23.03.2015 eshte ngritur KVO-ja, kjo e fundit, ka mbyllur afatin e dorëzimit të ofertave në datën 06/04/2015. Hapja e procedures te prokurimit ne sistemin elektronik eshte bere ne daten 07.04.2015 dhe jo ne daten 06.04.2015. Ne caktimin e dates te zhvillimit te tenderit NjP nuk ka pasur parasysh qe data e caktuar eshte dite pushimi. Megjithse sitemi nuk pranon oferta jashte afatit te percaktuar ne rubriken "Informacioni administrativ".

Ne mbeshetjet te Procesverbalit Nr.3 date 07/04/2015 "Hapja e procedures" me objekt "Blerje Tonera" ne kete procedure prokurimi kane paraqitur oferta ne menyre elektronike 5(pese) OE;

Sipas procesverbalit Nr.4, date 14.04.2015 "Shqyrtimi dhe vleresimi i ofertave", KVO-ja mbas vleresimit te dokumentave ligjore, administartiv, teknik dhe financiar te paraqitur nga OE pjesmarres ne proceduren "Kerkese per propozim" ka kualifikuar 3(tre) OE dhe skualifikuar 2(dy) OE. Skualifikimi i ketyre dy OE eshte bere per arsye se nuk kane permbushur kriteret e vecanta per kualifikim. Njoftimi i klasifikimit eshte bere ne daten 14.04.2015.

Ne daten 19.04.2015 eshte bere ankese nga OE " BNT Elektroniks", protokolluar ne gjykate me nr.1495, date 21.04.2015. OE pretendon se i ploteson te gjitha kerkesat per kualifikim dhe eshte skualifikuar padrejtesisht nga KVO-ja, ne ankese jane dhene te gjitha sqarimet e nevojshem qe argumentojne plotesimin e te gjitha specifikimeve teknike te kerkuara.

Me urdherin nr.107 Prot. Date 21.04.2015, procedura e prokurimit eshte pezulluar, dhe eshte ngritur komisioni per shqyrtimin e ankeses. Me shkresen nr.1564 prot. Date 23.04.2015 i eshte kthyer pergjigje OE "BNT Elektroniks", duke mos pranuar asnje nga pretendimet ne ankese. Nga ballafaqimi i argumentave te dhena ne ankesen e paraqitur nga OE "BNT Elektroniks" me pergjigjen e dhene nga AK, ne opinjon te grupit te auditimit; Komisioni ka analizuar dhe pregaditur pergjigjen e ankeses jo ne perputhje me kerkesat e Ligjit Nr. 9643 date 20.11.2006 i ndryshuar, neni 53 "Shqyrtimi i ofertave" pika 1 e tij ku parashikohet se "Autoriteti Kontraktor, kur e shikon te arsyeshme u kerkon sqarime per ofertat e tyre, per shqyrtimin, vleresimin dhe krahasimin sa me te drejte te ketyre ofertave".

OE "BNT Elektroniks" shpk duke mos qene dakort me pergjigjen e dhene nga AK, e ka vijuar ankesen ne KPP, me te njejten permbajtje, me nr.448 prot. Date 27.04.2015.

Me vendimin nr.772/1 date 30.04.2015, KPP ka pezullur proceduren e prokurimit dhe shqyrtimin ne themel te ankeses.

Me vendimin nr.336/2015, KPP ka vendosur te pranoje ankesen e OE "BNT Elektroniks" , ka urdheruar AK , qe te anulloje vendimin e KVO-se per skualifikimin e ketij OE dhe te korigjoe shkeljet e konstatuara, duke kualifikuar ate.

Nga KVO-ja eshte bere rivleresimi i ofertave, dokumentuar ne procesverbalin Nr.05 date 01.06.2015. KPP ka hequr pezullimin per proceduren e prokurimit "Kerkese per propozim", me fond limit 1 416 667 leke (pa tvsh), zhvilluar ne daten 06.04.2015.

Nga rivleresimi i bere KVO-ja ka vleresuar si oferte te sukseshme, oferten e paraqitur nga OE "BNT Elektroniks" sh.p.k ne vleren 1 276 128 leke pa tvsh.

Nga KVO-ja eshte hartuar Raporti permbledhes per Kryetarin e AK, ku ky i fundit eshte vene ne dijeni ne lidhje me zhvillimin e procedures te prokurimit me objekt "Blerje Paisje Elektronike" dhe i'eshte propozuar per miratimin e procedures dhe shpalljen fitues te ofertes te paraqitur nga OE "BNT Elektroniks" sh.p.k ne vleren 1 276 128 leke pa tvsh, si oferte e sukseshme.

**RAPORT FINAL AUDITIMI
GJYKATA E APELIT TIRANË**

Njoftimi i fitusit është derguar për tu publikuar në faqen e APP-se në datën 09.06.2015, publikuar në Buletinin e APP-se Nr.23, datë 15 Qershor 2015.

IV. Në lidhjen dhe zbatimin e kontratës të ofertuesit fitues në procedurën e prokurimit.

Nuk është mbajtur procesverbal në lidhje me dorezimin dhe shqyrtimin e dokumentacionit administrativ-ligjor, teknik dhe financiar të tenderit me objekt “Blerje Paisj Elektronike” nga shoqëria e shpallur fituese “BNT Elektroniks” sh.p.k.

Sigurimi i kontratës është bërë përpara lidhjes të kontratës, në datën 16.06.2015, në vlerën 153 135.4 leke.

Nga AK është lidhur Kontrata Nr. 146 Prot. datë 30.06.2015 me OE “BNT Elektroniks” shpk sh.p.k, në vlerën 1 276 128 leke pa tvsh dhe 1 531 354 leke me tvsh.

Nga AK është bërë Njoftimi i Kontartës të nënshkruar në datën 30.06.2015 në APP, publikuar nga kjo e fundit në Buletinin Nr.26, datë 06 Korrik 2015.

Sipas procesverbalit të datës 30.06.2015 malli është dorezuar nga përfaqësuesi “BNT Elektroniks” shpk dhe marrë në dorezim nga Gjykata e Apelit Tirane me akt-marrje në dorezim të datës 30.06.2014 (viti lapsus).

Dosja e tenderit është inventarizuar, protokolluar dhe arkivuar me nr.156 prot. datë 23.07.2015, në përputhje me nenin 30, të Udhëzimit “Norma Teknike Profesionale dhe Metodologjisë të shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë”, miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave në zbatim të nenit 3 e 29 të Ligjit nr.9154, datë 06.11.2003, “Për Arkivat”.

2. Tenderi i zhvilluar në sistemin elektronik me objekt prokurimi “Blerje Tонера për Printer dhe Fotokopje”, realizuar në vitin 2015, me pjesëmarrje në konkurim të 4(kater) operatoreve ekonomik, të kualifikuar 2(dy) dhe të skualifikuar 2(dy), pa asnjë ankese dhe me të dhëna të tjera si më poshtë:

Të dhëna të përgjithshme për tenderin:

Të dhëna për tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e prokurimit
A	B	C
1.Urdhër Prokurimi Nr. 61 Prot. Datë 04.03.2015. 2.Fondi limit -pa tvsh 1 916 667 leke. -me tvsh 2 300 000 leke. 3.Pr.Prok. “Kerkese për propozim”, me El. 4.Data e zhvillimit të tenderit 16.03.2015,ora 11.00 5.Ftesa për oferte 5 operatorë ekonomikë. 6.Fituesi “Infosoft Office” sh.p.k. 7.Data e lidhjes të kontratës 08.04.2015. 8.Vlera e kontratës 2 210 119 leke pa tvsh. 9.Difer. mes f. limit e kont. 89 881 lekë me tvsh. 10.Lik. kontratës 2 210 119 leke, ose 100 %.	1.Arber Kushe, Kryetar 2.Hanke Suci, Anëtare 3.Erlin Hajdini, Anëtar	1.Egli Haxhiraj, Juriste 2.Aurora Bardhi, Anetare 3.Elvira Pitarka, Anetare

Nga verifikimi i dokumentave në dosjen përkatëse dhe sistemin elektronik për këtë tender, rezultoi se:

I. Lidhur me përlogaritjen e vlerës së kontratës.

Njësia e Prokurimit e ngritur me urdherin e Kryetarit të AK, nr.60, prot. datë 04.03.2015 i është ngarkuar si detyrë dhe hartimi i specifikimeve teknike dhe përlogaritja e fondit limit. Në mbështetje të urdherit të mesiperm, komisioni ka hartuar procesverbalin Nr.1 të datës 04.03.2015 në të cilin ka pasqyruar përlogaritjen e vlerës limit të kontratës dhe specifikimet teknike. Përlogaritja e fondit limit është bërë në bazë të testimit të tregut. Sipas evidentimit në procesverbalin e datës 04.03.2015, fondi limit për tenderin me procedurë “Kerkese për propozim” dhe objekt “Blerje Tонера për Printer dhe

**RAPORT FINAL AUDITIMI
GJYKATA E APELIT TIRANË**

Fotokopje” do te jete 1 916 667 leke pa tvsh eshte vene ne dispozicion nga buxheti i shtetit per vitin 2015 ”.

Fondi limit i pergjithshem sipas parashikimit ne RPPP per vitin 2015, derguar nga ZABGJ me shkresen nr.54, date 04.02.2015 ne AK “Gjykata Apelit Tirane”, per “Blerje Tонера per Printer dhe Fotokopje” eshte parashikuar ne vleren 1 916 667 leke pa TVSH dhe 2 300 000 leke me tvsh, po aq sa eshte perlloritur Fondi limit nga NjP.

Nuk konstatohen diferenca midis fondit limit te pergjithshem te parashikuar ne RPPP me fondin limit te perlloritur nga NjP dhe fondit te prokuruar nga AK.

II. Mbi hartimin e dokumentave të tenderit.

Me Urdherin nr.60, prot. date 04.03.2015 eshte ngritur NjP e njejte me ate te shenuar ne Urdhër Prokurimi Nr.61 Prot. datë 04.03.2015 ku eshte përcaktura që procedura e prokurimit të jetë “Kerkese per propozim”. Ne Procesverbalin Nr.2 date 04.03.2015 jane vendosur kriteret per kualifikim sipas natyres dhe vellimit te kontrates. Në referim të DST nga NjP janë vendosur kriteret e kualifikimit, ku përfshihen (kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomik, kapaciteti ekonomik dhe financiar, kapaciteti teknik si dhe kriteret e përgjithshme të kualifikimit të përcaktuara në DST dhe në legjislacionin e prokurimit publik.

Në zbatim të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, VKM-se nr.914, date 29.12.2014 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar, personi i autorizuar per te kryer veprimet ne sistemin elektronik eshte futur ne sistem, ka hedhur dokumentat e tenderit bashke me njoftimin e kontrates si dhe ka ftuar 5(pese) OE per te marre pjese ne kete procedure prokurimi.

Njoftimi i kontrates nuk eshte nenshkruar nga Kryetari i AK perpara se te dergohet per tu publikuar ne sistemin elektronik te APP.

NjP nuk ka miratuar 5 OE qe do te ftohen per te marre pjese ne kete procedure prokurimi perpara se te kryhen veprimet ne sistemin elektronik nga personi i autorizuar per te kryer veprimet ne sistemin elektronik.

Njoftimi i kontrates eshte botuar ne Buletinin e APP-se te dates 09 Mars 2015.

Ne daten 09.03.2013, nga OE “Infosoft office” shpk eshte bere kerkese per sqarim ne lidhje me dokumentat e tenderit. Po ne daten 09.03.2015 nga AK eshte kthyer pergjigje ne sistemin elektronik kerkusit.

III. Mbi vlerësimin e ofertave dhe përzgjedhjen e ofertës fituese.

Me Urdherin nr.62 Prot, date 04.03.2015 eshte ngritur KVO-ja, kjo e fundit, ka mbyllur afatin e dorëzimit të ofertave në datën 16/03/2015.

Ne mbeshetje te Procesverbalit Nr.3 date 16/03/2015 “Hapja e procedures” me objekt “Blerje Tонера” ne kete procedure prokurimi kane paraqitur oferta ne menyre elektronike 4(kater) OE;

Sipas procesverbalit Nr.4, date 19.03.2015 “Shqyrtimi dhe vleresimi i ofertave”, KVO-ja mbas vleresimit te dokumentave ligjore, administativ, teknik dhe financiar dhe mostrave te produkteve te paraqitur nga OE pjesmarres ne proceduren “Kerkese per propozim” jane kualifikuar 2(dy) OE dhe skualifikuar 2(dy) OE. Skualifikimi i ketyre dy OE eshte bere per arsye se nuk kane plotesuar kerkesat per kualifikim te vendosura nga AK.

Ne dosjen e prokurimit mungon procesverbali i kthimit te mostrave OE te kualifikuar por jo fitues ne kete procedure prokurimi. Njoftimi i klasifikimit nga sistemi elektronik eshte bere ne daten 19.03.2015.

Oferta e paraqitur nga OE “Infosoft office” sh.p.k ne vleren 1 841 766 leke pa tvsh eshte klasifikuar ne vendin e pare ne renditje.

Mbas mbarimit te afateve te ankimimit nga KVO-ja eshte hartuar Raporti permbledhes per Kryetarin e AK, date 27.03.2015 ku ky i fundit vihet ne dijeni ne lidhje me zhvillimin e procedures te prokurimit

**RAPORT FINAL AUDITIMI
GJYKATA E APELIT TIRANË**

me objekt “Blerje Tонера” dhe i propozohet per miratimin e procedures dhe shpalljen fitues te ofertes te paraqitur nga OE “Infosoft Office” sh.p.k ne vleren 1 841 766 leke pa tvsh, si oferte e sukseshme. Njoftimi i fitusit eshte derguar per tu publikuar ne faqen e APP-se ne daten 27.03.2015, publikuar ne Buletinin e APP-se Nr.07 Prill 2015.

IV. Në lidhjen dhe zbatimin e kontrates të ofertuesit fitues në proceduren e prokurimit.

Nuk eshte mbajtur procesverabli ne lidhje me dorezimin dhe shqyrtimin e dokumentacionit administrativ-ligjor, teknik dhe financiar te tenderit me objekt “Blerje Tонера” nga shoqeria e shpallur fituese “Infosoft Office” sh.p.k.

Ne dosjen fizike mungon sigurimi i kontrates (eshte bashkangjitur Ush ne lidhjen e bankes).

Nga AK është lidhur Kontrata Nr. 102 Prot. datë 08/04/2015 me OE “Infosoft Office” sh.p.k ne vleren 1 841 766 leke pa tvsh dhe 2 210 119 leke me tvsh.

Njoftimi i Kontartes te nenshkruar eshte publikuar ne Buletinin e APP-se Nr.15, date 20 Prill 2015.

Ne dosje mungon urdheri per marrjen ne dorezim te mallit dhe zbatimin e kontrates me objekt “Blerje Tонера per Printer dhe Fotokopje” lidhur midis Gjykates Apelit Tirane dhe shoqerise “Infosoft Office” shpk.

Dosja e tenderit eshte inventarizuar, protokolluar dhe arkivuar me nr.156 prot. date 23.07.2015, në përputhje me nenin 30, të Udhëzimit “Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë”, miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave në zbatim të nenit 3 e 29 të Ligjit nr.9154, datë 06.11.2003, “Për Arkivat”.

Per vitin 2014

1. Tenderi i zhvilluar ne platformen elektronike me objekt “Blerje karburanti” me 2 Lote, realizuar ne vitin 2014, me pjesmarrje ne konkurim te 3(tre) OE per Lotin e I-re dhe 3(tre) OE per Lotin 2, te kualifikuar 2(dy) per Lotin 1 dhe 2(dy) per Lotin 2-te, 1(nje) te skualifikuar per Lotin e pare dhe te dYTE, pa asnje ankese dhe me te dhena te tjera si ne tabelen e meposhme:

Të dhëna të përgjithshme për tenderin:

Të dhëna për tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e prokurimit
A	B	C
1. Urdhër Prokurimi Nr.13 date 06.02.2014. 2. Fondi limit - pa tvsh 2 083 333 leke. - Loti i 1, blerje Gazoili D1 1 864 833 leke. - Loti i 2, blerje Benzine 218 500 leke. - me tvsh 2 500 000 leke. 3. Pr.Prok. “Kerkese per Propozim”, me EL. 4. Data e zhvillimit te tenderit 21.02.2014, ora 10.00. 5. Morën pjesë në tender 3 OE. 6. Fituesi: Loti I-re - “KASTRATI” sh a. Loti II-te - “KASTRATI” sha. 7. Data e lidhjes te kontratës 10.03.2014. 8. Vlera e kontratës: - L.1 per Gazoil D1, 1 864 833 leke pa tvsh. - L.2 per Benzin, 218 500 leke pa tvsh. 9. Diferenca me fondin limit 0 lekë pa tvsh. 10. Lik.kont. ne shumen ## leke ose 100 %.	1.Altin Gjana, Kryetar 2.Hanke Suci, Anëtare 3.Yllka Cika, Anëtare	1.Elona Lipivani, Jurist 2.Aurora Bardhi, Anetare 3.Elvira Pitarka, Anetare

Nga verifikimi i dokumentave ne dosjen perkatese dhe sistemin elektronik per kete tender, rezultoi se:

I. Lidhur me përlllogaritjen e vlerës të kontratës.

Nga Titullari i AK nuk ka dale urdheri i brendshem per ngritjen e komisionit per perlllogaritjen e fondit limit dhe hartimin e specifikimve teknike. Me Urdherin e Kryetarit te Autoritetit Kontraktor Nr.13 Prot. date 06.02.2014 eshte ngritur Njesia e Prokurimit, ne urdher nuk saketesohet qe ngarkohet kjo e fundit per hartimin e specifikimeve teknike dhe perlllogaritja e fondit limit. Argumentimi i fondit limit

**RAPORT FINAL AUDITIMI
GJYKATA E APELIT TIRANË**

eshte bere nga Kryetarja e Deges te Buxhetit, llogaritjet e bera jane pasqyruar ne nje tabele qe eshte bere pjese e dosjes te tenderit. Nuk ka nje procesverbal te vecante ku te jete pasqyruar menyra e pellogaritjes te fondit limit dhe hartimi i specifikimeve teknike, keto te fundit jane pjese e dosjes por te pa nenshkruara nga personi qe i ka hartuar apo siguruar.

Ne mbeshtetje te nevojave vjetore per karburant te pasqyruara ne tabelen e siperpermendur eshte llogaritur dhe fondi limit ne vleren 2 083 333 leke pa tvsh dhe 2 500 000 leke me tvsh, per 11 778 litra nafte dhe 1380 litra benzin (190 leke/liter per te dy artikujt).

Sic e trajtuam dhe me larte nuk evidentohet menyra e perlllogaritjes te fondit limit, nese eshte bazuar ne cmimet e publikura ne Buletinin e fundit te APP-se ose ne nje nga menytrat e parashikuara ne VKM.

Sipas RPPP per vitin 2014, derguar nga ZABGJ me shkresen nr. 42/1, date 07.02.2014 ne AK "Gjykata Apelit Tirane", fondi limit i pergjithshem per "Blerje Karburant dhe vaj" eshte parashikuar ne vleren 2 500 000 leke me tvsh, po aq sa eshte llogaritur nga K/D/Buxhetiti.

Nuk konstatohen diferenca midis fondit limit te pergjithshem te parashikuar ne RPPP me fondin limit te perlllogaritur nga K/D/Buxhetit dhe fondit te prokuruar nga AK.

II. Mbi hartimin e dokumentave të tenderit.

Njesia e Prokurimit e ngritur sipas Urdher Prokurimi Nr.13 date 06.02.2014 ka hartuar procesverbalin Nr.1 date 11.02.2014 "Mbi hartimin e dokumentave te tenderit". Ne procesverbalin e mbajtur nga NjP nuk argumentohen vendosja e kriterëve te pergjitheshme dhe te vecanta per kualifikim. Bazuar ne dokumentat standart te APP-se janë plotesuar kriteret e kualifikimit, ku përfshihen (kriteret e pergjitheshme, kriteret e vecanta dhe kapaciteti ekonomik dhe financiar) ne perputhje me legjislacionin e prokurimit publik.

Në zbatim të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, VKM nr.1 date 10.01.2007 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik". Dokumentat e tenderit pasi jane firmosur nga te gjithë anetaret e NjP, se bashku me njoftimin e kontrates (e pa nenshkruar nga K/AK) jane derguar ne forme elektronike per tu publikuar, ne faqen zyrtare te internetit te APP-se dhe ne Buletinin e APP-se. Nga personi i autorizuar per te kryer veprimet ne sistemin elektronik jane ftuar per te marre pjese ne kete procedure prokurimi 5 (pese) operatore ekonomik te pa miratuar/argumentuar me pare ne procesverbalin e hartimit te dokumentave te tenderit. Njoftimi i kontrates per Lotin I-re "Blerje Gazoil D1 (Eurodizel) 10 PPM" dhe per Lotin 2 "Blerje Benzine pa plumb 10 PPM" eshte publikuar ne Buletinin e APP-se te dates 17 Shkurt 2014.

III. Mbi vlerësimin e ofertave dhe përzgjedhjen e ofertës fituese.

Me Urdherin nr.14 Prot. date 06/02/2014 eshte ngritur KVO-ja. Sipas Njoftimit te kontrates te publikuar ne faqen e internetit te APP-se dhe shpallur ne Buletinin e kesaj te fundit, tenderi eshte zhvilluar ne daten 21.02.2014.

Anetaret e KVO-se kane hyre ne sistemin elektronik ne daten dhe oren e caktuar sipas njoftimit te publikuar ne faqen e internetit te APP-se. Ne mbeshtetje te procesverbalit Nr.2 date 21.02.2014 "Hapja e procedures te prokurimit", rezultojne te kene paraqitur oferta ne menyre elektronike OE:

Per Lotin I-re "Blerje Gazoil D1 (Eurodizel) 10 PPM" :

1. "Kastrati" shpk, me marzh fitimi 14.8 leke/liter.
2. "Bolv-oil" shpk, me marzh fitimi 13 leke/liter.
3. "A.K.F PETROLEUM" shpk, me marzh fitimi 11.99 leke/liter.

Per Lotin II-te "Blerje Benzine pa plumb 10 PPM" :

1. "Kastrati" shpk, me marzh fitimi 14.8 leke/liter.
2. "Bolv-oil" shpk, me marzh fitimi 16 leke/liter.
3. "A.K.F PETROLEUM" shpk, me marzh fitimi 20.7 leke/liter.

**RAPORT FINAL AUDITIMI
GJYKATA E APELIT TIRANË**

Ne mbeshetjetje te procesverbalit Nr.3, date 24.02.2014 "Per shqyrtimin dhe vleresimin e ofertave". Nga shqyrtimi i dokumentacionit ligjor-teknik-administartiv dhe ofertave ekonomike te paraqitura/dorezuara nga OE pjesmarres ne kete procedure prokurimi, eshte vleresuar si oferte e sukseshme per Lotin I-re oferta e paraqitur nga shoqeria "Bolvo-Oil" sha, me marzh fitimi te shprehur ne vlere absolute 13 leke/liter per Gazoil D1dhe per Lotin II-te shoqeria "Kastrati" sha me marzh fitimi 14.8 leke/liter per Benzin pa plumb 10ppm.

Njoftimi i klasifikimit ne sistemin elektronik eshte bere ne daten 24 .02.2014.

Mbas mbarimit te afateve te ankimimit nga ana e KVO-se ne daten 03.03.2014 eshte pregaditur raporti permbledhes per Titullarin, ne lidhje me proceduren e shqyrtimit,vleresimit dhe krahasimit te ofertave per miratimin e kualifikimin per Lotin I-re te shoqerise "Bolvo-Oil" shpk, me marzh fitimi te shprehur vlere absolute 13 leke/liter per Gazoil D1 dhe per Lotin II-te te shoqerise "Kastrati" sh.p.k me marzh fitimi 14.8 leke/liter per Benzin pa plumb 10ppm.

Formulari i Njoftimit te Fituesit eshte derguar per tu publikuar ne faqen e internetit te APP-se (pa u miratuar nga K/AK) ne daten 03.03.2014. Njoftimi i fituesit eshte publikuar ne Buletinin e APP-se te dates 10 Mars 2014.

IV. Në lidhje me zbatimin e kontrates të ofertuesit fitues në proceduren e prokurimit.

Nga ana e KVO-se nuk eshte hartuar procesverabli per verifikimin e dokumentacionit administrativ, ligjor dhe teknik te tenderit me objekt prokurimi "Blerje Karburanti" te paraqitur nga shoqeria e shpallura fituese: "Bolvi-Oil" per Lotin e 1-re dhe "Kastrati" sh.a per lotin e 2-te.

Nga verifikimi dhe krahasimi i dokumentacionit te paraqitur ne menyre shkresore me dokumentacionin e paraqitur nga shoqeria e shpallura fituese: "Bolvo-Oil" per Lotin e 1-re, ditën e zhvillimit te tenderit, elektronikisht per kete procedure prokurimi nuk rezultuan ndryshime dhe mungesa ne dokumentacionin e paraqitur.

Nga AK është lidhur Kontrata me shoqerine "Bolvo-Oil" sh.a me objekt "Blerje Karburanti" per Lotin e 1-te: Blerje Gazoil , me Nr. 48 Prot. datë 10.03.2014, ne vleren 1 864 833 leke pa tvsh, me tollona, sipas cmimit te botuar ne Buletinin e APP dhe marzhit te fitimit te ofruar nga furnizusi ne tender.

Njoftimi i kontrates te nenshkruar me shoqerine "Bolvo-Oil" sh.a per Lotin 1 "Blerje Gazoil D1(Eurodizel) 10PPM" esht bere ne daten 10.03.2014, publikuar ne Buletinin e APP-se te dates 24 Mars 2014.

Nga AK është lidhur Kontrata me shoqerine "Kastrati" sh.a me objekt "Blerje Karburanti" per Lotin e 2-te: Blerje Benzine pa plumb 10 PPM , me Nr. 75 Prot. datë 10.03.2014 pa tvsh, ne vleren 218 500 leke pa tvsh, me tollona, sipas cmimit te botuar ne Buletinin e APP dhe marzhit te fitimit te ofruar nga furnizusi ne tender.

Njoftimi i kontrates te nenshkruar me "Kastrati" sh.a, per Lotin 2 "Blerje Benzine pa plumb 10PPM" eshte bere me nr.75 prot. date 10.03.2014, publikuar ne Buletinin e APP-se te dates 24 Mars 2014.

Ne te dyja kontratat e lidhura mungojne dy elemente kryesore te nje kontrate: sasia e karburantit qe parashikohet te furnizohet AK dhe vlera e kontrates me TVSH.

Gjithashtu ne dosje mungon sigurimi i kontrates per te dyja kontratat e lidhura.

Mungon autorizimi/urdheri i Titullarit per monitorimin e zbatimin e kontrates.

Dosja e tenderit eshte inventarizuar, protokolluar dhe arkivuar me nr.05 prot. date 10.01.2015. në përputhje me nenin 30, të Udhëzimit "Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë", miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave në zbatim të nenit 3 e 29 të Ligjit nr.9154, datë 06.11.2003, "Për Arkivat".

2. Tenderi i zhvilluar ne rruge elektronike me objekt "Sherbimi i Ruajtjes dhe i sigurise fizike me Roje private", per periudhen 11.04.2014 - 31.12.2014 (264 dite), per 1 vendroje me 3 roje, me pjesmarrje ne konkurim te 6 OE, kualifikuar 6-te, te skualifikuar asnje, me 1(nje) ankese per

**RAPORT FINAL AUDITIMI
GJYKATA E APELIT TIRANË**

dokumentat e tenderit dhe 1(nje) ankese per klasifikimin dhe vleresimin e ofertave ne AK per vleresimin e ofertave dhe me te dhena te tjera si me poshte:

Të dhëna të përgjithshme për tenderin:

Të dhëna për tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e prokurimit
A	B	C
1.Urdhër Prokurimi Nr.18 Prot. Datë 13.02.2014 2.Fondi limit -pa tvsh 1 000 000 leke. -me tvsh 1 200 000 leke. 3.Pr.Prok. "Kerkese per propozim, me EL. 4.Data e zhvillimit te tenderit 03.03.2014, ora 10.0 5.Ftesa per oferte 5 operatorë ekonomikë. 6.Fituesi "Ales" sh.p.k. 7.Data e lidhjes kontratës 19.03.2014. 8.Vlera e kontratës 900 418.9 leke me tvsh. 9.Difer. mes f. limit e kont. 299 581 lekë me tvsh. 10.Lik. kontratës kontratës 900 418.9 leke,ose 100 %.	1.Altin Gjana, Kryetar 2.Hanke Suci, Anëtare 3.Yllka Cika, Anëtar	1.Elona Lipivani, Juriste 2.Aurora Bardhi, Anetare 3.Elvira Pitarka, Anetare

Nga verifikimi i dokumentave ne dosjen perkatese dhe sistemin elektronik per kete tender, rezultoi se:

I. Lidhur me përlogaritjen e vlerës së kontratës.

Nga Titullari i AK nuk ka dale urdheri i brendshem per ngritjen e komisionit per perlogaritjen e fondit limit dhe hartimin e termave te references. Ne Urdherin e Prokurimit te nxjerre nga Kryetari Autoritetit Kontraktor Nr.18 Prot. date 13.02.2014 eshte ngritur Njesia e Prokurimit, ne urdher nuk saktosohet qe ngarkohet kjo e fundit per hartimin e termave te references dhe perlogaritja e fondit limit. Argumentimi i fondit limit eshte bere nga Kryetarja e Deges te Buxhetit, llogaritjet e bera jane pasqyruar ne nje table qe eshte bere pjese e dosjes te tenderit. Nuk ka nje procesverbal te vecante ku te jete pasqyruar menyra e pellogaritjes te fondit limit dhe hartimi i termave te references, keto te fundit jane pjese e dosjes te tenderit, te pa nenshkruara nga personi qe i ka hartuar.

Ne mbeshtetje te nevojave vjetore per sherbimin e ruajtjes dhe sigurise te pasqyruara ne tabelen e siperpermendur eshte llogaritur dhe fondi limit ne vleren 2 000 000 leke pa tvsh dhe 2 400 000 leke me tvsh, per per periudhen 11.04.2014 deri me 31.12.2014. Fondi limit i perlllogaritur per 12 muaj eshte 2 735 831 leke pa tvsh dhe 3 282 997 leke me tvsh, per dy vendroje me nga 3 roje per cdo vendroje, 6 roje gjithsej.

Sic e trajtuam dhe me larte nuk evidentohet menyra e perlllogaritjes te fondit limit te parashikuara ne VKM. Nuk kemi nje perlllogaritje vjetore te fondit limit, per 1(nje) vendroje me 3(tre) roje, nje here llogaritjet jane bere per 10 muaj ne vleren 1 160 250 leke pa tvsh dhe 1 392 300 leke me tvsh, per nje vend roje me tre roje. Nje here perlllogaritjet jane bere per 2 vendroje me 6 roje gjithsej.

Sipas UP nr.15 prot. date 06.02.2014 kjo procedure prokurimi eshte nisur per tu zhvilluar ne daten 21.02.2014, me fond limit 1 160 250 leke pa tvsh dhe 1 392 300 leke me tvsh, per periudhen 01.03.2014 deri me 31.12.2014, per nje vend roje me tre roje. Procedura e prokurimit eshte pezulluar me Urdherin e Kryetarit te AK nr.403 prot. date 13.02.2014. Ne urdher theksohet se pezullimi behet per shkak te nje gabimi teknik ne Dokumentat Standart te tenderit dhe rifillimin e procedurave te prokurimit (nuk jepen arsyet konkrete te anulimit te procedures te prokurimit). Anullimi i procedures te prokurimit eshte Publikuar ne Buletinin e APP-se date 17 Shkurt 2014.

Sipas RPPP per vitin 2014, derguar me shkresen nr. 42/1, date 07.02.2014 nga ZABGJ ne AK "Gjykata Apelit Tirane", fondi limit i pergjithshem per "Sherbime te sigurimit dhe ruajtjes se godinave" eshte parashikuar ne vleren 1 850 000 leke me tvsh.

II. Mbi hartimin e dokumentave të tenderit.

**RAPORT FINAL AUDITIMI
GJYKATA E APELIT TIRANË**

Njesia e Prokurimit e ngritur sipas Urdher Prokurimi Nr.18 date 13.02.2014 ka hartuar procesverbalin Nr.1 date 13.02.2014 "Mbi hartimin e dokumentave te tenderit". Ne procesverbalin e mbajtur nga NjP nuk argumentohen vendosja e kriterëve te pergjitheshme dhe te vecanta per kualifikim. Bazuar ne dokumentat standart te APP-se janë plotësuar kriteret e kualifikimit, ku përfshihen (kriteret e pergjitheshme, kriteret e vecanta dhe kapaciteti ekonomik dhe financiar) ne perputhje me legjislacionin e prokurimit publik.

Në zbatim të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, VKM nr.1 date 10/01/2007 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik". Dokumentat e tenderit pasi jane firmosur nga te gjithe anetaret e NjP, se bashku me njoftimin e kontrates (e pa nenshkruar nga K/AK perpara se te dergohet per tu publikuar) jane derguar ne forme elektronike per tu publikuar, ne faqen zyrtare te internetit te APP-se dhe ne Buletinin e APP-se. Nga personi i autorizuar per te kryer veprimet ne sistemin elektronik jane ftuar per te marre pjese ne kete procedure prokurimi 5 (pese) operatore ekonomik (te pa miratuar/argumentuar me pare ne procesverbalin e hartimit te dokumentave te tenderit nga NjP). Njoftimi i kontrates eshte publikuar ne Buletinin e APP-se te dates 17 Shkurt 2014.

Me shkresen nr. 16 prot date 17.02.2014 eshte bere ankese nga SH.R.S.F "S.S.X" sh.p.k, protokolluar ne gjykate me nr.440 prot. date 17.02.2014. OE ankohet se ne kerkesat per kualifikim eshte kerkuar se OE duhet te jete i paisur me certifikaten ISO 9001 – 2008 , kerkese kjo qe bie ndesh me nenet 1,2 dhe 20 te LPP. Gjithashtu OE ankimues kerkon qe te saktësohet numri i rojeve, pasi ne dokumentat e tenderit nje here evidentohet 3 dhe nje here 6.

Me te drejte procedura e prokurimit eshte pezulluar me urdherin nr.26 prot. Date 20.02.2014, ne urdherin e pezullimit nuk percaktohet emir i personit apo personave qe do te shqyrtojne ankesen dhe do te pregadisnin pergjigje per OE ankimues. Me vendimin nr.493 prot date 20.02.2014, eshte vendosur qe te dy pretendimet e OE ankimues te merren parasysh dhe te behet modifikimi ne dokumentat e tenderit. Ne procesverbalin nr.02 date 20.02.2014 eshte dokumentuar modifikimi i dokumentave te tenderit dhe shtyrja e afatit te zhvillimit te tenderit ne daten 03.03.2014.

III.Mbi vlerësimin e ofertave dhe përzgjedhjen e ofertës fituese.

Me Urdherin nr.19, Prot, date 13/02/2014 eshte ngritur KVO-ja, kjo e fundit, ne mbeshtetje te njoftimit te kontrates ka mbyllur afatin e dorëzimit të ofertave në datën 03/03/2014.

Ne mbeshtetje te Procesverbalit Nr.3, date 03.03.2014 rezulton te kene marre pjese 6 OE. Oferta e paraqitur nga OE " Ales" shpk eshte vleresuar si oferte anomalisht e ulet. Eshte lajmeruar operatori ekonomik nepermjet sistemit qe te paraqese argumentat e tij ne lidhje me oferten e dhene. Po ne daten 03.03.2014 nga OE jane paraqitur argumentat ne lidhje me oferten e dorezuar, te cilat kane qene bindese per KVO-ne, duke mundesuar kualifikimin e tij.

Nga shqyrtimi i dokumentave administrativ, ligjor, ekonomik-financiar, teknik te paraqitur nga OE per kriteret e pergjitheshme dhe kerkesave te vecanta per kualifikim, nga ana e KVO jane kualifikuar te 6 OE qe kane marre pjese ne konkurim.

Klasifikimi perfundimtare ne sistemin elektronik eshte bere ne daten 04.03.2014.

KVO-ja ka hartuar Raporti permbledhes pa mbaruar afatet e ankimimit ne daten 04.03.2014 per Kryetarin e AK, per te miratuar proceduren e shqyrtimit, vleresimit dhe krahasimit te ofertave si dhe shpalljen e fituesit per oferten me te favorshme te paraqitur nga shoqeria "Ales" shpk, me vlere oferte me te ulet 750 349 leke pa tvsh ose 28 982.19 leke per nje roje ne muaj pa tvsh.

Ne daten 11.03.2014 eshte bere Njoftim Fituesit per OE "Ales" shpk , me vlere oferte me te ulet 750 349 leke pa tvsh.

Me nr.29 prot. date 05.03.2014 nga SH.R.S.F "Hoxha" shpk, eshte bere ankese protokolluar ne AK me nr.735 date 12.03.2014. Ankimuesi pretendon se jane kualifikuar 2 OE "Ales" dhe "Arbana" sh.a qe kane paraqitur oferte nen koston ligjore. Klasifikimi ne system eshte bere ne daten 04.03.2014, afati i

RAPORT FINAL AUDITIMI GJYKATA E APELIT TIRANË

fundit per ankimim eshte data 11.03.2014(mbas 7 dite nga publikimi i klasifikimit ne system). Ankesa eshte protokolluar ne gjykate ne daten 12.03.2014. Nga ana e AK nuk eshte marre parasyshe ankesa, me argumentin se eshte paraqitur jashte afateve ligjore te ankimimit, mbi 7 dite. Ankeses ne dosje i mungon bashkangjitur zarfi per te pare vulen datare te postes per te saktësuar dhe nxjerre arsyen perse ne gjykate ka ardhur dhe eshte protokolluar me 7 dite vonese.

Me shkresen nr.774 prot. Date 17.03.2014, AK i ka kthyer pergjigje OE, duke mos marre parasyshe ankesen me argumentin se ankesa nuk eshte paraqitur brenda afateve ligjore. AK ne daten 11.03.2014 ka derguar ne rruge elektronike Formularin per Njoftimin e Fituesit ne sistemin elektronik. Publikuar ne Buletinin e APP-se me 17 Mars 2014.

IV. Në lidhjen dhe zbatimin e kontrates të ofertuesit fitues në proceduren e prokurimit

Nga ana e Titullarit të Gjykates Apelit Tirane, është lidhur Kontrata Nr. 73 Prot. datë 19.03.2014 me Shoqerine “Ales sh.p.k” sha, ne vleren 750 349 leke pa tvsh. Si ne nenin 1 te kontrates “Vlera e Kontrates” dhe ne nenin 14 “Cmimi i kontrates” eshte pasqyruar vetem cmimi pa tvsh dhe jo me tvsh, per 1 vendroje me 3 roje, per periudhen 11.04.2014 deri me date 31.12.2014. Formulari i kontrates eshte neshkruar po ne daten 19.03.2014. Ne dosjen fizike mungon sigurimi i kontrates.

Per marrjen ne dorezim te dokumentave te OE fitues per kete procedure prokurimi nuk eshte hartuar nje procesverbal i vecante apo flete inventari ku te pasqyrohen te gjitha dokumentat e dorezuara nga OE i shpallur fitues dhe te nenshkruhet nga te dyja palet, perfaqesuesit te shoqerise dhe KVO-se.

Nga ana e AK eshte bere Njoftimi i Kontrates te nenshkruar, botuar ne Buletinin e APP-se te dates 24 Mars 2014.

Nuk eshte hartuar dhe miratuar Rregullorja e Brendshme “Per ruajtjen dhe sigurimin fizik te objektit”.

Nga ana e AK nuk eshte nxjerre Urdheri i Brendshem per ngritjen e komisionit te mbikqyrjes dhe monitorimin e cilesise te realizimit te Kontrates Nr. 73 Prot. datë 19/03/2014 me Shoqerine “Ales” sh.p.k, ne vleren 750 349 leke pa tvsh, per 1 vendroje me 3 roje per periudhen 11/04.2014 - 31/12/2014.

Me Nr.5 Prot. date 10.01.2015 dosja e tenderit eshte inventarizuar, protokolluar dhe arkivuar në përputhje me nenin 30, të Udhëzimit “Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë” miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave në zbatim të nenit 3 e 29 të Ligjit nr.9154, datë 06.11.2003, “Për Arkivat”.

Auditimi për procedurat e prokurimit me vlere te vogel

Mbeshtetur ne piken 5 te nenit 29, te ligjit nr.9643, date 20.11.2006 “Per prokurimin publik”, i ndryshuar. Ne piken 2/a “Prokurimi me vlere te vogel”, Kreu VI “Zhvillimi i procedures se kerkeses per propozim, prokurimit me vlere te vogel, sherbimet e kosulences, konkursi i projektimit” të V.K.M-se nr.1, date 10.01.2007 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i shfuqizuar. Nenin 40, pika 2, Kreu IV te VKM-se nr.914, date 29.12.2014 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar. Ne çdo fillim viti, me Urdher te Kryetarit AK eshte ngritur Komisioni i Prokurimit me Vlere te Vogel, per vitet 2014, 2015,2016 dhe 2017.

- Referuar RPPP dhe ndryshimeve te bera gjate vitit, nga AK “Gjykata Apelit Tirane” jane parashikuar per tu zhvilluar *gjate vitit 2017* nga fondet e buxhetit te shtetit 20 procedura prokurimi me vlere te vogel, me fond limit 5680 mije leke me tvsh. Referuar RRPP per vitin 2017 jane realizuar 20 procedura prokurimi me vlere te vogel, me vlere kontrate te lidhur 5 659.8 mije leke me tvsh.

- Referuar RPPP dhe ndryshimeve te bera gjate vitit, nga AK “Gjykata Apelit Tirane” jane parashikuar per tu zhvilluar *gjate vitit 2016* nga fondet e buxhetit te shtetit 17 procedura prokurimi me vlere te vogel, me fond limit 6 403.5 mije leke me tvsh. Sipas RRPP per vitin 2016 jane realizuar 18 procedura prokurimi me vlere te vogel, me vlere kontrate te lidhur 6 315.8 mije leke me tvsh.

**RAPORT FINAL AUDITIMI
GJYKATA E APELIT TIRANË**

Numri i prokurimeve te realizuar nga AK eshte me i madh se numer i prokurimeve te parashikuara ne RPPP per arsye se; fondi i parashikuara per tu prokuruar me nje procedure prokurimi, ne nje raste "Blerje Paisje te tjera" eshte realizuar me dy procedura prokurimi gjate vitit, ne perputhje me aktet ligjore dhe nen ligjore ne fuqi.

- Referuar RPPP dhe ndryshimeve te bera gjate vitit, nga AK "Gjykata Apelit Tirane" jane parashikuara per tu zhvilluar *gjate vitit 2015* nga fondet e buxhetit te shtetit 15 procedura prokurimi me vlere te vogel, me fond limit 3 410 mije leke me tvsh. Sipas RRPP per vitin 2015 jane realizuar 16 procedura prokurimi me vlere te vogel, me vlere kontrate te lidhur 3 093 mije leke me tvsh.

Numri i prokurimeve te realizuar nga AK eshte me i madh se numer i prokurimeve te parashikuara ne RPPP per arsye se; fondi i parashikuara per tu prokuruar me nje procedure prokurimi, ne nje raste "Blerje Paisje te tjera" eshte realizuar me dy procedura prokurimi gjate vitit, ne perputhje me aktet ligjore dhe nen ligjore ne fuqi.

- Referuar RPPP dhe ndryshimeve te bera gjate vitit, nga AK "Gjykata Apelit Tirane" jane parashikuara per tu zhvilluar *gjate vitit 2014* nga fondet e buxhetit te shtetit 14 procedura prokurimi me vlere te vogel, me fond limit 4 570 mije leke me tvsh. Sipas RRPP per vitin 2014 jane realizuar 15 procedura prokurimi me vlere te vogel, me vlere kontrate te lidhur 4 321.3 mije leke me tvsh.

Numri i prokurimeve te realizuar nga AK eshte me i madh se numer i prokurimeve te parashikuara ne RPPP i ndryshuar se: Procedura e prokurimit "Blerje mobilje" me fond limit te pergjithshem 1 600 mije leke eshte prokuruar duke u ndare ne dy pjese, nje pjese me proceduren "Kerkese per propozim" dhe pjesa tjetere me proceduren "Blerje me vlere te vogel".

Per vitin 2017, me zgjedhje u audituan 10 procedura prokurimi me vlere te vogel te realizuar ne sistemin elektronik dhe 5 procedura prokurimi te zhvilluar ne forme shkresore.

Per vitin 2016, me zgjedhje u audituan 8 procedura prokurimi me vlere te vogel te realizuar ne sistemin elektronik dhe 4 procedura prokurimi te zhvilluar ne forme shkresore.

Per vitin 2015, me zgjedhje u audituan 7 procedura prokurimi me vlere te vogel te realizuar ne sistemin elektronik dhe 4 procedura prokurimi te zhvilluar ne forme shkresore.

Per vitin 2014, me zgjedhje u audituan 7 procedura prokurimi me vlere te vogel te realizuar ne sistemin elektronik dhe 3 procedura prokurimi te zhvilluar ne forme shkresore.

Nga verifikimi ne sistemin elektronik dhe dokumentacionit perkates, rezultoi se eshte vepruar ne perputhje me Ligjin Nr. 9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin Publik", i ndryshuar. V.K.M-se nr.1, date 10.01.2007 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", i shfuqizuar. VKM nr.914, date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar. Udhëzimin Nr.05, date 27.01.2015 "Per zhvillimin e procedurave te prokurimit me vlerë të vogël në sistemin e prokurimit elektronik", i shfuqizuar. Udhëzimin Nr.1, date 14.04.2017 "Per zhvillimin e procedurave te prokurimit me vlerë të vogël në Sistemin e Prokurimit Elektronik", i shfuqizuar. Udhëzimin Nr. 3, date 27.01.2015 "Per procedurën e prokurimit me vlerë të vogël", i shfuqizuar, Udhëzimin Nr. 1, date 21.04.2016 "Per disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin Nr. 3, date 27.01.2015 "Per Procedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël", i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 2, date 24.04.2017, te shfuqizuar.

Te gjitha procedurat e prokurimit me vlere te vogel te zhvilluara nga AK ne sistemin elektronik dhe menyre shkresor rezultojne me dokumentacion shoqerues standart te parashikuara ne aktet ligjore dhe nenligjore ne fuqi.

Përveç sa u trajtua me larte gjate periudhes nen auditim, u konstatuan edhe disa te meta dhe parregullsi, konkretisht:

1. Perdorimi ne disa raste i procedures te prokurimit me vlere te vogel per blerjen e mallrave, apo kryerjen e sherbimeve te paparashikueshme/ te vleresuar si raste emergjente me vlere jo me te madhe se 100 000 leke pa tvsh, sipas formularit Nr.4. Kjo procedure prokurimi perdoret kur prania e komisionit është e pamundur, blerja apo shërbimi do kryhet në vend pa u respektuar procedurat e

**RAPORT FINAL AUDITIMI
GJYKATA E APELIT TIRANË**

parashikuara, në prani të personave (përfaqësues të institucionit) që ndodhen në vend dhe që mbajnë një procesverbal midis tyre për ngjarjen e ndodhur. Ne Udhëzimin e APP-se nr. Nr. 1, datë 21.04.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin Nr. 3, datë 27.01.2015 “Për Proçedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël” i ndryshuar, është përcatuar se kjo procedure prokurimi përdoret në rastet emergjente “kur ngjarja nuk mund të parashikohet”. Nuk mund të konsiderohet blerje emergjente mirembajtja e vazhdueshme e mjeteve të transportit jo në udhëtim, riparimi i pajisjeve elektronike apo blerja e materialeve të konsumit të përditshëm, si Letër A4 apo Toner etj. të kësaj natyre. Nuk është se KPVV ka vendosur kërkesa të shumta për kualifikim në Ftesën për Oferte (formularin Nr.3), për blerjet me vlerë të vogël të zhvilluara nëpërmjet sistemit elektronik. Gje e cila ka ndikuar pozitivisht në plotësimin e dokumentacionit nga OE pjesëmarrës në procedurat e prokurimit të realizuar nga AK (të paktën 24 orë nga publikimi i Ftesës për Ofertë në sistemin e prokurimit publik, për përgatitjen e ofertave). Për rrjedhojë nuk konstatohen raste të shumta anulimi të procedurave të prokurimit të zhvilluara në sistemin elektronik dhe përdorimi i procedurës të prokurimit në formë shkresore me formularin Nr. 6. **Te gjithë këto faktore duhet të kishin ndikuar në uljen e numrit të procedurave të prokurimit të zhvilluara nga AK në formë shkresore me formularin Nr.4, të vlerësuar si raste emergjente nga KPVV.** Procesverbalet e ndodhjes të ngjarjes/procesverbalet e konstatimit, duhet të jenë me të plotë, duhet të pasqyrojnë me hollësi rrethanat e ngjarjes, në mënyrë që edhe vlerësimet e bëra nga KPVV të ishin me i bazuar për rastet emergjente. Po kështu AK duhet të jetë me i kujdesshëm në hartimin e projektit buxhetit, duhet të planifikojë natyrën, sasinë dhe llojet e mallrave, shërbimeve dhe zërat e punëve që do të prokurohen dhe i përfshin ato në regjistrin e parashikimeve të procedurave të prokurimit publik, si dhe realizimi në kohë të procedurave të prokurimit.

Konkretisht gjatë periudhës 01.01.2016 - 30.04.2016 nga AK janë vlerësuar si raste emergjente blerjet e likuiduara me: Ush nr.21, dt.20.01.2016 në vlerën 7480 leke, për riparimin e pajisjeve elektronike (3 copë printera); Ush nr. 46, dt.12.02.2016, në vlerën 11 315 leke, për mirembajtje motorri; Ush nr. 37, date 09.02.2016, për printim në formatin A3, në vlerën 16 200 leke; Ush nr. 61, date 04.03.2016, në vlerën 15 000 leke për “Mirembajtje pajisje serveri”; Ush nr. 63, date 04.03.2016, për “Mirembajtje pajisje serveri” në vlerën 26 600 leke; Ush nr.66, date 23.03.2016, në shumën 25 000 leke për mirembajtje motorri; Ush nr. 86, date 25.03.2016, paguar “PC STORE” shpk në vlerën 5000 leke, në Up thuhet “Blerje kancelari” në fakt është blerë adaptor; Ush nr.96, date 05.04.2016, paguar “Erison Company” shpk, në vlerën 9941 leke për blerje Toner Blach; Ush nr. 114, date 20.04.2016, paguar “Copier Computer Center” shpk, në vlerën 8000 leke për blerje Letër A4; Ush nr. 118, date 22.04.2016, paguar në vlerën 20 412 leke për furnizime materiale të tjera zyre...etj.

Për periudhën 01.09.2017 deri më 31.12.2017 nga KPVV janë vlerësuar si raste emergjente, likuidimet e bëra me: Ush nr.270, date 05.09.2017, në shumën 21 280 leke për “Blerje pjesë këmbimi, goma dhe bateri”; Ush nr.275, date 08.09.2017, në shumën 14 000 leke për blerje baterie; Ush nr.281, dt.13.09.2017, në shumën 29 700 leke “Blerje pjesë këmbimi”, për riparimin e motorrit; Ush nr.289, dt.14.09.2017, në shumën 36 202 leke “Blerje Pult automjeti”; Ush nr.398, dt.19.12.2017 në shumën 23 000 leke, për “Blerje Pjesë Këmbimi”.....etj. Raste të kësaj natyre janë konstatuar edhe gjatë vitit 2014 dhe 2015.

2. Përdorimi i procedurës së prokurimit në formë shkresore sipas formularit Nr.5, kur vlera e një grup mallrash, kryerja e shërbimeve apo punëve të ngjashme, që kanë të njëjtin funksion kryesor apo që kanë të njëjtin emërtim në planin e shpenzimeve, **duke kaluar vlerën 100 mijë leke** pa tvsh brenda vitit kalendarik. Në asnjë rast, autoritetet kontraktore nuk duhet të prokurorin veçmas mallra, shërbime apo punë që përfshihen në një grup për shkak të ngjashmërisë së tyre, apo për shkak të funksionit kryesor.

**RAPORT FINAL AUDITIMI
GJYKATA E APELIT TIRANË**

Si per mirembajte mjete transporti, mirembajtje e paisje elektronike, mirembajte godine, mirembajtje paisje elektrike, siguracione te mjeteve te transportit. Te gjitha keto nenzera shpenzimesh e kalojne vleren e 100 mije leke gjate vitit, per rrjedhoje nuk mund te perdoret formulari 4, procedurat e prokurimit duhet zhvillohen nepermjet sistemit elektronik, konkretisht likujdimet e bera me: Ush nr.23, date 22.01.2016, ne vleren 102 980 leke per “Sigurim mjete transporti”; Ush nr.276, date 11.09.2017 ne shumen 29 556 leke, per siguracion mjete transporti; Ush nr.278, dt.13.09.2017, ne shumen 45 327 per “Blerje materiale elektrike”, ne fakt jane blere “Mjete pune” dhe jo materiale elektrike; Ush nr.279, dt.13.09.2017, ne shumen 68 640 leke, per “Blerje mjete pune”; Ush nr.280, dt.13.09.2017, ne shumen 80160 leke per “Blerje te tjera zyre” (te treja blerjet e bera brenda nje dite i perkasin grupit “Mjete pune”, per blerjen e te cilave jane shpenzuar 194 127 leke > 100 000 leke); Ush nr.292, dt.27.09.2017, ne shumen 14 520 leke “Per lysterje”, ne Up nr. 122/1 dt.15.09.2017 eshte shenuar “Vegla pune” si objekt prokurimi; Ush nr.293, dt.27.09.2017, ne shumen 16 800 leke per “Blerje vegla pune”; Ush nr.368, dt.24.11.2017, ne shumen 75 960 leke, per “Blerje Paisje Mobilje”; Ush nr.369, dt.24.11.2017, ne shumen 117 960 leke per “Orendi zyre”, ne fakt eshte i njejti grup artikuj me te njetin funksion “Paisje Zyre”. Gjate vitit 2017 per “Blerje Pisje Mobilje” eshte zhvilluar nje procedure prokurimi “Kerkese per propozim”.

Po keshtu konstatohen raste te blerjeve me Formularin Nr. 5, brenda vitit kalendarik, kur nje artikull apo grup artikujsh me te njeten funksion apo perberje eshte **realizuar nje here procedura e prokurimit me Vlere te Vogel** ne sistemin e elektronik me formularin Nr.3.

3. Ne procedurat e prokurimit te realizuar nga AK nepermjet sistemin elektronik, ne Ftesen per Oferte, sipas formularit Nr. 3, ne kerkesat per kualifikim eshte kerkuar edhe **depozitimi i mostarve te mallit** nga OE i klasifikuar i pari ne sistemin elektronik, nderkohe qe KPVV nuk ka percaktuar karakteristikat e mallit qe kerkohet te blihet, konkretisht ne likujdimet e bera me: Ush nr.82, date 23.03.2016, likujduar OE “Euromega” shpk ne vleren 142 800 leke per blerje materiale pastrimi, ne mbeshtetje te procedures te prokurimit te zhvilluar ne baze te Up nr.29, date 04.03.2016, me fond limit 220 225 leke pa tvsh; Ush nr.369, dt.24.11.2017, ne shumen 117 960 leke per “Orendi zyre” etj.

Depozitimi i mostrave nga OE i renditur i pari ne klasifikimin perfundimtar perpara se te shpallet fitues ne sistemin elektronik duhet te kerkohet vetem ne rastet kur jane percaktuar me pare nga KBVV, ne menyre te hollesishme karakteristikat e mallit qe kerkohet te blihet. Kur jane hartuar e dokumentuar **specifikimet teknike** ne nje procesverbal te vecante, ne mbeshtetje te se cilave eshte bere dhe **perlllogaritja e fondit limit** (me ndryshimet e fundit kerkesa per depozitimin e mostrave eshte hequr).

4. Mos percaktimi jo i sakte i karakteristikave te punes, mallit apo sherbimit te kerkuara per tu prokuruar ka bere qe edhe **marrja ne dorezim** e punes, mallit apo sherbimit nga komisioni i ngritur per kete qellim ne disa raste te jete bere formal, duke mos shenuar ne procesverbal/aktin e kolaudimit/monitorimit karakteristikat e punes, mallit apo sherbimit te marre ne dorezimr. **Duke mos vepruar ne perputhje me kerkesat e Udhezimit te MF Nr.30, date 27.12.2011 “Per menaxhimin e aktiveve ne njesite publike”, Kreu III-te, pika 42,43 dhe 44,** konkretisht ne likujdimet e bera me: Ush nr.278, dt.13.09.2017, ne shumen 45 327 per “Blerje materiale elektrike”, ne fakt jane blere “Mjete pune” dhe jo materiale elektrike; Ush nr.279, dt.13.09.2017, ne shumen 68 640 leke, per “Blerje mjete pune”; Ush nr.280, dt.13.09.2017, ne shumen 80160 leke per “Blerje te tjera zyre”, ne fakt jane blere “Mjete pune”; Ush nr.294, dt.27.09.2017; Ush nr.368, dt.24.11.2017, ne shumen 75 960 leke, per “Blerje Paisje Mobilje”; Ush nr.369, dt.24.11.2017, ne shumen 117 960 leke per blerje “Orendi zyre”, ne fakt eshte e njejta gje me artikullin paisje zyre; Ush nr.336, dt.27.10.2017, ne shumen 118 680 leke per “Blerje Paisje Elektronike” ne fakt jane blere 3 ngrohesh elektrik dhe 15 UPS; Ush nr. 387, dt.11.12.2017 ne shumen 84 000 leke per “Blerje goma makine” etj.

**RAPORT FINAL AUDITIMI
GJYKATA E APELIT TIRANË**

5. Perllogaritja e Fondit limit per BVV nuk eshte pasqyruar ne nje procesverbal te vecante ku te evidentohet dhe menyra e perllogaritjes. Urdher shpenzimit i eshte bashkangjitur praktika e blerjes bashke me Urdher prokurimin dhe nje table e hartuar nga K/Deges Buxhetit ku pasqyrohet fondi limit, ne kete te fundit nuk evidentohet menyra e perllogaritjes te fondit limit, si dhe parashikohet ne nenin 59 te VKM nr.914, date 29.12.2014 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuare. Udhezimin Nr.1, date 21.04.2016 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne Udhezimin Nr.3, date 27.01.2015 “Per Proceduren e Prokurimit me Vlere te Vogel”, pika 2. Ndryshuar me Udhëzimin Nr. 2, datë 24.04.2017, paragrafi trete pika 4, ku citohet... “Në çdo rast, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit nga titullari i autoritetit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, komisioni i prokurimit me vlerë të vogël duhet të përlllogarisë fondin për sasinë e mallrave, shërbimeve, punëve që do të prokurojë, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme”.

Konkretisht ne likujdimet e bera me: Ush nr.68, date 04.03.2016, per blerje kancelari ne vleren 158 016 leke; Ush nr.90, date 05.04.2016, blerje dollape arkive ne vleren 192 000 leke; Ush nr. 91, date 05.04.2016, paguar “PC STORE” ne vleren 100 000 leke per “Blerje paisje elektronike”; Ush nr. 115, date 21.04.2016, paguar “Eldi Qafmolla” PF ne vleren 450 000 leke; Up nr.62, date 30.03.2016; Ush nr.278, dt.13.09.2017, ne shumen 45 327 per “Blerje materiale elektrike”; Ush nr.279, dt.13.09.2017, ne shumen 68 640 leke, per “Blerje mjete pune; Ush nr.368, dt.24.11.2017, ne shumen 75 960 leke, per “Blerje Paisje Mobilje”; Ush nr.369, dt.24.11.2017, ne shumen 117 960 leke per “Orendi zyre”; Ush nr. 387, dt.11.12.2017 ne shumen 84 000 leke per “Blerje goma makine” etj.

Perllogaritja e fondit limit duhet te behet ne perputhje me nenin 59 te VKM-se nr.914, date 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. “.....Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: *çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe a) çmimet e tregut; ose/dhe b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe ç) çmimet ndërkombëtare, të botuara*”.

6. Ne procedurat e prokurimit me vlere te vogel, te zhvilluara nepermjet sistemit elektronik, ne rastet e mosparaqitjes te operatorit ekonomik fitues/klasifikuar i pari me vlere oferte me te ulet ose per mos plotesimin e kriterëve per kualifikim te vendosura nga AK ne Ftesen per Oferte (deri ne vendin e 5-te). Nuk eshte vepruar ne perputhje me Udhezimin Nr.05, datë 27.01.2015 “Për zhvillimin e procedurave të prokurimit me vlerë të vogël në sistemin e prokurimit elektronik” dhe Udhëzimin Nr.1, datë 14.04.2017 “Për zhvillimin e procedurave të prokurimit me vlerë të vogël në Sistemin e Prokurimit Eletronik”. Nga ana e KPVV nuk eshte mbajtur procesverbali i pasqyrimin te arsyes te skualifikimit kur ofertuesi i shpallur fitues eshte tërhequr nga oferta e tij, nuk eshte paraqitur në afatin kohor të përcaktuar në ”Ftesën për Ofertë, ose nuk ka plotësuar kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në ”Ftesën për Ofertë”, ky i fundit ka përzgjedhur ofertuesin e renditur i dyti në listën e ofertave dhe kështu me radhë, deri në ofertuesin e renditur në vendin e peste, ne mbeshtetje te te cilit plotesohet dhe publikohet “Formulari i Njoftim Fituesi” nga personi i autorizuar per te kryer veprimet ne sistemin elektronik. Këto veprime duhet të dokumentohen nga KPVV nëpërmjet një procesverbali të mbajtur për këtë qëllim. Konkretisht ne likujdimet e bera me: Ush nr.106, date 13.04.2016, paguar “Auto Star Albania” sh.a ne vleren 93 923 leke per “Mirembajtje automjeti”, Ush nr. 115, date 21.04.2016, paguar “Eldi Qafmolla” PF ne vleren 450 000 leke etj.

**RAPORT FINAL AUDITIMI
GJYKATA E APELIT TIRANË**

7. Nga AK nuk është mbajtur regjistri analitik për realizimin e prokurimeve me Vlere të Vogel, për çdo urdher shpenzimi/procedure prokurimi të realizuar me qëllim respektimin e kufirit maksimal të lejuar për PVV, jo më e madhe se 800 000 leke pa tvsh në vit, sipas formularit Nr.3 apo për përdorimin e procedurës të prokurimit në formë shkresore me vlerë jo më e madhe se 100 mijë leke pa tvsh në vit, për mallra, shërbime apo punë që përfshihen në një grup për shkak të ngjashmërisë së tyre, apo për shkak të funksionit kryesor, sipas formularit Nr.5..

8. Në disa raste të prokurimeve të shërbimeve (riparime/mirëmbajtje..etj), praktikës të blerjes i mungon procesverbali i konstatimit të difektit apo i shërbimit që kërkohet të kryhet (preventivi), si dhe procesverbali për punën e kryer në fakt nga ofruesi i shërbimit, konfirmuar nga marrësi në dorezim, përfaqësuesi i gjykatës, përpara se të bëhet likuidimi i vlerës perkatese.

4.6 Sistemi IT

Aktualisht në Gjykatën e Apelit disponohet 1 (një) server i tipit HP ProLiant DL 380 G7 me sistem operativ Windows Server 2008 R2 Standard i cili përdoret për replikimin e sistemit ICMIS, si dhe për ruajtjen e të gjithë seancave audio, ky server ka të instaluar sistemin ICMIS, arkiva audio ruhet në NAS Storage i blerë në vitin 2017.

Dhoma ku është vendosur serveri i gjykatës është e pershtateshme, është i pajisur me kondicioner për të siguruar një temperaturë konstante 20 gradë celsius dhe mbrojtur nga lagështia. Dhoma e serverit është e pajisur me fikse zjarri dhe aksesit në të është i kufizuar vetëm nga IT e gjykatës .Serveri është i montuar në rack dhe ka ushqim të përpunuar me rrymë elektrike (inverter dhe UPS)

Gjykata nuk është e pajisur me sistem backup për ruajtjen e të dhënave.

Nuk është hartuar rregullorja “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale,” ku të përfshihen rregulla të përdorimit dhe ruajtjes së mjeteve të TI, përdorimit e postës elektronike, siguria dhe mbrojtja e paisjeve të TI në zbatim të kërkesave të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, i ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012 mbi “Mbrojtjen e të dhënave personale”, Udhëzimit Nr.15, datë 23.12.2011 për “Përpunimin dhe publikimin e të dhënave personale në sistemin gjyqësor”, Vendimit Nr. 1, datë 04.03.2010 për “Percaktimin e rregullave të hollesishme për sigurimin e të dhënave personale”, si dhe akteve të tjera të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit.

V. Zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm

Gjykata është audituar nga NJAB në vitin 2014 . Konstatohet se me datë 08.10.2014 në Gjykatën e Apelit është kryer auditim tematik nga NJAB, në bazë të programit të Angazhimit tematik Nr.14, datë 06.10.2014”Lidhur me zbatimin e rekomandimeve të auditimit të mëparshëm”.

Konstatohet se është mbajtur akt verifikimi lidhur me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga grupi I auditimit datë 08.10.2014 , ndërmjet grupit të auditimit dhe Kryetarit të Gjykatës, Kancelarit dhe K/D/Buxhetit.

**RAPORT FINAL AUDITIMI
GJYKATA E APELIT TIRANË**

VI. KONKLUZIONE, REKOMANDIME DHE PLAN VEPRIMI I GJYKATES

Duke vlerësuar frymën e bashkëpunimit dhe të mirëkuptimit të gjykates tuaj, DAB-ja arrin në konkluzion që:

Gjykata Apelit Tiranë, paraqet një performancë të mire ne menaxhimin e fondeve buxhetore, burimeve njerëzore dhe shërbimeve gjyqësore.

Në përfundim të procesit të vlerësimeve të bëra, bazuar në nenin 6, pika c të ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” për arritjen e objektivave në vitin 2018 e në vazhdim kërkojmë dhënien e rekomandimeve për ndreqjen e parregullsive, si dhe masat konkrete të cilat synojnë të ulin mundësinë e përsëritjes së këtyre rasteve në të ardhmen sipas sistemeve si vijon:

I. Sistemi organizativ

1. Referuar nenit 37 germa ”dh” te Ligjit Nr.98, date 06.10.2016 ”Per Organizimin e Pushtetit Gjyqësor ne Republiken e Shqiperise”, te rishikohet dhe permiresohet rregullorja egzistuese, ku ndarja e detyrave, pershkrimet e punes dhe pergjegjesite te jene te qarta dhe sipas struktures aktuale per cdo punonjes qe ka funksione për menaxhimin e fondeve buxhetore duke perfshire edhe detyrimet qe rrjedhin nga ligji nr.10296 date 08.07.2010 “Per Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”(i ndryshuar).

Niveli i prioritetit : i mesëm

Afati i zbatimit : Deri me 30.06.2018

Reagimi i menaxhimit : Dakort me zbatimin

2. Deri ne krijimin e institucioneve te reja te Gjyqesorit, për plotësimin e çdo vendi vakant, te ngrihet një komision ad-hoc, që te hartojë kriteret konkrete të konkurimit, veç atyre të përgjithshme, te realizoje publikimin, mbledhjen e dokumentacionit, konkurimin nëpërmjet intervistimit, dokumentimin dhe arshivimin e te gjithë procedures.

Niveli i prioritetit : i mesëm

Afati i zbatimit : Ne vijimesi

Reagimi i menaxhimit : Dakort me zbatimin

3. Trajnimi i stafit administrativ eshte i domosdoshem, ne bashkepunim me MD, DAP, APP dhe ZABGJ duhet te programohet, sidomos ne drejtim te Ndryshimeve ne legjislacion, prokurimeve publike, perdorimin e sistemeve informatike dhe financiare, menaxhimin e burimeve njerzore dhe MFK-se.

Niveli i prioritetit : i mesëm

Afati i zbatimit : Ne vijimesi

Reagimi i menaxhimit : Dakort me zbatimin

II. Sistemi i hartimit dhe zbatimit te Buxhetit

1. Për hartimin e PBA-së si një proces i rëndësishm për aktivitetin e gjykatës në vijimësi duhet te ndahen detyrat për secilin anëtar te GMP, te hartohet kalendari i aktiviteteve të grupit të punës ne

**RAPORT FINAL AUDITIMI
GJYKATA E APELIT TIRANË**

reference edhe te kalendarit te hartuar nga ZABGJ sipas kërkesave të ligjit nr. 9936 datë 26/06/2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe udhëzimin nr.8 date 29/03/2012 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” pikat 39/a dhe 47-55 dhe te sigurohet gjurma e auditit ne kete proces.

Niveli i prioritetit: i mesëm

Afati i zbatimit : Në vijimësi

Reagimi i menaxhimit: Dakort me zbatimin

III. Sistemi i pagesave (Pagat, Transaksionet per blerjet, shpenzimet)

1. Ndërprerjen e pagesave për përfitim të padrjetë për gradë shkencore dhe vështirësi e dëmshmëri për shëndetin, kryerjen e llogaritjeve për vlerën e përfitimeve të padrejta deri në 31/12/2017, kontabilizimin e tyre dhe nxjerrjen e aktit administrativ për rikthimin e tyre në buxhetin e shtetit.

Niveli i prioritetit : i lartë

Afati i zbatimit : Menjëherë

Reagimi i menaxhimit : Dakort me zbatimin

2. Nga ana e GMS të gjykatës të merren masa për rishikimin e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm në fushën e pagave duke përcaktuar qartë detyrat dhe përgjegjësië e punonjësit që mbulon burimet njerëzore dhe procedurat e monitorimit. Njëkohësisht të saktësohen nga ana e burimeve njerëzore vjetërsitë në punë të të gjithë punonjësve duke kërkuar zyrtarisht nga KLD konfirmimin e vjetërsisë së punës për trupën gjyqësore, si dhe rillogaritjen e vjetërsive të administrates mbështetëse bazuar në librezat e punës dhe pas miratimit nga titullari ti dërgoht degës së buxhetit për të kryer verifikimet dhe korrigjimet e mundëshme.

Niveli i prioritetit : i mesëm

Afati i zbatimit : Brenda 30/04/2018

Reagimi i menaxhimit : Dakort me zbatimin

IV.Sitemi i raportimit financiar

1. Duke mbajtur parasysh se programi financiar Alpha Web ka 3 vjet në përdorim dhe punonjësit nuk kanë fituar aftësinë për të menaxhuar aktivitetin ekonomik financiar nëpërmjet tij nga ana e gjykatës të merren masa për trajnimet e punonjësve . Njëkohësisht brenda afateve të përcaktuara të kryhen të gjitha regjistrimet kontabile dhe pasqyrat financiare të vitit 2017 të gjenerohen nga programi si dhe monitorimin e e vazhdueshëm të rregjistrimeve për vitin 2018 e në vijim duke respektuar parimet e regjistrimeve në kohë , saktësi dhe korrektësi .

Niveli i prioritetit : i mesëm

Afati i zbatimit : Deri me 30/04/2018

Reagimi i menaxhimit : Dakort me zbatimin

**RAPORT FINAL AUDITIMI
GJYKATA E APELIT TIRANË**

2. Te analizohet gjendja aktuale e dy motocikletave dhe te mbahen nen kontroll shpenzimet per mirmbajtjen e tyre ne referim te ligjit 110/2015,per perdorimin me eficence, ekonomi dhe efikasitet te fondeve publike,te behet nje verifikim paraprak nga nje grup i ngritur per te shqyrtuar domosdoshmerine e kryerjes se sherbimeve te mirmbajtjes te shoqeruar me relacion sqarues.

Niveli i prioritetit : i mesëm

Afati i zbatimit : Ne vijimesi

Reagimi i menaxhimit : Dakort me zbatimin

3. Te analizohet gjendja aktuale e karburantit ne magazine dhe te merren masa qe furnizimi i mjeteve te transportit te kryhet vetem me karte elektronike ne zbatim te VKM nr561,date 29.07.2016,“Per standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve te karburantit ne njesite e qeverisjes se pergjithshme”.

V. Sistemi i prokurimeve me Vlera te Larta dhe Vlera te vogla

1. Ne perputhje me piken 1 te nenit 57 te VKM-se nr.914, date 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me Vendimin Nr.797, datë 29.12.2017, te caktohet personin/at përgjegjës për prokurimin. Personi/at përgjegjës për prokurimin të administrojë në mënyrë të vazhdueshme procesin e prokurimit dhe te kryejne te gjitha detyrat e parashikuara ne piken 3 te V.K.M-se.

2. Perlllogaritja e fondit limit te behet ne perputhje me nenin 59 te VKM-se nr.914, date 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.“Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës bëhet nga njësia e prokurimit, nëse”kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme. Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe a) çmimet e tregut; ose/dhe b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe ç) çmimet ndërkombëtare, të botuara”.

3. Njesia e Prokurimit te tregojte me shume kujdes ne vendosjen e kritereve te vecanta te kualifikimit, kerkesat te jene ne perputhje me nenin 1 pika 2/c,ç,d dhe piken 1 te nenit 46 te LPP, I ndryshuar. Ne menyre qe te eliminohen zgjatjet e panevojshme te procedurave te prokurimit, sigurimi i konkuresces dhe barazia ne tendera. Perlllogaritja e fondit limit dhe vendosja e disa kritereve kualifikuese per “Sherbimin e sigurimit dhe te ruajtjes” te behet ne perputhje me shkresen e APP-se dhe KPP nr.15166 dhe 1858 Prot. date 20.12.2017 “Rekomandim mbi menyren e zhvillimit te procedures se prokurimit per sherbimin privat te ruajtjes fizike”.

4. Materialet dhe paisjet që vleresohen edhe nga karakteristikat e tyre te percaktuara ne specifikimet teknike te merra ne dorëzim nga komisioni. Ne akt kolaudim/akt marrje ne dorezim te mallit te saktesohen karakteristikat e produkteve sipas kontratës me ato të furnizuara në fakt nga furnitori, ne perputhje me kërkesat e udhezimit nr.30 date 27.02.2011 “Menaxhimi i Aktiveve ne NJSHP”.

**RAPORT FINAL AUDITIMI
GJYKATA E APELIT TIRANË**

5. Të merren masa për mbikqyrjen e cilësisë së realizimit të kontratave të shërbimeve veçanërisht të ruajtjes dhe sigurisë fizikese të godinës së gjykatës në përputhje me nenin 77 të VKM-se nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Niveli i prioritetit : i mesëm

Afati i zbatimit : Në vijimësi

Reagimi i menaxhimit : Dakort me zbatimin

Per Procedurat e Prokurimet me Vlere te Vogel, rekomandohet:

a). Per blerje me Vlere te Vogel, përpara nxjerrjes së urdhrimit të prokurimit nga titullari i autoritetit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, pasi të ketë siguruar apo hartuar specifikimet teknike/termat e referencës të përlogaris fondin limit për sasinë e mallrave, shërbimeve, punëve që do të prokurojë, në përputhje me nenin 59 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

b). Në procedurën e prokurimit me vlerë të vogël autoriteti kontraktor nuk duhet të kërkojë paraqitjen e mostrave të mallit objekt prokurimi gjatë fazës të vlerësimit të ofertave, pasi verifikimi i cilësisë së mallit bëhet në momentin e marrjes në dorëzim të mallit, objekt prokurimi.

c). KPVV duhet të refuzojë automatikisht ofertën e paraqitur nga një operator ekonomik, i cili në një procedurë të mëparshme prokurimi me vlerë të vogël të zhvilluar nga ky autoritet gjatë këtij viti, nuk e ka njoftuar brenda afatit kohor të përcaktuar në ftesën për ofertë mbi arsyet që kanë çuar në pamundësinë e realizimit të objektit të prokurimit. Ky proces të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur për këtë qëllim, i cili duhet të bëhet pjesë e dosjes së tenderit.

d). Nga KBVV të mos përfshihen në klasifikimi, ato oferta që janë refuzuar, për shkak të mospasjes në objektin e ushtrimit të veprimtarisë objektin e prokurimit, si dhe ato që janë refuzuar për shkak të mos paraqitjes pa justifikim në një procedurë të mëparshme prokurimi.

e). Per blerjet me vlerë të vogël, kërkesat për punë, mallra apo shërbime të jenë me të qarta dhe të kene një përshkrim me të hollësishëm të punës, mallit apo shërbimit që kërkohej të realizohet. Në përputhje me të cilat të hartohen specifikimet teknike/termat e referencës dhe përlogaritja e fondit limit. Në përputhje me pikën 5 të Udhezimit Nr.3 datë 08.01.2018 “ Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.

Niveli i prioritetit : i mesëm

Afati i zbatimit : Menjeherë

Reagimi i menaxhimit: Dakort me zbatimin

VI. Sistemi i TI

1. Bazuar në nenin 37 germa “dhe” të Ligjit Nr.98, datë 06.10.2016 “Per Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve të tjera ligjore dhe nenligjore. Të hartohet rregullorja “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, në Gjykatën

**RAPORT FINAL AUDITIMI
GJYKATA E APELIT TIRANË**

1. Bazuar në nenin 37 germa “dhe” te Ligjit Nr.98, date 06.10.2016 “Per Organizimin e Pushtetit Gjyqesor ne Republiken e Shqiperise” dhe akteve te tjera ligjore dhe nenligjore. Te hartohet rregullorja “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, në Gjykatën e Apelit, Tirane”. Ku te perfshihen rregulla e perdorimit dhe ruajtjes te sistemit te TI, perdorimin e postes elektronike, siguria dhe mbrojtja e paisjeve te TI. Ne zbatim te kerkesave te Ligjit Nr.9887, date 10.03.2008, i ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012 mbi “Mbrojtjen e te dhenave personale”, Udhezimit Nr.15, date 23.12.2011 per “Perpunimin dhe publikimin e te dhenave personale ne sistemin gjyqesor”, Vendimit Nr. 1, date 04.03.2010 per “Percaktimin e rregullave te hollesishme per sigurimin e te dhenave personale”, si dhe akteve te tjera te Agjensise Kombetare te Shoqerise se Informacionit.

Niveli i prioritetit : i mesem

Afati i zbatimit : Deri me 31.03.2018

Reagimi i menaxhimit: Dakort me zbatimin

Këto rekomandime pasi të vlerësohen nga ju, do të shërbejnë si bazë për zbatimin e plan veprimit dhe reagimit, me qëllim përmirësimin e punës, duke nxjerrë aktet përkatës dhe personat përgjegjës që do t’i zbatojnë ato gjatë vitit 2018 e në vazhdim.

Raporti përfundimtar hartohet në dy kopje

Grupi i Auditimit


Inspektor Audit

Agim Koçi



Inspektor Audit

Aristotel Telhaj



Inspektor Audit

Marjana Sulshabanaj

